



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR
NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
I PËRPUTHSHMËRISË
NË
NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE
TIRANË

Tiranë 2022

Përmbajtja

| | |
|---|--------------|
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE..... | 3 |
| 1.Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit..... | 3 |
| 2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve..... | 3 |
| 3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinion i auditimití í í í í í í í í í í í í í í í | 9 |
| II.HYRJA..... | 13 |
| 1. Objekti i auditimit..... | 14 |
| 2. Qëllimi i auditimit..... | 14 |
| 3. Identifikimi i çështjes..... | 14 |
| 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese..... | 14 |
| 5. Përgjegjësit e audituesve..... | 14 |
| 6. Kriteret e vlerësimit..... | 15 |
| 7. Standartet e auditimit..... | 15 |
| 8. Metodat e auditimit..... | 15 |
| 9. Dokumentimi i auditimit..... | 15 |
| III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT..... | 15 |
| 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin..... | 15 |
| 2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit..... | 16 |
| 2.1. Mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të kompetencave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullësor (Për këtë pikë auditimi do të merren të dhëna edhe në institucionet: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Njësitet e Qeverisjes Vendore)..... | 16-31 |
| 2.2. Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i programit ekonomik | 31-34 |
| 2.3. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi..... | 34-41 |
| 2.4. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.)..... | 41-43 |
| 2.5. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore..... | 43-54 |
| 2.6. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime..... | 54-72 |
| 2.7. Vlerësimi dhe argumentimi i dhënies së ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash)..... | 72-77 |
| IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET..... | 77-94 |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrimi i shkurtër i projektit

Agjencia, në përputhje me misionin, fushat e përgjegjësisë dhe përgjegjësitë e saj funksionale, të përcaktuara në Ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", kryen detyrat, si më poshtë vijon:

-Agjencia ka për mision zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

-Identifikon nevojat me qëllim përcaktimin e prioriteteve në këtë fushë, bazuar në analizën e situatës së riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel kombëtar;

-Bashkëpunon me institucionet e strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, në nivel qendror e vendor, si dhe me organet, entet, institucionet e specializuara lidhur me plane, programe e projekte që synojnë reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

-Mbrojtjen civile në nivel kombëtar;

-Trajnimin e vazhdueshëm të strukturave shtetërore, të subjekteve private dhe të vullnetarëve,

I.2 Gjetjet kryesore të konstatuara

| Gjetja | Përmbledhje e gjetjes | Referenca në raport | Rëndësia | Rekomandimi |
|--------|--|---------------------|----------|-------------|
| 1 | <p>Plani Kombëtar për Emergjencat Civile është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 385, date 03.12.2004.</p> <p>Institucionet e ngarkuara me ligj për emergjencat civile për 17 vite, periudha viti 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, nuk kanë arritur të përditësojnë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2004 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot. Dokumenti Strategjik i Emergjencave Civile të Shqipërisë deri në miratimin e dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2004, i cili nuk pasqyron rrethana te reja në fushën menaxhimit të emergjencave, përfshirë edhe Ligjin nr. 45/2019 për mbrojtjen civile, në rastet si më poshtë:</p> <p>Kreu 1. (1.2) Baza ligjore</p> <p>Kreu 2. Organizimi i Sistemit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në Shqipëri.</p> <p>Kreu 3.(3.3) Përgjegjësitë për bashkërendimin e emergjencave civile.</p> <p>Kreu 4.(4.3) Masat e përgjithshme për Parandalimin dhe Lehtësimin.</p> <p>Kreu 5.(4.3) Rolet dhe Përgjegjësitë.</p> <p>Kreu 6 Përgjigja.</p> <p>Shtojca B: Baza ligjore, funksionet dhe</p> | Pika 2.1, fq 16-31 | E lartë | Ska |

| | | | | |
|---|---|--------------------|---------|-----|
| | detyrat e institucioneve etj, të cilat nuk gjejnë mishërim te plani kombëtar i vitit 2004. | | | |
| 2 | <p>Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 për mbrojtjen civile. Në veçanti për sigurimin e pronës bujqësore, kullësore nga shoqëritë e sigurimit. Konkretisht: Janë në proces miratimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekt-vendim për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile. -Projekt-vendim për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112. -Projekt-vendim për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive. <p>Nuk ka, dhe as në proces akt rregullator, për sigurimin nga zjarri në shoqëritë e sigurimit, për dëm shpërblimin në rast të rënies të zjarrit. Ashtu siç është vepruar me ndërtesat nga tërmeti etj.</p> <p>-Bashkitë dhe Prefekturat përpos njësive të reaguesve të parë, nuk kanë në dispozicion edhe kompani të specializuara për mbrojtjen nga zjarri kontraktuara të cilat asistojnë në aspektin teknik sa herë që kërkohet nga Bashkitë dhe Prefekturat, edhe pse me Ligjin 45/2019 për Mbrojtjen Civile, neni 30, pikat e dhe j, neni 58, pika ç; neni 61, pika ë mundësohet angazhimi i subjekteve private.</p> | Pika 2.1, fq 16-31 | E lartë | Ska |
| 3 | <p>Për periudhën 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Mungesa e këtij dokumenti ka bërë të pamundur parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Pas një viti 1 viti e gjysmës, me urdhër të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021, është ngritur grupi ndërinstytucional dhe grupi teknik</p> | Pika 2.1, fq 16-31 | E mesme | Ska |

| | | | | |
|---|--|----------------------|---------|---|
| | <p>ndërinstitucional i punës për përgatitjen Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ky dokument është në proces, pra nuk ka përfunduar.</p> | | | |
| 4 | <p>Niveli qendror dhe lokal nuk ka burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret.</p> <p>-Nga 61 Bashki në shkallë Republike, janë marrë të dhëna në 55 prej tyre, në të cilat raportohen 152 zjarrfikëse. Nga këto 131 në gjendje pune, 8 me defekte të vogla, 3 me defekte të konsiderueshme, 10 jashtë përdorimit dhe 36 të pa targuara (pa dokumentacion). Shumë nga zjarrfikëset në dispozicion janë të vjetruara (disa që datojnë nga vitet gjashtëdhjetë), janë në gjendje të keqe dhe nuk janë të ndërveprueshme sepse janë dhuruar nga vende të ndryshme.</p> <p>Numri i zjarrfikësve profesionist për vitin 2021 është 1295. Popullsia në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 2021 është 2,829,741 banor. Numri i banorëve/zjarrfikës për vitin 2021 është 2,185, duke kaluar 205 banor për zjarrfikës, në kundërshtim me Ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" neni 7, pika 5 - Bashkive dhe njësisive administrative u mungojnë pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisje të jashtme për shuarjen e zjarreve, si: Kostume anti zjarr, kundragaz, çizme kundra zjarrit, doreza kundra zjarrit etj. Pompa shpine gjithsej 243, nga këto profesionale 221, të zakonshme 22, fikse me pluhur 568, me CO2 92, pompa thithëse 23 dhe pompa të ndryshme 55.</p> <p>Sipas Ligjit Nr. 152/2015, "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shërbimin e Shpëtimin", shumica e kompetencave të shuarjes së zjarrit u transferuan nga prefekturat tek bashkitë, duke lënë në nivel qendror vetëm legjislacionin, trajnimin dhe bashkëpunimin mes strukturave të shuarjes së zjarrit.</p> <p>Sipas Ligjit Nr. 152/2015, Bashkitë janë të detyruara të investojnë në ngritjen e kapaciteteve vullnetare të shuarjes së</p> | Pika 2.1 fq 16-31 | E mesme | <p>Nga Drejtori i Përgjithshëm ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pamjaftueshmëria e burimet njerëzore dhe teknike për menaxhimin efektiv dhe reagimin ndaj situatave emergjente(zjarret).</p> |

| | | | | |
|---|---|---------------------------|----------------|---|
| | <p>zjarreve, përveç shërbimit profesional. Por kufizimet buxhetore pengojnë shumë bashki të zhvillojnë programe për shuarjen e zjarrit me vullnetarizëm.</p> | | | |
| 5 | <p>Gjendja e mangët operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret), ka krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë. Konkretisht Ministria e Mbrojtjes nga 4 helikopter gjithsej, ka në gjendje operacionale vetëm një helikopter të gatshëm, i cili është përdorur gjatë operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë gjatë vërës së këtij viti.</p> <p>Në këtë kontekst, shpenzimi prej 36,069,300 lekë për blerjen e shërbimit me dy helikopter nga shoqëria ðV.H.ö nga AKMC, nuk do të ishte kryer në qoftë se Ministria e Mbrojtjes do të kishte përdorur kapacitetet e veta operacionale, si dhe AKMC nuk do të ishte drejtuar Mekanizimit Evropian të Mbrojtjes Civile ERCC, për ndihmë ndërkombëtare, ndihmë e cila ka ardhur nga Shteti Hollandez me 3 mjete Helikopter dhe 76 veta personel, Republika Çeke me 2 mjete Helikopter me 7 veta personel. Gjithashtu USAID ka ofruar asistencë teknike mbi metodat e shuarjes së zjarreve në pyje me 4 veta personel, të cilët lehtësuan procesin e shuarjes së zjarreve në vatrat më kritike të vendit</p> | <p>Pika 2.1, fq 16-31</p> | <p>E lartë</p> | <p>Ska</p> |
| 6 | <p>Nuk është krijuar fondi i solidaritetit i krijuar dhe banka për mbrojtjen civile (zjarret), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 ðPër mbrojtjen civilë, neni 66 ðFondi i solidaritetit, pikat 1,2,3 ku është shprehur respektivisht ðPika 1. AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond solidariteti, për mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të këtij ligji.</p> <p>Pika 2. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik.</p> <p>Pika 3. Fondi i krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, mund t'ua transferohet njësisive të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre, sipas legjislacionit në fuqi</p> | <p>Pika 2.1, fq 16-31</p> | <p>E lartë</p> | <p>Nga AKMC-ja, të merren masa për të krijuar fondin e solidaritetit nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, për përballimin e situatave emergjente, si dhe të bëhen transparente të gjitha proceset e krijimit të këtij fondi.</p> |
| | <p>AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021,</p> | | | |

| | | | | |
|---|--|--------------------|---------|---|
| 7 | <p>ka kryer procedurë prokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015 òPër prokurimin Publik në Ministrin e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në Forcat e Armatosuraò, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik</p> | Pika 2.6, fq 53-71 | E lartë | Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen. |
| 8 | <p>AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajon gusht 2021, nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 46.</p> <p>-Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fondi është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., datë 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., datë 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50.</p> <p>Për këtë procedurë prokurimi nuk është marrë autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1</p> | Pika 2.6, fq 54-72 | E lartë | Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me procedurën për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në Gusht 2021, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve. |
| 9 | <p>Referuar faktit që Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes</p> | Pika 2.6, fq 54-72 | E lartë | Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullosor etj.,) duke marrë masa për një organizim më të mirë institucional në |

| | | | | |
|----|---|--------------------|---------|--|
| | <p>së zjarreve nga ajri në Gusht 2021, duhet të kishte vlerësuar dhe zhvilluar procedurën e prokurimit të Marrëveshje kuadërë, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, të Për prokurimin publikë 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, të Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, neni 60 ,61 dhe 62, për të siguruar mirë përdorimin të fondeve publike</p> | | | <p>aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, në këtë kontekst vlerësimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit të Marrëveshje kuadërë.</p> |
| 10 | <p>Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik të V.H. nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, të Për prokurimin publikë nënenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, të Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, neni 82.</p> <p>Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Operatori ekonomik të V.H. shpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik të V.H. shpk, dhe Kompanisë A.I.G.C Gjermani, dokument i pavlefshëm për tu marr në konsideratë pasi: -Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë. -Konfirmimin që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit. -Konfirmimi i operacioneve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit. -Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit) -Licencën Operative , në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautikë i vendit të regjistrimit Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011 të Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010 "mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2. -Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse | Pika 2.6, fq 54-72 | E lartë | <p>Nga Institucioni t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.</p> |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik ÷V.H.ö, nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.</p> <p>Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të ÷V.H.ö shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.</p> | | | |
|--|--|--|--|--|

1.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e përputhshmërisë të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Tiranë për periudhën nga data 01.09.2020 deri me datë 10.12.2021.

Nga auditimi i ushtruar u konstatua se aktiviteti i Institucionit në përgjithësi përputhet me kërkesat dhe kriteret e kuadrit ligjor në fuqi. Pavarësisht sa u citua si më sipër, për periudhën objekt auditimi u konstatuan edhe shkelje të kuadrit nënligjor dhe rregullator dhe në veçanti të përditësimit të dokumenteve strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente, pasi ende vazhdohet me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 385, datë 03.12.2004; Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 ÷Për mbrojtjen civileö. Në veçanti për sigurimin e pronës bujqësore, kullosore nga shoqëritë e sigurimit; Për periudhën 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Mungesa e këtij dokumenti ka bërë të pa mundur parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; Zbatimin e procedurave të prokurimit dhe kontratave për shërbimet publike, kryerjen e transaksioneve financiare për shpenzimet, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, etj.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë e modifikuar/kualifikuar

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Tiranë për 01.09.2020 deri me datë 10.12.2021, nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të aktivitetit të këtij Institucioni. Krahas parregullsisive materiale sasiore të konstatuara, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Tiranë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e **një opinionit të***

modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Tiranë, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionin me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 (Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë), ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530); Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit, kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

-Nuk është kryer përditësimi i dokumenteve strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente, pasi ende vazhdohet me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 385, date 03.12.2004. Dokumenti Strategjik i Emergjencave Civile të Shqipërisë deri në miratimin e dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2004, i cili nuk pasqyron rrethana të reja në fushën menaxhimit të emergjencave, përfshirë edhe Ligjin nr. 45/2019 për mbrojtjen civile.

-Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, për mbrojtjen civile, në veçanti për sigurimin e pronës bujqësore, kullimore nga shoqëritë e sigurimit. Për periudhën 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Mungesa e këtij dokumenti ka bërë të pamundur parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

- Nuk ka funksionuar Komisioni Teknik Këshillimor i emëruar në zbatim të VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive.

-Niveli qendror dhe lokal nuk ka burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret. Nga 61 Bashki në shkallë Republike, janë marrë të dhëna në 55 prej tyre, në të cilat raportohen 152 zjarrefikëse. Nga këto 131 në gjendje pune, 8 me defekte të vogla, 3 me defekte të konsiderueshme, 10 jashtë përdorimit dhe 36 të pa treguara

(pa dokumentacion). Shumë nga zjarrfikëset në dispozicion janë të vjetruara (disa që datojnë nga vitet gjashtëdhjetë), janë në gjendje të keqe dhe nuk janë të ndërveprueshme, sepse janë dhuruar nga vende të ndryshme.

- Bashkive dhe njësi administrative u mungojnë pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisje të jashtme për shuarjen e zjarreve, si: Kostume anti zjarr, kundragaz, çizme kundra zjarrit, doreza kundra zjarrit etj. Janë raportuar nga bashkitë pompa shpine gjithsej 243, nga këto profesionale 221, të zakonshme 22, fikse me pluhur 568, me CO2 92, pompa thithëse 23 dhe pompa të ndryshme 55.

Numri i zjarrfikësve profesionist për vitin 2021 është 1295. Popullsia në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 2021 është 2,829,741 banor. Numri i banorëve/zjarrfikës për vitin 2021 është 2,185, duke kaluar 205 banor për zjarrfikës, në kundërshtim me Ligjin 152/2015 òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò neni 7, pika 5.

Me Ligjin Nr. 152/2015,òPër Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shërbimin e Shpëtiminò, shumica e kompetencave të shuarjes së zjarrit u transferuan nga prefekturat tek bashkitë, duke lënë në nivel qendror vetëm legjislacionin, trajnimin dhe bashkëpunimin mes strukturave të shuarjes së zjarrit. Referuar këtij Ligji, Bashkitë janë të detyruara të investojnë në ngritjen e kapaciteteve vullnetare të shuarjes së zjarreve, përveç shërbimit profesional. Por kufizimet buxhetore pengojnë shumë bashki të zhvillojnë programe për shuarjen e zjarrit me vullnetarizëm.

-Nga AKMC, nuk ka janë përdorur Kapacitetet e Paralajmërimit të hershëm.

- Gjendja e mangët operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret), ka krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë në korrik-gusht 2021.

- Nuk është krijuar fondi i solidaritetit për mbrojtjen civile (zjarret), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilò, neni 66 òFondi i solidaritetinò, pikat 1,2,3.

- Për periudhën objekt auditimi nga AKMC, nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilò, neni 67 “Inspektiminò, pikat 1 dhe 2.

- Për periudhën objekt auditimi, në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilò, neni 68 “Kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2.

- AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, ka kryer procedurë prokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes, si dhe nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 46. Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik òV.H.ò për sigurimin e dy mjeteve ajrore nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 82.

- Referuar faktit që Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente, nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në gusht 2021, duhet të kishte vlerësuar dhe zhvilluar

procedurën e prokurimit òMarrëveshje kuadërò, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 60 ,61 dhe 62, për të siguruar mirë përdorimin të fondeve publike.

- Është likuiduar shoqëria òV.H.ò për vlerën 36,069,300 lekë, për 89.06 orë pune operacionale të helikopterëve të kontraktuar për fikjen e zjarreve. Regjistri i mbajtur për orët operacionale të helikopterëve më datë 03.08.2021, pasqyron Berlin(Gjermani)-Shqipëri 11,53 orë operacionale x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se òNjësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku òKohë pune operacionaleò, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V. Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë...ò.Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria V.H.ò shpk.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Tiranë.

Strukturat ekzekutive dhe drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Tiranë, janë përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike (burimeve financiare) në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), kryesisht dhe veçanërisht ato për zbatimin e gjithë kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator për emergjencat civile.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësive publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde dhe procedura prokurimi në pajtim me kriteret ligjore, nënligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme , nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e një opinionit të arsyeshëm. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH kanë respektuar në vijimësi kërkesat Kodit të Etikës të KLSH, në lidhje organike më të gjithë kërkesat e kuadrit ligjor rregullator të veprimtarisë menaxheriale audituese institucionale.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinionit i auditimit janë të përshtatshme.

Ky auditim përputhshmërie promovon përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, òPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 851/1prot., datë 04.08.2021, i ndryshuar, nga data 05.08.2021 deri 10.12.2021, në Agjencinë Kombëtare e Mbrojtjes Civile Tiranë (në vijim AKMC) për periudhën nga data 01.09.2020 deri me datë 10.12.2021, u krye auditimi òPërputhshmërisë me përbërje:

1. F. I., përgjegjës grupi
2. E. M., audituese
3. M. H., auditues
4. A.T., auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objekti i auditimit: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Tiranë ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të aktivitetit të Institucionit.

b. Qëllimi i auditimit:

Auditimi ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

c. Identifikimi i çështjes:

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Tiranë duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për përgjegjësitë e saj funksionale në mbrojtjen civile në nivel kombëtar, duke patur në konsideratë bashkëpunimin me institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, në nivel qendror e vendor, si dhe me organet, entet, institucionet e specializuara lidhur me plane, programe e projekte që synojnë reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Menaxhmenti është përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore dhe që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilë, Ligjin nr. 152/2015 òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, VKM nr. 747, datë 20.11.2019, òPër organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, VKM nr. 923, datë 25.11.2020, òPër funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile.

e. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë

respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

f. Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Ligji nr. 45/2019 ÷Për mbrojtjen civilë; Ligji nr. 152/2015, ÷Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin; Ligji nr. 25/2018, ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015, ÷Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, ÷Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, ÷Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007, ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar; VKM nr. 747, datë 20.11.2019, ÷Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile; VKM nr. 923, datë 25.11.2020, ÷Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile; VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, ÷Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive; VKM nr. 965, datë 2.12.2015, ÷Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave; VKM nr. 148, datë 24.2.2016, ÷Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit dhe statistikës të Këshillit të Ministrave; VKM nr. 870, datë 14.12.2011, ÷Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit; VKM nr. 997, datë 10.12.2010, ÷Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, me ndryshimet vijuese të tij; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, ÷Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar.

g. Standardet e auditimit:

ISSAI 100- (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik);
-ISSAI 4000- (Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë);
ISSAI 400 - (Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë);
- SNA) të IFAC - (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit);
-Manual i IDI-t -(Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI për auditimet e përputhshmërisë);
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;
-Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH-së;
-Kodi etik i KLSH.

h. Metoda e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

i. Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 ÷Dokumentimi i Auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia, në përputhje me misionin, fushat e përgjegjësisë dhe përgjegjësitë e saj funksionale, të përcaktuara në Ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", kryen detyrat, si më poshtë vijon:

- Agjencia ka për mision zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Identifikon nevojat me qëllim përcaktimin e prioriteteve në këtë fushë, bazuar në analizën e situatës së riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel kombëtar;
- Bashkëpunon me institucionet e strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, në nivel qendror e vendor, si dhe me organet, entet, institucionet e specializuara lidhur me plane, programe e projekte që synojnë reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;
- Mbrojtjen civile në nivel kombëtar;
- Trajnimin e vazhdueshëm të strukturave shtetërore, të subjekteve private dhe të vullnetarëve;

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të kompetencave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor (Për këtë pikë auditimi do të merren të dhëna edhe në institucionet: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore).

Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore për Shqipërinë janë: gjeologjike (tërmete, rrëshqitje dheu, shkëmbinjsh); hidrometeorologjike (përmytje, shira të rrëmbyer, thatësira, stuhi bore, orteqe apo bllokim nga bora, stuhi ere); bio-fizike (zjarre në pyje, epidemi). Shqipëria ndeshet gjithashtu me një numër problemesh mjedisore, të cilave u shtohet ekzistenca ende e zonave me rrezik të lartë për shkak të ndotjes (hot-spote).

Dy vitet e fundit, një numër ngjarjesh të ndjeshme kanë përqendruar vëmendjen në aftësinë e shoqërisë shqiptare, për t'iu përgjigjur emergjencave siç janë katastrofat natyrore (tërmetet), dhe shpërthimi i epidemive të ndryshme (COVID-19), disa prej të cilave ndodhin natyrshëm e disa nga faktori njeri.

Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret. Në vitin 2021, sipërfaqja totale e djegur (për shkaqe natyrore apo nga njeriu) arriti 8029 hektarë, nga 8479 ha që është regjistruar në vitin 2017.

Planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente, nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. Në situatat emergjente të krijuara pa prituri, çdo vonesë në menaxhimin e situatës së shkaktuar do të rezultojë në përhapjen e mëtejshme të fatkeqësisë (në rastin e fundit me pandeminë COVID-19). Nga ana tjetër, pas përfundimit të emergjencës është e rëndësishme që të ndërmerren masa për rimëkëmbjen e komuniteteve të prekura. Këto probleme mund të shmangen nëse ekziston një planifikim dhe përgatitje e duhur për parandalimin dhe tejkalimin e këtyre situatave.

Menaxhimi i emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullosor etj.) kërkon një organizim të mirë institucional, në aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të

jashtëzakonshme. Reagimi ndaj rasteve emergjente paraqet një varg aktiviteteve sfiduese që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore. Situatat e jashtëzakonshme dallojnë nga përmasat, shkaqet dhe pasojat, kështu që kërkojnë një përgatitje dhe reagim institucional të organizuar mirë.

Cikli i menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullosor etj..) tregon se gatishmëria e mirë për emergjencat (zjarreve) është një proces i vazhdueshëm. Gjithashtu sqaron faktin se kur ndodh ndonjë fatkeqësi, reagimi i shpejtë është thelbësor për të minimizuar dëmet njerëzore dhe materiale. Bazuar në përvojat e më hershme pas çdo gjendje jo të zakonshme vjen periudha e rimëkëmbjes dhe e rikthimit të ekonomisë apo sektorëve të prekur, në gjendjen e mëparshme.

Planifikimi dhe praktikimi duhet të bëhet në të gjitha fazat e ciklit. Është sidomos e rëndësishme që planet e reagimit të testohen rregullisht dhe tërësisht si pjesë e fazës përgatitore. Kjo do të sigurojë që planet të jenë praktike, të realizueshme dhe se njerëzit që do të përballen me problemin në terren janë plotësisht të trajnuar në zbatimin e rolit të tyre.

Pas paraqitjes së rasteve të zjarreve në një komunitet, ndërhyrja e menjëhershme e institucioneve kompetente mundëson minimizimin e dëmeve të shkaktuara nga këto fatkeqësi. Kjo ndërhyrje bëhet përmes aktiviteteve të reagimit emergjent, të cilat adresojnë efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta të një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe mjedisit të komunitetit të përfshirë nga zjarret.

Aksionet e reagimit për shpëtim dhe ndihmë në komunitetet e goditura nga zjarret, mund të jepen nga tri nivele reaguesish varësisht prej nivelit të urgjencës së situatës së paraqitur. Niveli i parë janë niveli i bashkisë, niveli i dytë janë Prefektët e Qarkut dhe niveli i tret niveli qendror (AKMC në koordinimin me Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit, Ministria e Shëndetësisë etj).

KUADRI LIGJOR DHE KONCEPTUAL

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenet 170 dhe 174, adreson çështjet e emergjencave dhe fatkeqësive, aktet që nxirren dhe masat që merren në raste të tilla. Gjithashtu janë miratuar: Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilë, dhe òPlani Kombëtar i Emergjencave Civile. Përveç tyre, ka një numër ligjesh dhe vendimesh qeverie të tjera që adresojnë aspekte të veçanta të Emergjencave Civile, si p.sh Ligji nr. 152/2015, òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, VKM nr. 148, datë 24.2.2016, òPër ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit dhe statistikës të këshillit të ministrave, VKM nr. 747, datë 20.11.2019, òPër organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, VKM nr. 923, datë 25.11.2020, òPër funksionimin e organizimit të komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile, VKM nr. 747, datë 20.11.2019, òPër organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, VKM Nr. 520, datë 25.7.2019, òPër miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Gjatë periudhës korrik - gusht, si pasojë e temperaturave të larta që kanë përfshirë mbarë rajonin, në të gjithë vendin janë shfaqur 556, vatra zjarri (194 gjatë muajit korrik dhe 362 gjatë muajit gusht) si dhe janë prekur 58 bashki. Zjarret më problematike janë ato që kanë prekur Prefekturën e Vlorës, Lezhës, Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Dëmet e shkaktuara janë të konsiderueshme në banesa, sipërfaqe pyjore, kullota, shkurre, ullishte por edhe 2 humbje jete në fshatin Arshi Lengo, njësia administrative Antigone, Bashkia Gjirokastrë.

Më konkretisht dëmet e shkaktuara nga zjarret sipas prefekturave paraqiten sipas tabelës së mëposhtme.

| Prefektura | Humbje Jete | Lëndime Persona | Ndërtesa | Shkurre (ha) | Ullishte (rrënjë) | Dushk (ha) | Pemëtari | Tokë bujqësore (ha) | Kullote | Ahishte (ha) | Pisha | Total rrënjë | Total hektarë |
|-------------|-------------|-----------------|----------|--------------|-------------------|------------|----------|---------------------|---------|--------------|-------|--------------|---------------|
| Berat | 0 | 0 | 1 | 22 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 51 | 0 | 77 |
| Dibër | 0 | 0 | 3 | 46 | 0 | 21 | 0 | 0 | 33 | 0 | 328 | 0 | 428 |
| Durrës | 0 | 0 | 2 | 63 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 66 |
| Elbasan | 0 | 0 | 0 | 28 | 500 | 7 | 0 | 0 | 0 | 2 | 23 | 500 | 60 |
| Fier | 0 | 0 | 7 | 161 | 11283 | 0 | 84 | 0 | 1 | 0 | 119 | 11367 | 280 |
| Gjirokastrë | 2 | 3 | 3 | 564 | 560 | 38 | 20 | 3 | 0 | 0 | 12 | 580 | 614 |
| Korçë | 0 | 2 | 10 | 79 | 0 | 5 | 0 | 11 | 1 | 0 | 40 | 0 | 125 |
| Kukës | 0 | 0 | 0 | 2065 | 0 | 7 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 0 | 2076 |
| Lezhë | 0 | 0 | 1 | 91 | 100 | 218 | 0 | 0 | 237 | 0 | 3 | 100 | 548 |
| Shkodër | 0 | 5 | 6 | 1162 | 2000 | 3 | 0 | 0 | 18 | 380 | 34 | 2000 | 1596 |
| Tiranë | 0 | 0 | 9 | 112 | 265 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17 | 265 | 129 |
| Vlorë | 0 | 0 | 2 | 1941 | 540 | 2 | 0 | 0 | 83 | 0 | 3 | 540 | 2028 |
| Total | | 10 | 44 | 6335 | 15248 | 300 | 104 | 13 | 377 | 383 | 635 | 15352 | 8029 |

Burimi i të dhënave: AKMC

Prefekturat me sipërfaqet më të mëdha të djegura janë Vlora, Kukësi dhe Shkodra. Nga vlerësimet e ekspertëve të kryera në terren janë raportuar të djegura 8029 hektarë, nga të cilat kullotë 377 ha, shkurre 6335 ha, dushk 300 ha, ahishte 383 dhe pisha 635 ha. Janë djegur gjithashtu 15248 rrënjë ullinj dhe 104 rrënjë pemëtari të ndryshme.

Për situatën e zjarreve korrik - gusht 2021, AKMC-së i janë bërë 69 kërkesa për ndihmë nga Prefektët e Qarqeve dhe njësitë vendore për vatrat e zjarreve Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. AKMC-ja për koordinimin dhe shpërndarjen e kapaciteteve logjistike dhe njerëzore për përballimin e situatës së zjarreve korrik-gusht 2021, i ka bërë 151 kërkesa Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile. Në mënyrë të detajuar kërkesat janë paraqitur tek letrat e punës.

Për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave të emergjencave civile, përfshi këtu dhe ato të zjarreve për periudhën korrik-gusht 2021, janë identifikuar mangësitë të natyrës ligjore/ rregullatorë, si dhe ato operacionale si më poshtë vijon:

-1. Plani Kombëtar për Emergjencat Civile është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 385, date 03.12.2004.

Institucionet e ngarkuara me ligj për emergjencat civile për 17 vite, periudha viti 2004 deri më datë 10.12.2021 që ka përfunduar auditimi, nuk kanë arritur të përditësojnë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2004 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot. Dokumenti Strategjik i

Emergjencave Civile të Shqipërisë deri në miratimin e dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2004, i cili nuk pasqyron rrethana të reja në fushën menaxhimit të emergjencave, përfshirë edhe Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, në rastet si më poshtë:

Kreu 1. (1.2) Baza ligjore.

Kreu 2. Organizimi i Sistemit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në Shqipëri.

Kreu 3.(3.3) Përgjegjësitë për bashkërendimin e emergjencave civile.

Kreu 4.(4.3) Masat e përgjithshme për Parandalimin dhe Lehtësimin.

Kreu 5.(4.3) Rolet dhe Përgjegjësitë.

Kreu 6 Përgjigja.

Shtojca B: Baza ligjore, funksionet dhe detyrat e institucioneve etj, të cilat nuk gjejnë mishërim të plani kombëtar i vitit 2004.

Plani i Reagimit Kombëtar nuk ka gjetur zbatueshmëri në shumë intervenime që janë bërë gjatë ndodhjes së fatkeqësive. Plani Kombëtar i Emergjencave Civile, është një nga dokumentet kyçe për të zbërthyer vizionin strategjik në aktivitete praktike. Ai përcakton organizimin e sistemit kombëtar të menaxhimit të emergjencave civile dhe përgjegjësitë e ndërveprimin në nivel kombëtar, rajonal e komunal. Ai gjithashtu trajton çështjet e informimit publik, bashkëpunimit dhe asistencës së jashtme, implikimet financiare, vlerësimin dhe raportimi e dëmeve, bashkëpunimin me OJQ-të në situata të tilla, etj. Në thelb ai është një mjet koordinimi.

Për periudhën 2004 deri më janar të vitit 2020 është operuar me Ligjin nr. 8576, datë 26.03.2001, òPër emergjencat civile, i ndryshuar, ligj i cili nuk përcakton përditësimin e dokumentit strategjik të emergjencave civile së Shqipërisë. Në janar 2020 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 14, pika 2, ka të përcaktuar òPlanet për emergjencat civile miratohen në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor dhe rishikohen jo më pak se një herë në çdo tre vjet.

Me urdhër të Kryeministrit nr. 58, datë 29.06.2021, është ngritur grupi ndërinstitucional dhe grupi teknik ndërinstitucional i punës për përgatitjen e projektit të ri të Planit Kombëtar për emergjencat Civile. Me urdhër të Kryeministrit nr. 97, datë 08.07.2021 është urdhëruar ngritja, përbërja dhe funksionimi i sekretariatit teknik të grupi ndërinstitucional dhe grupi teknik ndërinstitucional i punës për përgatitjen e projektit të ri të Planit Kombëtar për emergjencat Civile.

2. Për periudhën 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundon auditimi, Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Mungesa e këtij dokumenti ka bërë të pamundur parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Pas 1 viti e gjysmës, me urdhër të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021, është ngritur grupi ndërinstitucional dhe grupi teknik ndërinstitucional i punës për përgatitjen Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ky dokument është në proces, pra nuk ka përfunduar deri më datë 10.12.2021 që përfundon auditimi.

Në Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 10 òStrategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është shprehur në mënyrë eksplicite ò*Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit. 2. Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë rishikohet, jo më pak se një herë në çdo pesë vjet, nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.*

3. Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civileò. Në veçanti për sigurimin e pronës bujqësore, kullimore nga shoqëritë e sigurimit. Konkretisht: Janë në proces miratimi:

- Projekt-vendim për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile.

-Projekt-vendim për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112.

-Projekt-vendim për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive.

Nuk ka dhe as në proces akt rregullator, për sigurimin nga zjarri në shoqëritë e sigurimit, për dëm shpërblimin në rast të rënies të zjarrit. Ashtu siç është vepruar me ndërtesat nga tërmeti etj.

-Bashkitë dhe Prefekturat për pos njërive të reaguesve të parë, nuk kanë në dispozicion edhe kompani të specializuara për mbrojtjen nga zjarri të kontraktuara, të cilat asistojnë në aspektin teknik sa herë që kërkohet nga Bashkitë dhe Prefekturat, edhe pse me Ligjin 45/2019, òPër Mbrojtjen Civileò, neni 30, pikat e dhe j, neni 58, pika ç; neni 61, pika ë mundësohet angazhimi i subjekteve private.

4. Qendra Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civile nuk është plotësuar me organikën e plotë, nuk janë hartuar programet e trajnimit për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, për rritjen e aftësive për zvogëlimin e riskut, programet e edukimit dhe ndërgjegjësimin, në fushën e zvogëlimin të riskut, si dhe mbikëqyrja dhe zhvillimi i trajnimeve për personelin e mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, në fushën e zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile.

Me urdhër të kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020 òPër miratimin e strukturës dhe të organikës së AKMCò, është krijuar Qendra Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civileò, si njësi organizative e drejtorisë së Edukimit Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit, me 4 punonjës, ku në fakt janë 3 punonjës (specialist), përgjegjësi i sektorit është vakant. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 881, datë 25.06.2021 òPër metodat e brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel qendror dhe vendor.

Referuar sa më lart kjo rregullore ka **dal rreth 16 muaj me vonesë** nga urdhri i Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020, òPër miratimin e strukturës dhe të organikës së AKMCò.

Në strukturën organizative të AKMC është Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit, përbëhet nga 2 (dy) sektorë, të cilët janë:

-Sektori (Qendra) Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizmit;

-Sektori i GIS, IT dhe Publikimit.

Deri më 10.12.2021 datë në të cilën përfundoi auditimi, kjo organikë nuk është plotësuar. Konkretisht me vend vakant drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i Sektorit (Qendra) Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizmit, si dhe një specialist Sektorit i GIS, IT dhe Publikimit.

5. Nuk ka funksionuar Komisioni Teknik Këshillimor i emëruar në zbatim të VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, òPër përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësiveò, është vendosur nënë drejtimin AKMC në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (në vijim KTK), i cili këshillon për çështje të zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile. KTK-ja kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i AKMC dhe ka në përbërje përfaqësues të Ministrive, të strukturave në vartësi të tyre dhe të institucioneve. Ky komision nuk është mbledhur për periudhën janar-gusht 2021.

Mbledhja e këtij komisioni për periudhën janar-gusht 2021, referuar pikës 3/a të vendimit të sipërcituar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se òKTK-ja thirret dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC, sa herë që e gjykon të nevojshme, por jo më pak se një herë në gjashtë muaj. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm.

6. Niveli qendror dhe lokal nuk ka burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret.

-Nga 61 Bashki në shkallë Republike, janë marrë të dhëna në 55 prej tyre, në të cilat raportohen 152 zjarrfikëse. Nga këto 131 në gjendje pune, 8 me defekte të vogla, 3 me defekte të konsiderueshme, 10 jashtë përdorimit dhe 36 të pa targuara (pa dokumentacion). Shumë nga zjarrfikëset në dispozicion janë të vjetruara (disa që datojnë nga vitet gjashtëdhjetë), janë në gjendje të keqe dhe nuk janë të ndërveprueshme sepse janë dhuruar nga vende të ndryshme.

- Bashkive dhe njërive administrative u mungojnë pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisje të jashtme për shuarjen e zjarreve, si: Kostume anti zjarr, kundragaz, çizme kundra zjarrit, doreza kundra zjarrit etj. Janë raportuar nga bashkitë, pompa shpine gjithsej 243, nga këto profesionale 221, të zakonshme 22, fikse me pluhur 568, me CO2 92, pompa thithëse 23 dhe pompa të ndryshme 55.

Numri i zjarrfikësve profesionist për vitin 2021 është 1295. Popullsia në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 2021 është 2,829,741 banor. Numri i banorëve/zjarrfikës për vitin 2021 është 2,185 banor (2,829,741 : 1,295 =2,185), duke kaluar 205 banor për zjarrfikës, në kundërshtim me Ligjin 152/2015 òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò neni 7, pika 5.

Sipas Ligjit Nr. 152/2015,òPër Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shërbimin e Shpëtimitò, shumica e kompetencave të shuarjes së zjarrit u transferuan nga prefekturat tek bashkitë, duke lënë në nivel qendror vetëm legjislacionin, trajnimin dhe bashkëpunimin mes strukturave të shuarjes së zjarrit. Sipas Ligjit Nr. 152/2015, Bashkitë janë të detyruara të investojnë në ngritjen e kapaciteteve vullnetare të shuarjes së zjarreve, përveç shërbimit profesional. Por kufizimet buxhetore pengojnë shumë bashki të zhvillojnë programe për shuarjen e zjarrit me vullnetarizëm.

7. Kapacitetet operacionale të përfshira në situatën e zjarreve Korrik- Gusht 2021.

| Prefektura | Forca të Armatosura | Mjete FA | Forca Policore | Mjete MZSH | Forca MZSH | Urgjenca Mjekësore | Forca Vullnetare | AKZM | Forca Bashkiake | Shërbimi Pyjor | Total forca | Total mjete |
|---------------|---------------------|------------|----------------|------------|-------------|--------------------|------------------|------------|-----------------|----------------|--------------|-------------|
| Berat | 130 | 8 | 26 | 8 | 167 | 0 | 75 | 95 | 119 | 8 | 620 | 33 |
| Dibër | 45 | 2 | 18 | 15 | 362 | 0 | 390 | 21 | 271 | 93 | 1200 | 33 |
| Durrës | 0 | 0 | 37 | 7 | 257 | 0 | 66 | 9 | 115 | 18 | 502 | 70 |
| Elbasan | 0 | 2 | 5 | 17 | 259 | 0 | 131 | 0 | 37 | 42 | 474 | 53 |
| Fier | 162 | 8 | 67 | 8 | 725 | 0 | 253 | 14 | 273 | 22 | 1516 | 127 |
| Gjirokastër | 432 | 19 | 108 | 11 | 623 | 7 | 462 | 31 | 296 | 116 | 2068 | 176 |
| Korçë | 132 | 11 | 35 | 15 | 327 | 1 | 46 | 21 | 230 | 54 | 845 | 62 |
| Kukës | 427 | 20 | 0 | 6 | 264 | 0 | 208 | 29 | 92 | 83 | 1103 | 21 |
| Lezhë | 1117 | 40 | 213 | 7 | 423 | 2 | 201 | 0 | 319 | 220 | 2493 | 76 |
| Shkodër | 1049 | 33 | 55 | 17 | 894 | 0 | 275 | 14 | 680 | 283 | 3250 | 126 |
| Tiranë | 100 | 5 | 151 | 20 | 802 | 0 | 126 | 4 | 111 | 27 | 1321 | 166 |
| Vlorë | 2344 | 126 | 38 | 20 | 776 | 17 | 313 | 91 | 425 | 62 | 4049 | 329 |
| Totali | 5938 | 284 | 753 | 151 | 5879 | 27 | 2546 | 329 | 2968 | 1028 | 19441 | 1272 |

Burimi i të dhënave AKMC

8. Nuk ka janë përdorur Kapacitetet e Paralajmërimit të hershëm.

Pasi nuk ka përfunduar (është në proces) rehabilitimi i stacioneve hidrometeorologjike të cilat janë në pronësi të AKMC-së, të cilat do të përdoren për detyra operacionale nga IGJEUM. Njëkohësisht numri i vrojtuesve dhe sinjalizuesve të kontraktura nga njësitë vendore është në nivel të kufizuar.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente deleguar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.44 datë 19.02.2021, në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit, Drejtorit të Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe sektorit të inspektimit.

9. Gjendja e mangët operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret).

Gjendja e mangët operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret), ka krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë. Konkretisht Ministria e Mbrojtjes nga 4 helikopter gjithsej, ka në gjendje operacionale vetëm një helikopter të gatshëm, helikopter i cili është përdorur gjatë operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë gjatë vërës së këtij viti.

Në këtë kontekst, shpenzimi prej 36,069,300 lekë për blerjen e shërbimit me dy helikopter nga shoqëria òV.H.ò nga AKMC, nuk do të ishte kryer në qoftë se Ministria e Mbrojtjes do të kishte përdorur kapacitetet e veta operacionale, si dhe AKMC nuk do të ishte drejtuar Mekanizimit Evropian të Mbrojtjes Civile ERCC, për ndihmë ndërkombëtare, ndihmë e cila ka ardhur nga Shteti Hollandez me 3 mjete Helikopter dhe 76 veta personel, Republika Çeke me 2 mjete Helikopter me 7 veta personel. Gjithashtu USAID ka ofruar asistencë teknike mbi metodat e shuarjes së zjarreve në pyje me 4 veta personel, të cilët lehtësuan procesin e shuarjes së zjarreve në vatrat më kritike të vendit

10. Nuk është krijuar fondi i solidaritetit për mbrojtjen civile (zjarret), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilë, neni 66 òFondi i solidaritetitò, pikat 1, 2, 3 ku është shprehur respektivisht:

“Pika 1. AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond solidariteti, për mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Pika 2. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik.

Pika 3. Fondi i krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, mund t’u transferohet njësitë të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre, sipas legjislacionit në fuqi”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente deleguar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.44 datë 19.02.2021 në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit, Drejtorit të Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe sektorit të inspektimit.

11. Nuk janë kryer inspektime nga AKMC, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilë, neni 67 “Inspektimi”, pikat 1 dhe 2 ku është shprehur respektivisht *Pika 1. Inspektimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji për mbrojtjen civile për institucionet dhe strukturat shtetërore dhe subjektet private kryhet nga inspektorët e AKMC-së, sipas dispozitave ligjore në fuqi për inspektimin.*

Pika 2. Gjatë inspektimeve, inspektorët duhet të shqyrtojnë në veçanti:

a) zbatimin e masave për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen ndaj fatkeqësive dhe rimëkëmbjen e pasojave të tyre;

b) miratimin dhe përditësimin e dokumentit të strategjisë për zvogëlimin riskut nga fatkeqësitë, dokumentit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile;

c) planifikimin e fondeve nga institucionet publike dhe strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese nga fatkeqësitë në objektet dhe infrastrukturën e tyre, sipas fushës së përgjegjësive të tyre shtetërore;

ç) organizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në fushën e veprimtarisë së tyre;

d) krijimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në fushën e përgjegjësive të tyre dhe shkëmbimin e informacioneve me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

dh) zbatimin e detyrimeve ligjore, si edhe udhëzimeve të ndryshme të dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Plan kontrolli nr. 1390/1 prot., datë 25.06.2021 i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm për masat e marra nga Prefektura Fier dhe bashkitë e këtij Qarku, për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, me objekt: zbatimin e masave të marra dhe planet e përgatitura për përballimin e situatave të zjarreve që mund të ndodhin gjatë sezonit të verës, ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për parandalimin e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga zjarret.

Ky program në fund ka përcaktuar se ÷Në përfundim të planit të kontrollit të përgatitet informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara. Për masat të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, ekipi AKMC-së, të vërë detyra konkrete. Në fakt nuk është përgatitur informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente deleguar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.44 datë 19.02.2021 në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit, Drejtorit të Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe sektorit të inspeksionit.

12. Për periudhën objekt auditimi, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, për mbrojtjen civilë, neni 68 "Kundërvajtjet administrative", pikat 1 dhe 2 ku është shprehur respektivisht ÷Pika 1. Shkelja e njëres prej dispozitave të parashikuara në shkronjat "a", "b", "ç" dhe "d", të pikës 1, dhe shkronjat "a" e "b", të pikës 2, të nenit 61, të këtij ligji, nga subjektet private, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) - 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Shkelja e njëres prej dispozitave të parashikuara në pikën 8, të nenit 14; shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "ë", të pikës 2, të nenit 22; shkronjat "a", "c", "ç", "d", "ë", "f", "gj" dhe "h", të pikës 2, të nenit 28; shkronjat "a", "c", "d", "dh", "e", "ë", "g" dhe "gj", të nenit 30; pikat 3 dhe 4, të nenit 42; shkronja "b, e pikës 2, të nenit 43; pikat 2, 3 dhe 5, të nenit 49; pikat 1 dhe 2, të nenit 51; shkronja "ç", e nenit 58, të këtij ligji, nga titullarët e institucioneve shtetërore apo subjektet private, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) - 500 000 (pesëqind mijë) lekë"

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente deleguar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr.44 datë 19.02.2021 në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit, Drejtorit të Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe sektorit të inspeksionit.

| | |
|------------------------------|---|
| 1. Titulli i gjetjes: | Mos përditësimi i akteve nënligjore |
| Situata: | <p>Plani Kombëtar për Emergjencat Civile, është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 385, date 03.12.2004.</p> <p>Institucionet e ngarkuara me ligj për emergjencat civile për 17 vite, periudha viti 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, nuk kanë arritur të përditësojnë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2004 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot. Dokumenti Strategjik i Emergjencave Civile të Shqipërisë deri në miratimin e dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2004, i cili nuk pasqyron rrethana të reja në fushën menaxhimit të emergjencave, përfshirë edhe Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, në rastet si më poshtë:</p> <p>Kreu 1. (1.2) Baza ligjore.</p> <p>Kreu 2. Organizimi i Sistemit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në Shqipëri.</p> <p>Kreu 3.(3.3) Përgjegjësitë për bashkërendimin e emergjencave civile.</p> <p>Kreu 4.(4.3) Masat e përgjithshme për Parandalimin dhe Lehtësimin.</p> <p>Kreu 5.(4.3) Rolet dhe Përgjegjësitë.</p> <p>Kreu 6 Përgjigja.</p> <p>Shtojca B: Baza ligjore, funksionet dhe detyrat e institucioneve etj, të cilat nuk gjejnë mishërim të plani kombëtar i vitit 2004.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 14, pika 2. |
| Ndikimi/Efekti: | Plani i Reagimit Kombëtar nuk ka gjetur zbatueshmëri në shumë intervenime që janë bërë gjatë ndodhjes së fatkeqësive, pasi plani Kombëtar i Emergjencave Civile, është një nga dokumentet kyçe për të zbrëthyer vizionin strategjik në aktivitete praktike. |
| Shkaku: | Mos përfundimi i projektit të ri të Planit Kombëtar për emergjencat Civile nga grupi ndërinstitucional dhe grupi teknik ndërinstitucional i punës, i ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 58, datë 29.06.2021. |
| Rëndësia: | E Lartë |
| Rekomandimi 1.1: | Ska |

| | |
|------------------------------|---|
| 2. Titulli i gjetjes: | Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile. |
| Situata: | <p>Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile. Në veçanti për sigurimin e pronës bujqësore, kullësore nga shoqëritë e sigurimit. Konkretisht: Janë në proces miratimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekt-vendim për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile. -Projekt-vendim për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të |

| | |
|------------------------|--|
| | <p>thirrjeve emergjente 112.</p> <p>-Projekt-vendim për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive.</p> <p>Nuk ka, dhe as në proces akt rregullator, për sigurimin nga zjarri në shoqëritë e sigurimit, për dëm shpërblimin në rast të rënies të zjarrit. Ashtu siç është vepruar me ndërtesat nga tërmeti etj.</p> <p>-Bashkitë dhe Prefekurat përpos njësive të reaguesve të parë, nuk kanë në dispozicion edhe kompani të specializuara për mbrojtjen nga zjarri kontraktuara të cilat asistojnë në aspektin teknik sa herë që kërkohet nga Bashkitë dhe Prefekurat, edhe pse me Ligjin 45/2019, òPër Mbrojtjen Civile, neni 30, pikat e dhe j, neni 58, pika ç; neni 61, pika ë mundësohet angazhimi i subjekteve private.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 72. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos ushtrim i plot nga AKC i përgjegjësive të saj funksionale në mbrojtjen civile në nivel kombëtar. |
| Shkaku: | Neglizhencë e strukturave të larta shtetërore, Ministrisë Mbrojtjes, Prefekurave të Qarqeve, Këshillave Bashkiak dhe Kryetarëve të Bashkive. |
| Rëndësia: | E lartë |
| Rekomandimi : | Sçka |

| | |
|------------------------------|--|
| 3. Titulli i gjetjes: | Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. |
| Situata: | Për periudhën 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Mungesa e këtij dokumenti ka bërë të pamundur parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Pas një viti 1 viti e gjysmës, me urdhër të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021, është ngritur grupi ndërinstitucional dhe grupi teknik ndërinstitucional i punës për përgatitjen Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ky dokument është në proces, pra nuk ka përfunduar deri më deri më datë 10.12.2021 që përfundon auditimit. |
| Kriteri: | Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 10. |
| Ndikimi/Efekti: | Nuk është bërë i mundur parashikimi i fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. |
| Shkaku: | Mos përfundimi i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë nga grupi ndërinstitucional dhe grupi teknik ndërinstitucional i punës, i ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021. |

| | |
|----------------------|---------|
| Rëndësia: | E Lartë |
| Rekomandimi : | Ska |

| | |
|------------------------------|--|
| 4. Titulli i gjetjes: | Nuk ka funksionuar Komisioni Teknik Këshillimor. |
| Situata: | Nuk ka funksionuar Komisioni Teknik Këshillimor i emëruar në zbatim të VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, òPër përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësiveò. Nën drejtimin e AKMC në Ministrinë e Mbrojtjes, krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (në vijim KTK), i cili këshillon për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile. KTK-ja kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC dhe ka në përbërje përfaqësues të Ministrive, të strukturave në vartësi të tyre dhe të institucioneve. Nuk është mbledhur për periudhën janar-gushtë 2021. |
| Kriteri: | VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, òPër përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësiveò, pika 1,3,4. |
| Ndikimi/Efekt: | Risk që vendimmarrjet për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile të mos jenë më të spikatura. |
| Shkaku: | Mos vlerësim sa dhe si duhet nga Drejtori i Përgjithshëm. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandimi | Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për funksionimin e Komisionit Teknik Këshillimor, që në të ardhmen vendimmarrjet për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile të jenë sa më të dobishme. |

| | |
|------------------------------|---|
| 5. Titulli i gjetjes: | Burime njerëzore dhe teknike të pa mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret. |
| Situata: | <p>Niveli qendror dhe lokal nuk ka burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret.</p> <p>-Nga 61 Bashki në shkallë Republike, janë marrë të dhëna në 55 prej tyre, në të cilat raportohen 152 zjarrfikëse. Nga këto 131 në gjendje pune, 8 me defekte të vogla, 3 me defekte të konsiderueshme, 10 jashtë përdorimit dhe 36 të pa targuara (pa dokumentacion). Shumë nga zjarrfikëset në dispozicion janë të vjetruara (disa që datojnë nga vitet gjashtëdhjetë), janë në gjendje të keqe dhe nuk janë të ndërveprueshme sepse janë dhuruar nga vende të ndryshme.</p> <p>- Bashkive dhe njësite administrative u mungojnë pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisje të jashtme për shuarjen e zjarreve, si: Kostume anti zjarr, kundragaz, çizme kundra zjarrit, doreza kundra zjarrit etj. Janë raportuar; Pompa shpine gjithsej 243, nga këto profesionale 221, të zakonshme 22, fikse me pluhur 568, me CO2 92, pompa thithëse 23 dhe pompa të ndryshme 55.</p> <p>Numri i zjarrfikësve profesionist për vitin 2021 është 1295. Popullsia në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 2021 është 2,829,741 banor. Numri i banorëve/zjarrfikës për vitin 2021 është 2,185, duke kaluar 205 banor për zjarrfikës, në kundërshtim me Ligjin 152/2015 òPër</p> |

| | |
|------------------------|--|
| | <p>shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në neni 7, pika 5.</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2015, për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shërbimin e Shpëtimin, shumica e kompetencave të shuarjes së zjarrit u transferuan nga prefekturat tek bashkitë, duke lënë në nivel qendror vetëm legjislacionin, trajnimin dhe bashkëpunimin mes strukturave të shuarjes së zjarrit.</p> <p>Po në zbatim të këtij ligji, Bashkitë janë të detyruara të investojnë në ngritjen e kapaciteteve vullnetare të shuarjes së zjarreve, përveç shërbimit profesional. Por kufizimet buxhetore pengojnë shumë bashki të zhvillojnë programe për shuarjen e zjarrit me vullnetarizëm.</p> |
| Kriteri: | Ligji 152/2015, për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, neni 7, pika 5. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos ushtrim i plotë nga AKMC i përgjegjësive të saj funksionale në mbrojtjen nga zjarri në nivel kombëtar. |
| Shkaku: | Mos vëmendje e duhur institucionale në nivel qendror dhe lokal. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandimi | Nga Drejtori i Përgjithshëm ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore dhe teknike për menaxhimin efektiv dhe reagimin ndaj situatave emergjente (zjarret). |

| | |
|------------------------------|--|
| 6. Titulli i gjetjes: | Nga AKMC nuk janë përdorur Kapacitetet e Paralajmërimit të hershëm. |
| Situata: | <p>Nga AKMC, nuk ka janë përdorur Kapacitetet e Paralajmërimit të hershëm.</p> <p>Deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, nuk është realizuar (është në proces) rehabilitimi i stacioneve hidrometeorologjike të cilat janë në pronësi të AKMC-së, që do të përdoren për detyra operacionale nga IGJEUM. Njëkohësisht numri i vrojtuesve dhe sinjalizuesve të kontraktura nga njësitë vendore është në nivel të kufizuar.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 45/2019, për mbrojtjen civile, neni 8. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos vënia në eficiencë e sistemit të sinjalizimit krijon pamundësi për ndërhyrjen në kohë ndaj situatave emergjente të fatkeqësive natyrore. |
| Shkaku: | Mungesë fondesh . |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandimi | Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për rehabilitimi i stacioneve hidrometeorologjike, për të siguruar menaxhimin efektiv për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus zjarret. |

| | |
|------------------------------|---|
| 7. Titulli i gjetjes: | Gjendja e mangët operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret). |
| Situata: | Gjendja e mangët operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret), ka krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë. Konkretisht Ministria e Mbrojtjes nga 4 helikopter gjithsej që ka për emergjencat civile (zjarret), ka në gjendje operacionale vetëm një helikopter të gatshëm, helikopter i cili është përdorur gjatë operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë gjatë vërës |

| | |
|------------------------|--|
| | së këtij viti. Në këtë kontekst, shpenzimi prej 36,069,300 lekë për blerjen e shërbimit me dy helikopter nga shoqëria òV.H.ò nga AKMC, nuk do të ishte kryer në qoftë se Ministra e Mbrojtjes do të kishte përdorur kapacitetet e veta operacionale, si dhe AKMC nuk do të ishte drejtuar Mekanizimit Evropian të Mbrojtjes Civile ERCC, për ndihmë ndërkombëtare, ndihmë e cila ka ardhur nga Shteti Hollandez me 3 mjete Helikopter dhe 76 veta personel, Republika Çeke me 2 mjete Helikopter me 7 veta personel. Gjithashtu USAID ka ofruar asistencë teknike mbi metodat e shuarjes së zjarreve në pyje me 4 veta personel, të cilët lehtësuan procesin e shuarjes së zjarreve në vatrat më kritike të vendit. |
| Kriteri: | Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civileò, neni 22. |
| Ndikimi/Efekti: | Shpenzim në vlerën 36,069,300 lekë. |
| Shkaku: | Mangësi operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret)? |
| Rëndësia: | E Lartë. |
| Rekomandimi | Ska. |

| | |
|------------------------------|---|
| 8. Titulli i gjetjes: | Nuk është krijuar fondi i solidaritetit. |
| Situata: | Nuk është krijuar fondi i solidaritetit për mbrojtjen civile (zjarret), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civileò, neni 66 òFondi i solidaritetitò, pikat 1, 2, 3 ku është shprehur respektivisht. òPika 1. AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond solidariteti, për mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të këtij ligji. Pika 2. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik. Pika 3. Fondi i krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, mund t'ua transferohet njërive të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre, sipas legjislacionit në fuqiò. |
| Kriteri: | Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civileò, neni 66. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos përfitim fonde për përballimin e situatave emergjente. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandimi | Nga AKMC-ja, të merren masa për të krijuar fondin e solidaritetit nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, për përballimin e situatave emergjente, si dhe të bëhen transparente të gjitha proceset e krijimit të këtij fondi. |

| | |
|------------------------------|---|
| 9. Titulli i gjetjes: | Nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri. |
|------------------------------|---|

| | |
|------------------------|---|
| Situata: | <p>Për periudhën objekt auditimi nga AKMC, nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar Plan kontrolli nr. 1390/1 prot., datë 25.06.2021 òPër masat e marra nga Prefektura Fier dhe bashkitë e këtij Qarku, për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, me objekt: zbatimi masave të marra dhe planet e përgatitura për përballimin e situatave të zjarreve që mund të ndodhin gjatë sezonit të verës, ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për parandalimin e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga zjarret. Sipas këtij Programi është kërkuar që:</p> <p>òNë përfundim të planit të kontrollit të përgatitet informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara. Për masat të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, ekipi AKMC-së, të vërë detyra konkret. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nuk është përgatitur informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 67 òInspektimi, pikat 1 dhe 2. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos ushtrim i përgjegjësive nga ana e ... |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E Lartë. |
| Rekomandimi | Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për kryer inspektime në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësive të tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri. |

| | |
|-------------------------------|--|
| 10. Titulli i gjetjes: | Nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021. |
| Situata: | Për periudhën objekt auditimi, në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësive të tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021. |
| Kriteri: | Ligji nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 68 “Kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos ushtrim i përgjegjësive Institucionale |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandimi | Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për ushtrim të plot të përgjegjësive të Tij funksionale ndaj strukturave qendrore dhe vendore për mos marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësive të tyre |

2.2. Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i programit ekonomik.

Buxhetit fillestar i miratuar me ligjin e buxhetit për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për vitin 2020 dhe 2021, paraqitet në tabelën si më poshtë:

| PROGAMI BUXHETOR | EMËRTIMI Emergjencat Civile-Totali | LLOGARIA EKONOMIKE | LIGJI 88 18.12.2019 Programi buxhetor 2020 | LLIGJI NR. 137 DT 16.12.2020 Programi buxhetor 2021 |
|------------------|---|---------------------|--|--|
| AKMC | Paga | 600 | - | 100,000 |
| | Sigurime Shoqërore | 601 | - | 17,000 |
| 10910 | Mallra e shërbime | 602 | 54,262 | 55,000 |
| | | 603 | | - |
| | Subvencione | 604 | 130,000 | 115,000 |
| | Transferta Korente të Brendshme | 605 | 4,000 | 4,000 |
| | Trans për Buxh. Familja & Individ | 606 | - | - |
| | Kapitale të Trupëzuara (financim I brendshëm) | 231 | 10,000 | 400,000 |
| | Kapitale të Trupëzuara | 231/Financim i huaj | 119,250 | 300,000 |
| | TOTALI | | 317,512 | 991,000 |

Burimi i të dhënave AKMC

Realizimi i Buxhetit për AKMC për vitin 2020 dhe fakti për periudhën objekt auditimi 2021, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Në 000/lekë

| Nr | Emërtimi | Llog. ekonomike | Viti 2020 | | | | Janar-30 Nëntor 2021 | | | |
|----|-----------------------------------|-----------------|----------------|--------|--------|---------|----------------------|-------------------|--------|---------|
| | | | Plan Fillestar | Plan | Fakt | Real. % | Plan Fillestar | Plan me ndryshime | Fakt | Real. % |
| 1 | Paga | 600 | 29,000 | 13,000 | 11,236 | 86 | 100,000 | 56,000 | 42,407 | 76 |
| 2 | Sigurime Shoqërore | 601 | 6,000 | 3,500 | 1,862 | 53 | 17,000 | 14,600 | 7,042 | 48 |
| 3 | Mallra e shërbime | 602 | 54,262 | 31,262 | 2,390 | 8 | 55,000 | 87,830 | 44,528 | 51 |
| 4 | Transferta Korente të Brendshme | 604 | 130,000 | 500 | - | - | 115,000 | 63,046 | - | 0 |
| 5 | Transferta Korente të Huaja | 605 | 4,000 | 4,000 | 3,120 | 78 | 4,000 | 4,000 | 3,093 | 77 |
| 6 | Trans për Buxh. Familja & Individ | 606 | - | - | - | - | - | 370 | 198 | 54 |
| 7 | Kapitale të Trupëzuar | 231 | - | - | - | - | 400,000 | 300,000 | 27,955 | 9 |

| | | | | | | | | | | |
|-----------------------------------|--|-------------|------------|--------|----|-------------|---------|-------------|----|--|
| a (financim I brendshëm) | | | | | | | | | | |
| Totali | | 223,26 2 | 52,26 2 | 18,608 | 36 | 691,00 0 | 525,846 | 125,22 3 | 24 | |

Burimi i të dhënave AKMC

Konkluzion:

Nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente nuk është përgatitur Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI) (projektet, preventivat dhe dokumentacioni ligjor) për projektet prioritare të investimit për vitin 2021 dhe 2022). Për projektin kryesor të investimit ÷Fatkeqësi natyrore të menaxhuara me vlerë 280,073 mijë lekë për vitin 2021. Drejtorja e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, ka dërguar me 1 vit vonesë Formularin e Propozimit të Projektit të Investimit, konkretisht me shkresën nr. 1892/1, datë 30.08.2021 në Ministrinë e Mbrojtjes me subjekt ÷Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja duke e bërë praktikisht të pamundur realizimin e këtij investimi prioritar dhe mos përdorimin e fondit. Konstatohet se janë kryer ndryshime të vazhdueshme, ku për vitin 2020 janë kryer 2 shtesa/pakësime në vlerën 35,000 mijë lekë, për vitin 2021 janë kryer 6 shtesa/pakësime në vlerën 300,250 mijë lekë, tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit si edhe atë të përlogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së AKMC, tregojnë se planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Sa më sipër nuk janë zbatuar:

- Ligji nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9.
- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 4, neni 19.
- Udhëzimi Nr.7 datë 28.02.2028, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 2.5.
- VKM nr.128, datë 07.03.2018, “Për miratimi e tavaneve Përgatitore të shpenzimeve të PBA 2019-2021”, pika 3.

Veprimi cili ngarkon me përgjegjësi H.Ç me e detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente.

| | |
|-----------------------------|--|
| 1. Titulli i gjetjes | Raportimi jashtë afateve ligjore. |
| Situata | Nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, nuk është përgatitur Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI) (projektet, preventivat dhe dokumentacioni ligjor) për projektet prioritare të investimit për vitin 2021 dhe 2022). Për projektin kryesor të investimit ÷Fatkeqësi natyrore të |

| | |
|-----------------------|---|
| | menaxhuarao me vlerë 280,073 mijë lekë për vitin 2021. Nga drejtoria e sipër cituar është dërguar 1 vit vonesë, konkretisht me shkresën nr. 1892/1, datë 30.08.2021 në Ministrinë e Mbrojtjes me subjekt oMbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytjao duke e bërë praktikisht të pamundur realizimin e këtij investimi prioritar dhe mos përdorimin e fondit. |
| Kriteri | Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëo i ndryshuar; Udhëzimi nr. 8, datë 29.03.2012 oPër procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, pika 33, pika 35 dhe gërma (l) e pikës 39. |
| Ndikimi/Efekti | Krijon risk për mos monitorimin në kohë të buxhetit. |
| Shkaku | Keq interpretim të dispozitave ligjore në fuqi. |
| Rëndësia | E mesme. |
| Rekomandimi | AKMC, Drejtoria e rehabilitimit, rimëkëmbjes dhe kompensimit nga fatkeqësitë të marrë masat që në të ardhmen për projektet prioritare të investimeve, të përgatisë dhe dërgojë brenda afateve ligjore formularët e propozimeve të projekteve. |

| | |
|-----------------------------|--|
| 2. Titulli i gjetjes | Nuk është kryer një planifikim i saktë, ku tã referohej kërkesave reale buxhetore. |
| Situata | Për vitin 2020 janë kryer 2 shtesa/pakësime në vlerën 35,000 mijë lekë, për vitin 2021 janë kryer 6 shtesa/pakësime në vlerën 300,250 mijë lekë, tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së AKMC tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. |
| Kriteri | Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëo i ndryshuar. |
| Ndikimi/Efekti | Mos eficiency në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për AKMC. |
| Shkaku | Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese. |
| Rëndësia | E mesme. |
| Rekomandimi | Nga ana e AKMC të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve |

2.3. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Marrëdhëniet e punës në AKMC-së në nivel qendror dhe vendor janë të rregulluara me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, òPër nëpunësin civilò i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ në nivel qendror dhe vendor i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò i ndryshuar. Me Urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021, të Ministrit të Mbrojtjes protokolluar në AKMC me nr. 1226/2 prot., datë 25.06.2021, është miratuar Rregullorja òPër metodat e brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të AKMC në nivel qendror dhe vendorò, afërsisht me 10 muaj vonesë nga krijimi i kësaj njësie shpenzuese.

-Procedurat e rekrutimit për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil:

Rekrutimi në Shërbim Civil është bazuar në planifikimin e nevojave institucionale për burimet njerëzore. Në zbatim të nenit 18, të Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, òPër nëpunësin civilò i ndryshuar, dhe VKM nr. 108, datë 26.02.2014, òPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civilò, ku brenda muajit tetor të çdo viti institucionet e varësisë hartojnë dhe paraqesin planin e nevojave për rekrutimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë.

Njësia e burimeve njerëzore në Ministri, mbështetur në planin e nevojave të institucioneve të varësisë dhe aparatit të ministrisë, harton planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për sistemin ministror dhe e paraqet për miratim pranë Sekretarit të Përgjithshëm. Pas miratimit, plani i konsoliduar i nevojave për rekrutim dërgohet brenda muajit nëntor në Departamentin e Administratës Publike (DAP).

DAP deri në fund të muajit dhjetor, harton projektvendimin për planifikimin vjetor të pranimit për administratën shtetërore, i cili propozohet Këshillit të Ministrave deri në fund të muajit janar. Pas miratimit të planit të nevojave për administratën shtetërore, DAP nis procesin e rekrutimit, pra shpalljen e vendeve vakante dhe administrimin e procedurave të seleksionimit për çdo kategori të shërbimit civil.

-Procesi i rekrutimit dhe emërimeve për punonjësit mbështetës (me kontratë):

Ky proces realizohet nga Ministria e Mbrojtjes në zbatim të nenit 13, pika 2, gërma òshò, të Ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014, òPër pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: òEmëron, liron, ose shkarkon nga detyra personelin civil në strukturat civile të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, përveç atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civilò.

Burimet e financimit për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, janë fondet e Buxhetit të Shtetit të miratuara respektivisht me Ligjin nr. 88/2019, datë 18.12.2019, òPër buxhetin e vitit 2020ò i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 137/2020, datë 16.11.2020, òPër buxhetin e vitit 2021ò.

Për periudhën e audituar (nga data 01.09.2020, deri më 10.12.2021), struktura organizative nuk ka pësuar ndryshime rrënjësore. Kjo situatë krijon mundësimin e lehtë për parashikimin e fondit të pagave dhe taksa mbi to, në çdo fund viti diferencat mes fondit të parashikuar dhe fondit të alokuar për paga dhe taksa mbi to, janë me një përqindje të ulët. Struktura, planifikimi dhe realizimi i fondeve të pagave të AKMC-së, të dhënat të trajtuara si më poshtë:

000/lekë

| Programi buxhetor viti 2020 | | | | |
|---|----------|---------|--------|-------------------------------|
| Përshkrimi | Llogaria | Pakësim | Shtesa | Fondi për paga dhe kontribute |
| Shkresa nr. 28, datë 02.07.2020, òPër disa ndryshime në Ligjin nr. 88/2019, datë 18.12.2019, òPër buxhetin e vitit 2020ò. | 600 | 0 | 29,000 | |
| | 601 | 0 | 6,000 | |

| | | | | | |
|---|-----------------|------------------|----------------|---------------|--------------------------------------|
| Shkresa nr. 5160/1 prot., datë 10.12.2020, òNjoftim mbi VKM nr. 926, datë 25.11.2020, òPër rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2020, ndërmjet Ministrive dhe Institucioneve Buxhetoreë. | 600 | 10,000 | 0 | | |
| | 601 | 0 | 0 | | |
| Shkresa nr. 5642/2 prot., datë 13.01.2021, òNjoftim mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 34, datë 16.12.2020ë. | 600 | 6,000 | 0 | | |
| | 601 | 2,500 | 0 | | |
| Totali | | 18,500 | 35,500 | 17,000 | |
| Programi buxhetor viti Janar-Nëntor | | | | | |
| Përshkrimi | Llogaria | Fillestar | Pakësim | Shtesa | Fondi për paga dhe kontribute |
| Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020, òPër buxhetin e vitit 2021ë | 600 | 100,000 | 44,000 | 0 | |
| | 601 | 17,000 | 2,400 | 0 | |
| Totali | | 117,000 | 0 | 46,400 | 70,600 |

Burimi i të dhënave: Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

000/lekë

| Programi buxhetor viti 2020 | Struktura mesatarisht | Emërtimi | Llogaria | Plani me ndryshime | Realizimi faktik 12 mujori | Mbetje | Realizimi në % |
|-------------------------------------|-----------------------|--------------------|----------|--------------------|----------------------------|---------------|----------------|
| | | Paga | 600 | 13,000 | 11,236 | 1,764 | 86% |
| AKMC 10910 | 46 | Sigurime shoqërore | 601 | 3,500 | 1,862 | 1,638 | 53% |
| Totali | | | | 16,500 | 13,098 | 3,402 | 79% |
| Programi buxhetor viti Janar-Nëntor | Struktura mesatarisht | Emërtimi | Llogaria | Plani me ndryshime | Realizimi faktik 11 mujori | Mbetje | Realizimi në % |
| | | Paga | 600 | 56,000 | 46,601 | 9,399 | 83% |
| AKMC 10910 | 52 | Sigurime shoqërore | 601 | 14,600 | 7,741 | 6,859 | 53% |
| Totali | | | | 70,600 | 54,342 | 16,258 | 77% |

Burimi i të dhënave: Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura, rezulton një tepriçë fondesh në shumën totale 16,258 mijë lekë, por theksojmë se kjo periudhë nuk përfshin muajin dhjetor të vitit 2021. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të strukturës organizative (nga 106 në 52).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, listë pagesat për periudhën objekt auditimi, rakordojnë me urdhër shpenzimet e Degës së Thesarit Tiranë së bashku me dokumentacionin bankar. Listë pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, janë deklaruar në sistemin tatimor. Punonjësit janë të deklaruar në sistemin tatimor sipas vendimeve të emërimit të punonjësve të dala nga Sektori i Burimeve Njerëzore të institucionit.

Këto deklarime në sistemin tatimor nga AKMC paraqiten në mënyrë të përmbledhur konkretisht si më poshtë:

lekë

| Viti | Paga bruto | Paga për sigurime shoqërore | Sigurime shoqërore | | Sigurime shëndetësore | | Sigurim Suplement PM | TAP |
|-------------------|------------|-----------------------------|--------------------|-----------|-----------------------|-----------|----------------------|-----------|
| | | | Shoq. PDH | Shoq. PM | Shënd. PDH | Shënd. PM | | |
| Viti 2020 | 13,936,000 | 13,813,852 | 2,072,079 | 1,312,323 | 236,903 | 236,908 | 444,155 | 956,810 |
| Janar-Nëntor 2021 | 43,880,157 | 43,787,849 | 6,568,184 | 4,159,848 | 739,829 | 739,837 | 1,366,840 | 3,388,329 |

Burimi i të dhënave: Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Referuar Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, òPër mbrojtjen civileë, dhe VKM nr. 747, datë 20.11.2019, òPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civileë, neni 4, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020, është miratuar struktura organizative për vitin 2020, së bashku me nivelin e pagave, në total me numër punonjësish 106 nga të cilët 94 punonjës në drejtorinë e përgjithshme dhe 12 punonjës në nivel vendor në qarqe, si dhe në zbatim të VKM nr. 747, datë 20.11.2019, Kreu IV, pika 3, përcakton se: òDeri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, struktura aktuale vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës së miratuarë.

AKMC në lidhje me caktimin e nivelit të pagave është bazuar në referencat e parashikuara në VKM nr. 187, datë 08.03.2017, òPër miratimin e strukturës dhe të nivele të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektitò.

Pagat janë të grupuara në katër nivele për secilin pozicion pune konkretisht niveli I, II, III dhe IV dhe secili pozicion ka një limit të përcaktuar. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me procedurat të cilat janë ndjekur nga AKMC për mbajtjen e pagave konstatohet se:

Listë pagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rastit), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndale (suplementari në nivel 3% dhe 4% sipas rastit, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale është 32,000 lekë paga maksimale 118,100 lekë në përputhje me VKM nr. 1025, datë 16.12.2020, òPër përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendiò. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

- Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave konstatohet se për katër punonjës ish-ushtarak, që kanë përfunduar studimet e universitare në Shkollën e Lartë të Bashkuar Tiranë sistemim tre vjeçar, nga AKMC janë klasifikuar në kategorinë e sistemit katër vjeçar (master shkencor). Duke u bazuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 2012, datë 11.12.2015, òMiratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake në viteò, tabela 1 dhe 2, këto diploma ekuivalentohen si Bachelor. Në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, këta punonjës duhen të trajtohen me vlerën 10,000 lekë në muaj dhe jo në vlerën 14,000 lekë në muaj që i ka trajtuar AKMC-ja. Kjo praktikë është korrigjuar nga muaji mars 2021 dhe në vazhdim, ku këta punonjës janë trajtuar me vlerën 10,000 lekë në muaj në përputhje me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes. Për muajt gusht 2020 - shkurt 2021 kjo diferencë është në vlerën **78,044 lekë** e cila për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit përbën **efekt negativ në administrimin e fondeve publike për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike**. Në mënyrë të përmbledhur të dhënat paraqiten si më poshtë:

Në lekë

| Emër Mbiemër | Arsimi | Pagesat mbi klasifikimin e diplomave | Viti 2020 | | | | | Viti 2021 | | Diferenca |
|--------------|---|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|-----------|----------|-----------|
| | | | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | |
| Behar Gjoni | Shkolla e Lartë e Bashkuar Tiranë sistemi tre vjeçar përfunduar studimet në vitin 1985. | Sipas listë pagesave (klasifikimi i diplomës) vlera e përfituar | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 0 | 0 | 20,000 |
| | | Sipas urdhrit nr. 2012, datë 11.12.2015, (klasifikimi i diplomës) vlera e cila duhet të përfitonte | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 0 | 0 | |
| | | Diferenca | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 0 | 0 | |
| Tonin | Shkolla e Lartë e Bashkuar Tiranë sistemi tre vjeçar përfunduar studimet në vitin | Sipas listë pagesave (klasifikimi i diplomës) vlera e përfituar | 0 | 3,181 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 15,681 |
| | | Sipas urdhrit nr. | 0 | 2,500 | 11,000 | 11,000 | 11,000 | 11,000 | 11,000 | |

| | | | | | | | | | | | |
|----------------------------|---|--|----------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|--------------|
| Prendi | 1986. | 2012, datë 11.12.2015, (klasifikimi i diplomës) vlera e cila duhet të përfitonte | | | | | | | | | |
| | | Diferenca | 0 | 681 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | |
| Kastriot Llakaj | Shkolla e Lartë e Bashkuar Tiranë sistemi tre vjeçar përfunduar studimet në vitin 1982. | Sipas listë pagesave (klasifikimi i diplomës) vlera e përfituar | 0 | 5,090 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 21,454 | |
| | | Sipas urdhrit nr. 2012, datë 11.12.2015, (klasifikimi i diplomës) vlera e cila duhet të përfitonte | 0 | 3,636 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | | 10,000 |
| | | Diferenca | 0 | 1,454 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | | 4,000 |
| Luan Gjonaj | Shkolla e Lartë e Bashkuar Tiranë sistemi tre vjeçar përfunduar studimet në vitin 1982. | Sipas listë pagesave (klasifikimi i diplomës) vlera e përfituar | 0 | 3,181 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 20,909 | |
| | | Sipas urdhrit nr. 2012, datë 11.12.2015, (klasifikimi i diplomës) vlera e cila duhet të përfitonte | 0 | 2,272 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | | 10,000 |
| | | Diferenca | 0 | 909 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | | 4,000 |
| Totali i diferencës | | | | | | | | | | 78,044 | |

Burimi i të dhënave: Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Nga auditimi me zgjedhje i 30 dosjeve të personelit (51% prej tyre) për periudhën e audituar, dokumentacioni në përgjithësi është i plotë. Pjesë përbërëse e dosjes janë kartat e identitetit, certifikatat familjare, dëftesa/diplomat e studimeve të kryera (fotokopje të noterizuara), listë notash, vërtetimet shëndetësore dokumente shtesë për grada e tituj shkencorë, për kurset e trajnimit, gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti etj. AKMC në lidhje me përshkrimin e punës bazohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, òPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò.

-Departamenti i Administratës Publike në tre rast ka kryer emërime në kundërshtim me kriteret e posaçme të pozicioneve të punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të depozituara në DAP konkretisht:

a). A.B. emëruar me shkresën nr. 1055/3 prot., datë 01.10.2020, sipas Urdhrit nr. 65, datë 01.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm H.Ç., bazuar në shkresën nr. 4374/3 prot, datë 29.09.2020, dhe nr. 4374/2 prot, datë 29.09.2020, të Departamentit të Administratës Publike, në pozicionin òSpecialistò në Sektorin (Qendra) Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizmit, në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Ka përfunduar studimet e larta në sistemin 4 vjeçar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Dega Histori titulli Specialist Historie. Emëruar në kundërshtim me formularin e përshkrimeve të punës, të miratuar nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes , Kreu XII òKërkesat e posaçmeò, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: òTë zotërojë diplomë të nivelit “Master profesional” në shkenca edukimi, shkenca sociale, shkenca ekonomike, arsim të lartë ushtarak/polikor, arsim i lartë në fushën e mbrojtjes/emergjencave civile. Dhe diploma bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushëò.

b). G.H. emëruar me shkresën nr. 969/1 prot., datë 23.09.2020, sipas Urdhrit nr. 55, datë 23.09.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm H.Ç., bazuar në shkresën nr. 4193/5 prot, datë

14.09.2020, të Departamentit të Administratës Publike, në pozicionin ÷Specialistë në Qendrën e Mbrojtjes Civile për Qarqet Elbasan, Berat dhe Korçë, me në qendër Korçë. Ka përfunduar studimet e larta cikli 4 vjeçar në Fakultetin e Gjeologji Minierash në degën Gjeologji Xeherore, Inxhinier Gjeolog. Emëruar në kundërshtim me formularin e përshkrimeve të punës, të miratuar nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes , Kreu XII ÷Kërkesat e posaçmeë, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: ÷Të zotëroj diplomë të nivelit ÷Bachelorë në arsim të lartë ushtarak/politor, shkenca ekonomike, inxhinieri mjedis-pyjore, inxhinier ndërtimi, arsim i lartë në fushën e mbrojtjes/emergjencave civileë.

c). M.Sh. emëruar me shkresën nr. 392/1 prot., datë 18.02.2021, sipas Urdhrit nr. 33, datë 18.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm H.Ç., bazuar në shkresën nr. 1140 prot, datë 15.02.2021, të Departamentit të Administratës Publike, në pozicionin ÷Specialisteë në sektorin e programeve dhe strategjive në drejtorinë e zvogëlimit të riskut dhe fatkeqësive dhe parandalimit. Ka përfunduar studimet Bachelor Drejtësi dhe Master Profesional të Drejtë Publike. Emëruar në kundërshtim me formularin e përshkrimeve të punës, të miratuar nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Kreu XII ÷Kërkesat e posaçmeë, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: ÷Të zotëroj diplomë të nivelit ÷Master Profesionalë në shkenca ekonomike, inxhinieri mjedisi, inxhinieri ndërtimi, inxhinieri hidrologjike-gjeologji, inxhinieri pyjore, inxhinieri kimike, arsim i lartë në fushën e mbrojtjes/emergjencave civile. Edhe diploma ÷Bachelorë duhet të jetë në të njëjtën fushëë.

-Struktura organizative e AKMC nuk është plotësuar konkretisht nga 106 pozicione të miratuara, në fakt janë punësuar 58 punonjës me një diferencë prej 48 punonjësish.

Në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, ÷Për mbrojtjen civileë, VKM nr. 747, datë 20.11.2019, ÷Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare Të Mbrojtjes Civileë, dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.27, datë 03.02.2020, ÷Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civileë, në datën 03.02.2020 nisi procesi për funksionalizimin e AKMC-së. Procesi i funksionalizimit të AKMC-së konsiston në dy elementë kryesorë:

1. Plotësimin me personel të strukturës organike të AKMC-së;
 2. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme (zyra, mjete dhe pajisje);
- Aktualisht, struktura organike e AKMC është plotësuar në masën 54.7 %.

Plotësimi me personel i strukturës organike të AKMC

Aktivitetet e kryera për plotësimin me personel:

1. Në muajin prill 2020 ka përfunduar procesi i hartimit të përshkrimeve të punës dhe planit të nevojave për rekrutim, si dhe janë dërguar pranë DAP fillimin e procesit të rekrutimit;
2. Në muajin Maj 2021 ka përfunduar rishikimi i projekt-rregullores së brendshme të AKMC;
3. Gjatë periudhës 2020-2021, janë plotësuar 58 pozicione pune (54.7%) nga 106 që janë gjithsej në strukturën organike të AKMC;

Aktualisht plotësimi i strukturës organike të AKMC është si më poshtë:

| Kategoritë e nëpunësve | | Numri organik | Numri faktik | Diferenca |
|------------------------------------|-------------|---------------|--------------|-----------|
| Organika nivel qendror | | | | |
| Nivel i lartë drejtues (Titullari) | II-a | 1 | 1 | 0 |
| Nivel i mesëm drejtues | II-b | 5 | 2 | 3 |
| Nivel i ulët drejtues | III-a | 12 | 3 | 9 |
| Nivel i ulët drejtues | III-a/1 | 9 | 3 | 6 |
| Nivel ekzekutiv (specialist) | III-b | 39 | 30 | 9 |
| Nivel ekzekutiv (specialist) | IV-a | 12 | 7 | 5 |
| Nivel ekzekutiv (specialist) | IV-b | 3 | 2 | 1 |
| Punonjës administrativ | me kontratë | 13 | 4 | 9 |

| | | | | |
|------------------------------------|-------|------------|-----------|-----------|
| Struktura organike gjithsej | | 94 | 52 | 42 |
| Organika nivel vendor | | | | |
| QMCQ | | | | |
| Drejtor qendre | III-a | 4 | 0 | 4 |
| Nivel ekzekutiv (specialist) | IV-a | 8 | 6 | 2 |
| Struktura organike gjithsej | | 12 | 6 | 6 |
| Totali | | 106 | 58 | 48 |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Për sa i përket proceseve gjyqësore në lidhje me ndërprerjet e marrëdhënieve të punës për punonjësit e AKMC-së për periudhën e audituar rezulton se, AKMC nuk ka zhvilluar ose si palë e paditur në asnjë proces gjyqësor.

| | |
|------------------------------|--|
| 1. Titulli i gjetjes: | Diferencë në ekuivalentimin e diplomave për punonjësit ish-ushtarak me efekt në vlerën 78,044 lekë. |
| Situata: | Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave konstatohet se për katër punonjës ish-ushtarak, që kanë përfunduar studimet e universitare në Shkollën e Lartë të Bashkuar Tiranë sistemim tre vjeçar, nga AKMC janë klasifikuar në kategorinë e sistemit katër vjeçar (master shkencor). Duke u bazuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 2012, datë 11.12.2015, ÷Miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake në viteö, tabela 1 dhe 2, këto diploma ekuivalentohen si Bachelor. Në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, këta punonjës duhen të trajtohen me vlerën 10,000 lekë në muaj dhe jo në vlerën 14,000 lekë në muaj që i ka trajtuar AKMC-ja. Kjo praktikë është korrigjuar nga muaji mars 2021 dhe në vazhdim, ku këta punonjës janë trajtuar me vlerën 10,000 lekë në muaj në përputhje me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes. Për muajt gusht 2020 - shkurt 2021 kjo diferencë është në vlerën 78,044 lekë e cila për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike. |
| Kriteri: | Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 2012, datë 11.12.2015, ÷Miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionit ushtarake në viteö, Tabela 1 dhe 2. |
| Ndikimi/Efekti: | Efekt negativ financiar në vlerën 78,044 lekë. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandimi: | Nga Drejtori i Përgjithshëm të analizohet vlera 78,044 lekë , vlerë e cila ka të bëjë me mos përcaktimin e saktë të statusit të klasifikimit dhe ekuivalentimit të diplomave universitare për punonjësit ish-ushtarak dhe ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen. |

| | |
|------------------------------|---|
| 2. Titulli i gjetjes: | DAP në tre rast ka kryer emërimë në kundërshtim me kriteret e posaçme të pozicioneve të punës. |
| Situata: | Departamenti i Administratës Publike në tre rast ka kryer emërimë në kundërshtim me kriteret e posaçme të pozicioneve të punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të depozituara në DAP. |

| | |
|------------------------|---|
| Kriteri: | Formulari i Përshkrimeve të Punës të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Kreu XII òKërkesat e posaçmeò. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos efektivitet në përdorim e burimeve njerëzore |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandimi: | Drejtori i Përgjithshëm të depozitoj në DAP kriteret e posaçme të pozicioneve të punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të kërkoj që emërimet e nëpunësve civil të kryhen në zbatim të këtyre kriterëve, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen. |

| | |
|------------------------------|---|
| 3. Titulli i gjetjes: | AKMC ushtron aktivitetin e saj me strukturë organizative të pa plotësuar. |
| Situata: | Për periudhën objekt auditimi AKMC ushtron aktivitetin e saj me strukturë organizative të pa plotësuar. Konkretisht nga 106 pozicione të miratuara, në fakt janë punësuar 58 punonjës me një diferencë prej 48 punonjësish. |
| Kriteri: | Urdhri i Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020, është miratuar struktura organizative për vitin 2020. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos përmbushja e përgjegjësive funksionale të AKMC, në mbrojtjen civile në nivel kombëtar |
| Shkaku: | Neglizhencë e DAP |
| Rëndësia: | E lartë |
| Rekomandimi: | Drejtori i Përgjithshëm ti kërkoj DAP nisjen e procesit të rekrutimit, pra shpalljen e vendeve vakante dhe administrimin e procedurave të seleksionimit për çdo kategori për të plotësuar strukturë organizative të AKMC. |

2.4. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Në zbatim të pikës nr. 4, të programit të auditimit nr. 851/1 prot., datë 04.08.2021, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit me nr. 13506 prot., datë 21.07.2020, për konfirmimin e nëpunësit Autorizues z. H.Ç. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe shkresën nr. 13505 prot., datë 21.07.2020 për konfirmimi e nëpunësit Zbatues të znj. R.R. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Kontabiliteti financiar (Ditari kontabël i shpenzimeve bankare).

-Urdhër shpenzimet (Shpenzimet me anë të bankës), të kaluara nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua:

Veprimet financiare janë regjistruar në regjistrat e kontabilitetit, bazuar në dokumente vërtetues. Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatorë si më poshtë:

Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 11.12.2020 për vlerën 120,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar shoqëria òD.A.òSh.a me NIPT K58007301A. Ky shpenzim ka të bëjë shërbim makine

(pjesë këmbimi dhe bateri). Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6023200. Ky shpenzim është klasifikuar blerje me vlerë të vogël òRast emergjentò, formulari nr.4. Me rast emergjent datë 27.11.2020 në dalje të Kamzës, si pasojë e mosfunksionimit të pedalit të fraksionit, i cili ngeli shtypur dhe mjeti nuk bënte ndryshimin e marsheve.

Formulari 4, është firmosur nga F.K. me detyrë specialiste tek sektori prokurimeve me profesion juriste, F.B. me detyrë specialiste tek financa me profesion ekonomiste dhe R.B. me detyrë sektori i prokurimeve me profesion jurist.

Procesverbal i datës 27.11.2020 K.N. dhe J.H. , për makinën Hynday me targë AB 253 BM, defekt në rrugë- fleksion ngelur shtypur, nuk ndërrohen marshet.

-Fatura tatimore shitje 321561013, datë 03.12.2020 të lëshuar nga shoqëria òD. A.ò sh.a e firmosur nga F.B., R.B. dhe F.K. për shitësin me firmë sigël, pa emër dhe mbiemër, për vlerën 120,000 lekë. Në fakt duhej firmosur nga personat e ndodhur në udhëtim në (K.N. dhe J.H.)

Kjo faturë ka 14 artikuj të pjesëve të këmbimit: Gomina grushti, kuzhinet gome krahu, pulexh dinamo, vaj motori, filtër ajër, filtër naftë, filtër vaji, filtër kondicioneri, tambure te par, tambure e pasme, ferrota të para, voland dhe kit fraksioni.

Të gjitha materialet e përshkruara në faturë, janë bërë hyrje në magazinë me fletëhyrjen nr. 1, datë 03.12.2020 (po brenda ditës) dhe nuk janë bërë dalje.

Urdhër shpenzimi, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi:

-Kontrata me karrotecin dhe sa është likuiduar për ta çuar makinën tek vendi i shërbimit, ose mjeti që e ka tërhequr.

-Fletëdalja e pjesëve të këmbimit (fakt që nuk ka fletëdalje, çka presupozon që pjesët duhet të jenë në magazinë).

-Situacioni i shërbimit i lëshuar nga operatori ekonomik shoqëria òD.A.òSh.a

Pjesët e zëvendësuara në magazinën rikupero (kontabilizimi dhe inventari fizik).

Nga sa përshkrua si më lart, nuk është shërbim emergjent, por një shërbim i rregullt, i cili duhet të kishte procedurën e vetë të prokurimit për përzgjedhjes së operatorit ekonomik. Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 3 , datë 8.01.2018 t APP, òMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, pika 18.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përberë nga F.B., R.B. dhe F.K..

| | |
|------------------------------|---|
| 1. Titulli i gjetjes: | Shpenzim në vlerën 120,000 lekë, trajtuar padrejtësisht si rast emergjent, formulari nr. 4 |
| Situata: | Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 11.12.2020 për vlerën 120,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar shoqëria òD.A.ò Sh.a. Ky shpenzim ka të bëjë me shërbim makine (pjesë këmbimi dhe bateri) dhe është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6023200, duke u konsideruar blerje me vlerë të vogël òRast emergjentò, formulari nr.4. Në fakt ky shpenzim nuk është rast emergjent, por një shërbim i rregullt, dhe duhet të ishte zbatuar procedurë prokurimi për përzgjedhjen e operatorit ekonomik. -Për këtë shpenzim nga shoqëria òD.A.ò sh.a është lëshuar fatura tatimore shitje 321561013, datë 03.12.2020, firmosur nga F.B., R.B. dhe F.K.. Në fakt duhej firmosur nga personat e ndodhur në udhëtim K.N. dhe J.H.. |

| | |
|------------------------|---|
| | Urdhër shpenzimi, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi: -Kontratën me karrotrecin dhe sa është likuiduar për ta çuar makinën tek vendi i shërbimit, ose mjeti që e ka tërhequr. -Fletëdaljen e pjesëve të këmbimit (fakt që nuk ka fletëdalje, çka presupozon që pjesët duhet të jenë në magazinë dhe që nuk janë). -Situacionin e shërbimit të lëshuar nga operatori ekonomik shoqëria òD.A.òSh.a. |
| Kriteri: | Udhëzimi i APP nr. 3 , datë 8.01.2018, òMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, pika 18, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligji nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35. |
| Ndikimi/Efekti: | Keq menaxhim i fondeve publike. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E Mesme |
| Rekomandimi: | Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen. |

2.5. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

AKMC nuk ka akses në Sistemin Informatikë të Thesarit, për rrjedhojë i gjithë dokumentacioni për kryerjen e shpenzimeve dërgohet dorazi në Degën e Thesarit Tiranë. Nga auditimi u konstatua se pasqyrat financiare për vitin 2020, janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes, me shkresën nr. 740 prot., datë 29.03.2021, dhe në Degën e Thesarit Tiranë brenda afatit të përcaktuar të vitit buxhetor (31.03.2020).

Në AKMC, sektori i financës punon me sistemin e programit òAlpha buxhetorò, i cili është azhornuar dhe mirëmbahet nga Instituti i Modelimeve në Biznes SHPK, sipas kontratës me nr. 623, datë 12.03.2021, òPër kryerjen e shërbimit azhornim softweri dhe mirëmbajtje të programit Alpha Buxhetorò në AKMC.

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò.

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kontabilitetit me bazë të modifikuar rrjedhëse në bazë të ndryshimeve për trajtimin kontabël të materialeve dhe shpenzimit vjetor në lidhje me to, që paraqesin veçori sipas trajtimit në sektorin publik.

Konkretisht:

-Është plotësuar dhe përpunuar dokumentacioni i kontabilitetit, konformë dispozitave ligjore që rregullojnë mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve kontabile. Janë azhornuar ditarët e kontabilitetit dhe libri i madh i përmbledhjes së llogarive.

-Në librin përmbledhës të llogarive, janë pasqyruar përmbledhëset e kontabilizimeve të ditarëve të kontabilitetit, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

- Bilancet kontabël kanë të pasqyruar tepricat e llogarive, sipas të dhënave të librit përmbledhës të llogarive.

-Në verifikimin e kryer për rakordimin e inventarëve kontabël dhe fizik, ka rakordim midis llogarive analitike me ato sintetike.

-Është azhornuar libri i llogarisë (libri i madh), sipas kërkesave të Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe udhëzimeve të Ministrisë të financave në zbatim të tij.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore si më poshtë:

-Për vitin 2020 dhe 2021, nuk është kryer në mënyrë periodike kontabilizimi i detyrimit të prapambetura në momentin e ndodhjes së tyre, pasi i gjithë dokumentacioni që vërteton kërkesat e bashkive (për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash) për dhënien e fondeve emergjente, depozitohet dhe verifikohet nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, (Sektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve), për këtë arsye kontabilizimi është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, òPër Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme, pika 3.1, òProcedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nënpika pika 32, paragrafi 2: òDetyrimet t e evidentohen në pasqyrat financiare duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre. Në këtë rast, duhet të mbahet nën kontroll evidentimi joreal i detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341 òOperacione me shtetin (detyrime)ò, por është mbajtur llogaria specifike 4864, referuar në pikën 42, të udhëzimit të sipërcituar. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, pika 2.3,“Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik. Kjo për faktin se nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, përpunimi i dosjeve bëhet me shumë vonesë. Shkelja e dispozitave ligjore ngarkon me përgjegjësi R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente deleguar në detyrën e Drejtorit të Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.44, datë 19.02.2021.

Me shkresën nr. 30, datë 08.01.2021, H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i drejtohet Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për detyrimet e prapambetura të Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për vitin 2020 në vlerën 988,758,441 lekë.

Detyrimin i shtetit ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore (kreditorëve të ndryshëm) të llogarisë 467 në vlerën 857,247,701 lekë përfaqëson detyrime të mbartura nga vitet e kaluara për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore për të cilët janë njoftuar institucionet përkatëse për trajtimin e tyre dhe mbetet në vlerësimin MFE për financimin e tyre.

Shpenzimet në periudhat e ardhshme të llogarisë 486 në vlerën 711,057,951lekë përfaqëson detyrimin për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

AKMC-së i është akorduar në artikullin 604 (emergjencat civile) sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2020 në vlerën 130,000,000lekë, ky fond është pakësuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë për transfertë korente të brendshme për disa Bashki të vendit, në vlerën 129,500,000 lekë për dhënie ndihme financiare familjeve që u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme referuar Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, òPër mbrojtjen Civile dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të

shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore. Gjendja kreditore është krijuar ndër vite, në veprimtarinë e përgjegjësive të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe që nga data 01.09.2020, atë të AKMC. Detyrimet janë mbartur në pasqyrat financiare të AKMC sipas akt-rakordimit dypalësh të mbajtur nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe AKMC-së më datë 15.12.2020.

Në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

| NR. | PËRSHKRIM | AKT RAKORDIMI MM 15.12.2021 | VLERA E DETYRIMIT TË DEKLARUAR 31.08.2020 | VLERA E DETYRIMIT TË RISHIKUAR 30.11.2020 | DETYRIME TË LIKUIDUARA VITI 2021 | VLERA E DETYRIMIT TË PASQYRUARA NË BILANC |
|-----|-------------------------------|-----------------------------|---|---|----------------------------------|---|
| 1 | Detyrime të prapambetura AKMC | 883,044,713 | 988,758,441 | 986,747,687 | 129,500,000 | 857,247,701 |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Ndryshimi në shumën e detyrimeve vjen si rezultat i kontrollit dhe vlerësimit të përgjithshëm të dokumentacioneve tekniko-ligjore të përcjella nga prefekturat dhe njësitë vendore pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, referuar VKM nr. 329, datë 16.05.2012, òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e për vitin 2020 dhe 2021, nuk është kryer në mënyrë periodike kontabilizimi i detyrimit të prapambetura në momentin e ndodhjes së tij, por është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, òPër Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme, pika 3.1, òProcedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nën-pika pika 32, paragrafi 2: “Detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogarit financiare. Në këtë rast, duhet të mbahet nën kontroll evidentimi joreal i detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341 òOperacione me shtetin (detyrime)ò, por është mbajtur llogaria specifike 4864, referuar nën pikës 42, të udhëzimit të sipërcituar. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, pika 2.3, òOrganizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik.

Me shkresën nr. 30, datë 08.01.2021, H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i drejtohet Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për detyrimet e prapambetura të Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për vitin 2020, në vlerën 988,758,441 lekë.

Detyrimin i shtetit ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore (kreditorëve të ndryshëm) të llogarisë 467 në vlerën 857,247,701 lekë, përfaqëson detyrime të mbartura nga vitet e kaluara për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore për të cilët janë njoftuar institucionet përkatëse për trajtimin e tyre dhe mbetet në vlerësimin MFE për financimin e tyre.

Shpenzimet në periudhat e ardhshme të llogarisë 486 në vlerën 711,057,951 lekë, përfaqëson detyrimin për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

AKMC-së i është akorduar në artikullin 604 (emergjencat civile) sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2020 në vlerën 130,000,000 lekë, ky fond është pakësuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë për transfertë korente të brendshme për disa Bashki të vendit, në vlerën 129,500,000 lekë për dhënie ndihme financiare familjeve që u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme referuar Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, òPër mbrojtjen Civile dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore .

Gjendja kreditore është krijuar ndër vite, në veprimtarinë e përgjegjësive së Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe që nga data 01.09.2020, atë të AKMC. Detyrimet janë mbartur në pasqyrat financiare të AKMC sipas akt rakordimit dypalësh të mbajtur nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe AKMC-së me datë 15.12.2020.

Në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

Vlerësimi dhe argumentimi nga AKMC konsiston në korrektësinë e preventivave ndërtimore/pajisjeve dhe orendive elektroshtëpiake, përputhshmërinë e proces-verbalit të konstatimit të gjendjes me preventivat e përpiluar, si dhe elementë të tjerë të vlerësuar. Sipas bazës ligjore, momenti i ndodhjes së fatkeqësisë, duhet të përkojë edhe me elementët e përfshira në dokumentacion. Kështu, për një përmbytje të ndodhur në 2016, duhet të hartohen preventivat ndërtimor sipas manualit të Entit Kombëtar të Banesave për periudhën 2016 (bazuar Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016), dhe ndërtimi i banesave sipas kostos mesatare për periudhën në fjalë. E njëjta logjikë ndiqet edhe me preventivat e orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake, të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për çmimet mesatare të identifikuar.

Proces gjyqësor me risk për dëmshpërblim për llogari të AKMC, proces i trashëguar nga Ministria e Brendshme, për shoqërinë "A.V.I." SHPK (V.H.) në vlerën 146,189,750 lekë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me cilësinë e palës paditëse ka paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, padinë me objekt òPavlefshmëri e titullit ekzekutiv, fatura tatimore dhe palë të paditur Shoqërinë òA.V.I.ò SHPK (V.H.)ò identifikuar me NIPT K91629003B me seli në Tiranë dhe Shoqërinë Përmbarimore òB.ò SHPK identifikuar me NIPT 162107009Q.

Pala e paditur shoqëria V.H. (A.V.I. SHPK) në vitin 2017, ka lidhur disa marrëveshje me Ministrinë e Punëve të Brendshme, për òKryerjen e shërbimeve për shuarjen e zjarreve dhe evakuimet nga zonat e prekuraò për llogari të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Për shkak të mospagimit nga Ministria e Punëve të Brendshme, shoqëria Kontraktore òA.V.I.ò SHPK, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me një kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titujt ekzekutivë, fatura tatimore, sipas objektit të kërkesës së shoqërisë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pas shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. ska, datë 11.02.2019, vendosi të rrëzojë kërkesën e kërkuarit shoqëria òA.V.I.ò SHPK (V.H.) dhe të refuzojë kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për 50 faturat tatimore, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Shoqëria Kontraktore e ka apeluar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe në përfundim, Gjykata e Apelit Administrativ me vendimin nr. 83, datë 28.12.2020, vendosi ndryshimin e vendimit nr. ska, datë 11.12.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke pranuar kërkesën e shoqërisë òA.V.I.ò dhe lëshuar urdhrin e ekzekutimit për titujt ekzekutivë, fatura tatimore, sipas objektit të kërkesës së shoqërisë.

Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ nr. 83, datë 28.12.2020, shoqëria kontraktore nëpërmjet zyrës së përmbarimit privat òB.ò SHPK me shkresën nr. 240/5 0059-20, datë 17.12.2020, (nr. protokoll hyrës 1576, datë 18.12.2020) i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me lajmërim òPër ekzekutim vullnetar të detyrimitò dhe më datë 30.12.2020, pranë Agjencisë është depozituar nga shoqëria përmbarimore vendimi òPër fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit òVendimi nr. 83, datë 11.12.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Kundër këtij vendimi Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë me shkresën nr. 1576/5, datë 30.12.2020, e cila është protokolluar nga Gjykata më datë 31.12.2020.

Rekursi është pranuar me vendimin òPër pranimin rekursitò datë 31.12.2020, dhe është në ruajtje në fashikullin gjyqësor nr. 193 regjistri, datë 04.04.2019. Vendimi òPër pranimin rekursitò datë 31.12.2020, është protokolluar nga AKMC-ja me nr. 1646/5, datë 08.01.2021.

Gjykata e Lartë ka lëshuar vendimin nr. 27, datë 15.02.2021, për pezullimin e vendimit nr.83, datë 11.12.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, marrë hyrje nga protokollu i AKMC-së me nr. 334/3, datë 12.03.2021.

Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 27, datë 15.02.2021, për pezullimin e vendimit nr.83, datë 11.12.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është dërguar nga AKMC pranë Zyrës Përmbarimore òB.ò SHPK me shkresën nr.334/5, datë 26.03.2021.

Më datë 18.01.2021, AKMC-ja ka dërguar përmes Postës Shqiptare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë shkresën nr. 97/2, datë 18.01.2021, òKërkesë padi me objekt Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, fatura tatimore si më poshtë....ò.

Çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me numër regjistri themeltar 1522, datë 19.01.2021.

ANEKSI 1. ANALIZA E DETAJUAR E KLASAVE TË LLOGARIVE TË KONTABILITETIT NË SEKTORIN PUBLIK.

1.1.2. Funksionimi për llogaritë e tepricës së granteve kapitale të brendshme (105) dhe tepricës së granteve kapitale të huaja (llogaria 106).

b) Llogaria 1069 òGrante kapitale të huaja në natyrë merr në kredi vlerën e aktiveve të dhuruara nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj (të marra në dorëzim dhe të bëra hyrje në institucion), në debi të llogarive përkatëse të aktiveve (20 dhe 21).

Llogaria 107 òPër vlerën e mjeteve të caktuara në përdorim merr në kredi vlerën neto të aktiveve afatgjata që institucioni merr në përdorim nga të tretët, me kundërparti debitin e llogarive përkatëse të grupit 21 të AAGJ. Teprica e saj tregon se këto aktive nuk janë të vetat.

Hartimi i pasqyrave financiare të Institucionit është mbështetur në Ligjin 9228, datë 29.04.2004, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, të ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2020, të Ministrisë së Financave.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka në varësi të saj katër Qendra të Mbrojtjes Civile, të cilat janë:

1. Qendra të Mbrojtjes Civile, Durrës
2. Qendra të Mbrojtjes Civile, Fier
3. Qendra të Mbrojtjes Civile, Korçë
4. Qendra të Mbrojtjes Civile, Shkodër

Më poshtë pasqyrohen analizat përkatëse të posteve të bilancit.

Pasqyra e inventarit qarkullues:

Gjendja e inventarit paraqitet në vlerën **790,939lekë** e rakorduar me inventarin fizik të kryer në fund të periudhës ushtrimore.

| 2.Gjendje Inventari qarkullues | 790,939 | 0 |
|--|----------------|----------|
| Materiale | 790,939 | 0 |
| Inventar i imët | | |
| Prodhim në proces | | |
| Produkte | | |
| Mallra | | |
| Kafshe në rritje e majmëri | | |
| Gjendje të pa mbërritura, ose pranë të tretëve | | |
| Diferenca nga çmimet e magazinimit | | |
| Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-) | | |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Pasqyra e aktiveve afatgjata paraqitet në vlerën neto **8,660,309** lekë.

| | | |
|---|------------------|--|
| II. Aktivët Afat gjata | 8,660,309 | |
| 1. Aktive Afatgjata jo materiale | | |
| Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave | | |
| Studime dhe kërkime | | |
| Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme | | |
| 2. Aktive Afatgjata materiale | 8,660,309 | |
| Toka, Troje, terrene | | |
| Pyje, Plantacione | | |
| Ndërtesa e Konstruksione | | |
| Rruge, rrjete, vepra ujore | | |
| Instalime teknike, makineri e pajisje | | |
| Mjete Transporti | 3,981,062.00 | |
| Rezerva Shtetërore | | |
| Kafshë pune e prodhimi | | |
| Inventar ekonomik | 4,679,247.00 | |
| Aktive afatgjata të dëmtuara | | |
| Caktime të Aktiveve Afatgjata | | |
| 3. Aktive Afatgjata Financiare | | |
| Pjesëmarrje në kapitalin e vet | | |
| 4. Investime | | |
| Për Aktive Afatgjata jo materiale | | |
| Për Aktive Afatgjata materiale | | |
| II. Aktivët Afat gjata | | |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Siç shihet, në aktivet Qëndrueshme të Trupëzuara, llogaria 210, òToka, Troje, Terreneò llogaria 211 òPyje, Plantacioneò, llogaria 212 òNdërtime e Konstruksione, llogaria 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreò, llogaria 214 òInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla puneò, paraqite në vlerën 0 lekë, pasi AKMC është Institucion i krijuar rishtazi dhe zhvillon aktivitetin e saj brenda ambienteve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Llogaria 215 òMjete transporti ò paraqitet me shtesë në vlerën neto 3,981,062 lekë bërë hyrje 1 mjet tip HYNDAY SANTA FE për AKMC sipas fletë-hyrjes nr. 1, datë 01.10.2020, dhe Urdhrit të Përbashkët të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC dhe Komandantit të Repartit Ushtarak 6630, nr. 67 prot., datë 02.10.2020, me subjekt “Kalim kapital Automjeti”.

Inventari ekonomik(llogarite 218 & 219)

Shtesa: paraqitet në vlerën neto 4,679,247 lekë

Llogaria 218 òInventari ekonomikò për vitin 2020 ka shtesë në këtë llogari në vlerën 25,559,601lekë e përbërë si më poshtë:

Hyrjet dhe shtesat gjatë vitit ushtrimor përfshijnë shtesa pa pagese brenda dhe jashtë sistemit, (kompjuter, mobileje, bere hyrje stacionet hidrometrologjike, GPS dhe sensor naftë, nga Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria Rajonale e Rezervave materiale të Shtetit Shkodër, Fier dhe Tiranë, ASNI) si më poshtë vijon.

- ASNI Kompjuter 20 copë në vlerën 1,945,220lekë;
- Kompjuter 2 copë në vlerën 194,500lekë;
- DPRMSH Mobilje në vlerën 341,590lekë;
- UMM nr. 1529 prot ., datë 10.12.2020, për të bërë hyrje stacionet hidrometrologjike në vlerë 22,971,491lekë;
- GPS dhe sensor naftë në vlerën 106,800lekë;

Llogaria 219 òAmortizimiò paraqitet në vlerën 21,057,632.43 lekë i përbërë si më poshtë vijon:

- 137,278 lekë amortizim mjete transporti;
- 20,920,354 lekë amortizim inventar ekonomik;

Pasqyra e llogarive të arkëtueshme paraqitet si më poshtë vijon:

| | | |
|---|--------------------|----------|
| 3. Llogari të Arkëtueshme | 3,147,622 | - |
| Klientë e llogari të ngjashme | | |
| Personeli, paradhënie, deficite, gjoba | | |
| Tatim e Taksa | | |
| Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal | | |
| Fatkeqësi natyrore që mbulohen nga shteti | | |
| Sigurime Shoqërore | | |
| Sigurime Shëndetësore | | |
| Organizma të tjerë shtetërorë | | |
| Institucione të tjera publike | | |
| Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë | | |
| Debitorë të ndryshëm | | |
| Operacione me shtetin (Të drejta) | 3,147,622 | |
| Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike | | |
| Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-) | | |
| 4. Të tjera aktive afatshkurtra | 857,247,701 | - |
| Parapagime | | |
| Llogari e pritjes të marrëdhënieve me thesarin | | |
| Diferenca konvertimi aktive | | |
| Shpenzime për t'u shpërndare në disa ushtrime | | |
| Shpenzime të periudhave të ardhshme | 857,247,701 | - |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme” si dhe Llogaria 423,429 për Personeli paradhënie deficite gjoba paraqiten në vlerën 0 lekë .

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin” me vlerën **3,147,622 lekë** paraqet saldon debitorë të llogarive si më poshtë:

| | |
|---|--------------------|
| 421. Detyrime ndaj personelit, në vlerën | 2,137,585 lekë |
| 431. Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, në vlerën | 175,351 lekë |
| 435. Sigurime Shoqërore, në vlerën | 742,875 lekë |
| 436. Sigurime shëndetësore, në vlerën | 91,811 lekë |
| 467. Kreditore të ndryshëm, në vlerën | 857,247,701 lekë |
| 486. Shpenzime të periudhave të ardhshme, në vlerën | (857,247,701) lekë |

Detyrimin i shtetit ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore (kreditoreve të ndryshëm) të llogarisë 467 në vlerën 857,247,701 lekë:

Që përfaqëson detyrime të mbartura nga vitet e kaluara për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore për të cilët janë njoftuar institucionet përkatëse për trajtimin e tyre dhe mbetet në vlerësimin MFE për financimin e tyre.

Shpenzimet në periudhat e ardhshme të llogarisë 486 në vlerën 711,057,951 lekë që përfaqëson detyrimin për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore

V. H. sipas Vendimit nr. 83, datë 11.12.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, detyrim ndaj shoqërisë òA.V.I.ò SHPK në vlerën e detyrimit 146,189,750 lekë.

AKMC-së i është akorduar në artikullin 604 sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2020 në vlerën 130,000,000 lekë, ky fond është pakësuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë për transfertë korrente të brendshme për disa Bashki të vendit, në vlerën 129,500,000 lekë për dhënie ndihmë financiare familjeve që u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme referuar Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, òPër mbrojtjen Civileò dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria

njerëzore”. Këta Kreditor janë krijuar ndër vite nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, deri në vitin 2019 në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme, (sot AKMC, në fushën e përgjegjësisë së në Ministrisë së Mbrojtjes) dhe për pasojë detyrimet do të mbarten në pasqyrat financiare të AKMC sipas akt rakordimit dypalësh të mbajtur nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe AKMC-së më datë 15.12.2020.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, nisur nga domosdoshmëria e evidentimit dhe saktësimin të detyrimeve të prapambetura në pasqyrat financiare të AKMC-së, ka iniciuar “Ngritjen e komisionit për evidentimin/ përpunimin dhe mbylljen e procedurave administrative me dokumentet e krijuara apo të ardhura në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile” Urdhër nr. 91, datë 06.11.2021. Në përfundim të punës së grupit të punës, në vijim të proces verbalit të hartuar prej tyre si dhe Akt Rakordimit me Ministrinë e Mbrojtjes datë 15.12.2020, është ngritur urdhri nr. 91/1, datë 15.12.2021, për marrjen në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për dëshmperblimet e fatkeqësive natyrore. Detyrimi i deklaruar në bilancin e vitit 2019 si dhe vlera e rakorduar e detyrimeve të prapambetura me Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2019 është 883,044,713 lekë, vlera e deklaruar e detyrimeve për 9-mujore është 988,758,441 lekë dhe e rishikuar nga grupi i punës në datë 30.11.2020, është 986,747,687 lekë sipas tabelës më poshtë:

| NR. | PËRSHKRIM | AKT RAKORDIMI MM 15.12.2021 | VLERA E DETYRIMIT TË DEKLARUAR 31.08.2020 | VLERA E DETYRIMIT TË RISHIKUAR 30.11.2020 | DETYRIME TË LIKUIDUARA VITI 2021 | VLERA E DETYRIMIT TË PASQYRUARA NË BILANC |
|-----|-------------------------------|-----------------------------|---|---|----------------------------------|---|
| 1 | Detyrime të prapambetura AKMC | 883,044,713 | 988,758,441 | 986,747,687 | 129,500,000 | 857,247,701 |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Ndryshimi në shumën e detyrimeve vjen si rezultat i kontrollit dhe vlerësimit të përgjithshëm të dokumentacioneve tekniko-ligjore të përcjella pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile referuar bazës ligjore si më poshtë vijon:

VKM nr. 329, datë 16.05.2012, për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, Udhëzimi nr. 263, datë 24.05.2013, për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

Vlerësimi dhe argumentimi nga AKMC konsiston në korrektesinë e preventivave ndërtimore/pajisjeve dhe orendive elektroshtëpiake, përputhshmërinë e proces-verbalit të konstatimit të gjendjes me preventivat e përpiluar, si dhe elementë të tjerë të vlerësuar. Sipas bazës ligjore, momenti i ndodhjes së fatkeqësisë, duhet të përkojë edhe me elementët e përfshira në dokumentacion. Kështu, për një përmbetje të ndodhur në 2016, duhet të hartohen preventivat ndërtimor sipas manualit të Entit Kombëtar të Banesave për periudhën 2016 (bazuar Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016), dhe ndërtimi i banesave sipas kostos mesatare për periudhën në fjalë. E njëjta logjikë ndiqet edhe me preventivat e orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake, të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për çmimet mesatare të identifikuar.

Në mungesë të një jo korrektesë në zërat e mësipërme, realizohen ndryshimet dhe saktësimet e nevojshme, në referencë të manualeve përkatëse.

Në vitin 2020 në zbatim të shkresës së MFE-së nr. 23021/1 prot., datë 21.12.2020, janë transferuar në llogari të njërive vendore fondi financiar prej 129,500,000 lekë, pakësuar fondi i programit buxhetor Emergjencat Civile për vitin 2020, në Artikullin 604 të Tjërës Transferta Korrente të Brendshme dhe për rrjedhojë kjo shifër i është zbritur vlerës së detyrimeve të evidentuara nga AKMC duke e çuar vlerën e detyrimeve të AKMC-së në **857,247,701 lekë**. Regjistrimi i detyrimeve dhe sistemi i tyre është evidentuar edhe në Sistemin e Thesarit më datë 31.12.2020, dhe me shkresën nr. 30, datë 08.01.2021, H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i drejtohet Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të Me lëndë,

bashkëngjitur do të gjeni raportin e detyrimeve të prapambetura të Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për vitin 2020.

- Me urdhër regjistrimi i detyrimeve të prapambetura nr. 1, datë 31.12.2020, për vlerën 883,044,713 lekë dëmshpërblim për fatkeqësitë natyrore nga bilanci i vitit 2019 të Ministrisë së Mbrojtjes, firmosur: Urdhërues H.Ç., Kontabilisti R.R. dhe aprovuar nga Dega e Thesarit.

Kontabilizuar llogaria detyrime të prapambetura (llogaria) 4864900, si shpenzime të periudha të ardhshme në vlerën 857,247,701 me një diferencë 25,797,012 lekë, firmosur nga R.R. dhe Dega e Thesarit.

Me urdhër regjistrimi i detyrimeve të prapambetura nr. 2, datë 31.12.2020, për vlerën 25,797,012 lekë (shtesa gjatë viti 2020 në vlerën 103,702,974 lekë, pakësim gjatë viti 2020, 129,500,000 lekë). Ky regjistrim është kryer në zbatim të urdhrorit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 91/4, datë 15.12.2020. Për marrjen në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për dëm shpërblimet re fatkeqësive natyrore.

Pasqyra e llogarive të pagueshme paraqitet:

| | 1. Llogari të Pagueshme | 860,395,323 | 0 |
|----------|--|--------------------|----------|
| 401-408 | Furnitorë e llogari të lidhura me to | | |
| 42 | Detyrime ndaj personelit | 2,137,585 | |
| 16,17,18 | Hua Afat shkurtra | | |
| 460 | Huadhënës | | |
| 431 | Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa | 175,351 | 0 |
| 432 | Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal | | |
| 435 | Sigurime Shoqërore | 655,595 | |
| 436 | Sigurime Shëndetësorë | 91,811 | |
| 437,438, | Organizma të tjerë shtetërore | 87,280 | |
| 44 | Institucione të tjera publike | | |
| 45 | Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike | | |
| 464 | Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë | | |
| 466 | Kreditorë për mjete në ruajtje | | 0 |
| 467 | Kreditorë të ndryshëm | 857,247,701 | |
| 4341 | Operacione me shtetin (detyrime) | | 0 |
| 49 | Shuma të parashikuara për xh vlerësim(-) | | |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Llogaria **4341** "Operacione me shtetin detyrime" paraqitet me vlerën 0 lekë për arsye se AKMC-së është Institucion i krijuar rishtazi.

Llogaria: 520: AKMC nuk ka Disponibilitete në Thesar.

Pasqyra e fondeve paraqitet si më poshtë :

| D | FONDI I KONSOLIDUAR | 9,451,248.00 | - |
|----------|--|---------------------|----------|
| 101 | Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar | 8,660,309.00 | 0 |
| 12 | Rezultatet e mbartura | | |
| 85 | Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore | 790,939.00 | - |
| 111 | Rezerva | | |
| 115 | Nga Fondet e veta të investimeve | | |
| 15 | Shuma të parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime | | |
| 105 | Teprica e Grandeve kapitale të Brendshme | | |
| 106 | Teprica e grandeve kapitale të Huaja | | |
| 107 | Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim | | |
| 109 | Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata | | |
| | Të Tjera | | |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

KRAHASIMI I TË DHËNAVE FAKTIKE NDËRMJET AKMC DHE DEGËS SË THESARIT

Nga të dhënat faktike (financim i brendshëm) të Njesisë Shpenzuese AKMC me situacionet raportuese të thesarit për periudhën raportuese të vitit 2020 paraqiten 000/leke në tabelë:

| Emërtimi i Programit | Buxheti i miratuar me ndryshime | | | Shpenzime kapitale | | | Totali shpenzimeve/Fakt | | |
|----------------------|---------------------------------|---------------|-----------|--------------------|---------|-----------|-------------------------|---------------|-----------|
| | AKMC | Thesari | Diferenca | AKMC | Thesari | Diferenca | AKMC | Thesari | Diferenca |
| Emergjencat Civile | 52,262 | 52,262 | - | - | - | - | 18,608 | 18,608 | - |
| TOTALI | 52,262 | 52,262 | - | - | - | - | 18,608 | 18,608 | - |

Burimi i të dhënave: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

NUMRI I PUNONJËSVE DHE FONDI I PAGAVE

Pasqyra nr.8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat.

Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

| | |
|------------------------------|---|
| 1. Titulli i gjetjes: | Mos kontabilizim në momentin e ndodhjes të vlerësimit dhe argumentimit të dhënies së ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore. |
| Situata: | Për vitin 2020, AKMC ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash) në vlerën 129,500,000 lekë në zbatim të Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, òPër mbrojtjen Civileo dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzoreo. Kontabilizimi nuk është kryer në momentin e ndodhjes së tyre, pasi i gjithë dokumentacioni që vërteton kërkesat e bashkive (për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash) për dhënien e fondeve emergjente, depozitohet dhe verifikohet nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, (Sektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve), për këtë arsye kontabilizimi është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, òPër Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshmeo, pika 3.1, òProcedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeo, nënpika pika 32, paragrafi 2. |
| Kriteri: | Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Për Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshmeo. |
| Ndikimi/Efekti: | Pasqyrim jo i drejt dhe të saktë financiar në kohë. |
| Shkaku: | Keq intepretim i dispozozitave ligjore |
| Rëndësia: | E lartë |
| Rekomandimi: | Nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga |

| | |
|--|--|
| | Fatkeqësitë, të depozitohet në kohë në Drejtorinë e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse i gjithë dokumentacioni që ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmbytjet, dhe nga fatkeqësi të tjera, që detyrimet t' e evidentohen në pasqyrat financiare, duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës s tyre. |
|--|--|

2.6. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.

Për periudhën e rënies dhe ndërhyrjes për fikjen e zjarreve nga ajri nga data 03.08.2021, deri në datën 13.08.2021, AKMC ka shpenzuar për mjetet ajrore të operatorëve privat vlerën 36,069,300 lekë. Ky fond është vënë në dispozicion nga Ministria e Mbrojtjes në zbatim të VKM nr. 503, datë 25.08.2021, ÷Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e viti 2021, Miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, në programin buxhetor ÷Emergjencat civile o kodi buxhetor 10910 është shtuar fondi me 33,000,000 lekë, fond i cili është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., date 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., date 01.10.2021 po për këtë vlerë.

-Me shkresën nr. 1699 prot., datë 02.08.2021, R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, me kompetencë të deleguar i drejtohet A. Ç. me detyrë drejtor i Drejtorisë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, në cilësinë e Titullarit të Autoriteti Kontraktor dhe Drejtorisë së Prokurimeve dhe Ankandeve, për dijeni dhe T.P. me detyrë drejtoreshë e kabinetit, në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Nisur nga kërkesat e strukturave të pushtetit vendor dhe Prefektit të Qarkut Vlorë për mbështetje nga ajri, si dhe referuar vlerësimit të situatës së sipërpërmendur, duke qenë se struktura e mbrojtjes civile nuk kanë kapacitete të mjaftueshëm për ndërhyrje nga ajri për të përballuar situatën emergjente të krijuar, pasi kapacitetet e tyre kanë vetëm një mjet helikopter të tipit Coungar me pajisje kovë me kapacitet 2500 litra ujë, ***kërkojmë fillimin e menjëhershme të procedurave të prokurimit për sigurimin e dy mjeteve ajrore për ndërhyrje nga ajri për shuarjen e zjarreve, në kushtet e situatës emergjente.***

-Me vendim nr. 2, datë 02.08.2021 Komiteti i Mbrojtjes Civile, ka vendosur që AKMC të marr të gjitha masat për shtimin e kapaciteteve logjistike për ndërhyrje nga ajri, për normalizimin e situatës së shkaktuar nga zjarret në Gadishullin e Karaburunit. Shpenzimet do të përballohen nga buxheti i MM dhe AKMC. Dhe në rast nevojë dhe nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

-AKMC me Memon nr. 1700/2 prot., datë 03.08.2021, i dërgon Ministrinë të Ministrisë së Mbrojtjes, praktikën për marrjen e masave për përballimin e situatës së krijuar.

-Me shkresën nr. 1683 prot., datë 30.07.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm është miratuar plani operacional ÷Për koordinimin dhe drejtimin e operacioneve në mbështetje të emergjencave civile të shkaktuar nga zjarret o, plan i cili është hartuar dhe firmosur nga R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, K.N. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve, R.R. me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pikën 5 ÷Komandimi dhe Komunikimi o, të së cilit është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷***Drejtimi i operacionit do të bëhet nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe i Përgjigjes së Emergjencave. Për sigurimin e komunikimit të pandërprerë me të gjitha strukturat dhe institucionet do të përdoren telefonat dhe e-mail***”.

Në zbatim të planit operacional nga R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një plan veprimi për monitorimin dhe për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar nga

operatori "V.H.ö , si dhe nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatori ÷V.H.ö , si referencë ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi.

Korrespondenca për fondin e vënë në dispozicion

-Shkresa Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3602/1 prot., datë 03.08.2021, protokolluar në AKMC me nr. 1440/11 prot., datë 04.08.2021 ÷Njoftim për rishpërndarje fondesh 2021ö.

-Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit me nr. 12228/2 prot., datë 21.07.2021, dërguar Degës Thesarit, për dijeni Ministrisë së Mbrojtjes, ku cilësohet, ju autorizojmë që shtesat dhe pakësimet në zërin shpenzime operative 6029999 të bëhet në muajin korrik 2021.

-Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (Ministria e Financave) me nr. 12228/1 prot., datë 16.07.2021 dërguar Degës së Thesarit, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, për dijeni AKMC, ku në AKMC ÷Emergjencat Civile, pakësohet me 11,400,592 lekë.

-Me shkresën nr. 1704/5 prot., datë 03.08.2021, Drejtori i Përgjithshëm i kërkon Ministrisë së Mbrojtjes rishpërndarje dhe shtesë të fondeve në nivel artikulli 602 ÷Mallra dhe shërbimeö shtim 48,000,000 pakësim 15,000,000 lekë.

Referuar fondit të vënë në dispozicion si më sipër, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 107, datë 03.08.2021, protokolluar në AKMC me nr. 1704 prot., datë 03.08.2021, është urdhëruar ngritja e grupit të punës ÷Për përcaktimin e termave të referencës dhe fondit limit, ku në pikën 1 është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Ngritje të grupit të punës ÷Për përcaktimin e termave të referencës dhe fondit limit për kryerjen e ÷Shërbimit të fikjes së zjarreve nëpërmjet ajritö në zonën e Gadishullit të Karaburunit, me përbërje si vijon:

-R.H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, kryetar.

-H.C., me detyrë specialist në sektorin e buxhetit dhe financës, anëtar.

-B.S., me detyrë specialiste në sektorin e paralajmërimeve dhe mbështetjes operacionale & humanitare, anëtar.

-R.B., me detyrë specialist në sektorin e prokurimit dhe marrëdhënieve kontraktuale, anëtar.

-S.Sh., me detyrë specialiste në sektorin (Qendra) Kombëtare Operacionale e emergjencave civile, anëtar.

Grupi i punës i ngritur më urdhër të drejtorit të përgjithshëm nr. 107, datë 03.08.2021, me procesverbal të datës 03.08.2021 ÷Mbi hartimin e termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e ÷Shërbimit të fikjes së zjarreve nëpërmjet ajritö, i përbërë nga R.H., H.C., B.S., R.B. dhe J.M., në pikën 1 ÷Termet e referencës për shërbimin e kërkuar përveç të tjerave është shprehur ".....*Shoqëria ka detyrimin që të njoftojë ALB Kontrollin për fluturimet e kryera në përputhje me parashikimet e kodit ajror dhe akteve të tjera ligjore në fuqiö, **përcaktim i cili nuk është në marrëveshje dhe në kontratën e lidhur ndërmjet palëve**", çka ngarkon me përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe nëpunësit autorizues, R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente në cilësinë e drejtuesit të operacionit.*

Në pikën II ÷Përcaktimi i fondit limitö, është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Për përcaktimin e fondit limit për kryerje ÷Shërbimit të fikjes së zjarreve nëpërmjet ajrit, grupi i punës ju referua në mënyrë ekskluzive kontratave të mëparshme dhe konkretisht marrëveshjes të bërë ndërmjet Operatorit ekonomik ÷A.V.I.ö sh.p.k dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht me nr. 109 prot., datë 27.07.2017 dhe me nr. 4366/3 prot., datë 20.07.2017, marrëveshja e cila ka si objekt kryerjen e shërbimeve për shuarjen e zjarreve dhe ka përcaktuar si çmim ÷Orë operacionale 337,500 lekë/ora pa TVSH. Grupi i punës mbështetur në çmimin e kontratës së sipërcituar dhe orëve operacionale të parashikuara (orë pune operacionale 118) përcakton fondin

limit në shumën 39,825,000 lekë pa TVSH ose 47,790,000 lekë. Ky procesverbal është firmosur nga R.H., H.C., B.S., R.B. dhe S.Sh..

Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 1704/1 prot., datë 03.08.2021, i drejtohet Ministrit të Mbrojtjes N.P. me relacion *Relacion mbi situatën e shkaktuar nga zjarret në gadishullin e Karaburunit dhe domosdoshmërinë për ndërhyrje nga ajri*, ku ndër të tjera cilëson *referuar procesverbalit të grupit të punës për përcaktimin e termave të referencës dhe fondit limit, fondi i nevojshëm për aktivizimin e kapaciteteve ajrore të jetë 48,000,000 lekë. Për sa më sipër kërkojmë:*

-Përdorimin e fondeve buxhetore të miratuara për AKMC në vlerën 15,000,000 lekë dhe alokim nga fondet e Ministrisë së Mbrojtjes 33,000,000 lekë.

Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1073, datë 03.08.2021, protokolluar në AKMC me nr. 1701/1 prot., datë 12.08.2021, *Marrjen e masave të nevojshme për normalizimin e situatës së shkaktuar nga zjarret në Gadishullin e Karaburunit, ku në pikën 2 shprehet në mënyrë eksplicite se AKMC, Sekretari i Përgjithshëm i MM dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrin masa për ndjekjen e procedurave ligjore për sigurimin e fondeve të nevojshme, përfshirë rialokimet buxhetore brenda programeve, sipas propozimit të AKMC dhe në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.**

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 108, datë 03.08.2021, protokolluar me nr. 1704/2 prot., datë 03.08.2021 *Për rritjen e kapaciteteve të ndërhyrjes nga ajri me qëllim kryerjen e shërbimeve* *Për shuarjen e zjarreve në Gadishullin e Karaburunit dhe përzgjedhjen e operatorit/negocimin e kushteve të marrëveshjes që do të lidhet me këtë qëllim*, është urdhëruar:

-Rritja e kapaciteteve të ndërhyrjes nga ajri për shuarjen e zjarreve në Gadishullin e Karaburunit, përmes zgjedhjes së një operatori privat që ofron këtë shërbim.

-Ngritja e grupit të punës për përzgjedhjen e operatorit dhe negocimin e kushteve të marrëveshjes për kryerjen e shërbimeve *Për shuarjen e zjarreve në Gadishullin e Karaburunit të përbërë nga:*

-K.N. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve.

-A.Z., me detyrë specialist në sektorin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe projekteve, anëtar.

-A.P., me detyrë specialiste në sektorin e paralajmërimit dhe mbështetjes operacionale & humanitare, anëtare.

-M.Sh., me detyrë specialiste në sektorin e programeve dhe strategjive, anëtarë.

-Sh.Q., me detyrë specialist në sektorin (Qendra) Kombëtare e Trajnimit për mbrojtje Civile dhe vullnetarizmit, anëtar.

Në këtë urdhër përveç të tjerave në pikën *i* cilësohet *....Të evidentojë operatorët e mundshëm ekonomik vendas që në aktivitetin e tyre tregtar ofrojnë shërbimin e shuarjes së zjarreve nga ajri dhe janë të gatshëm ti përgjigjen kërkesave emergjente të AKMC në funksion të zgjidhës së situatës.*

Grupi i punës me procesverbal të datës 03.08.2021 përveç të tjerave cilësohet *...* Pasi përcaktoj këto rregulla procedurale *Grupi i punës* kontaktoj operatorët ekonomik A., A.A., Sh.A. dhe Operatorit ekonomik *V.H.ö* për disponibilitetin e mjeteve të nevojshme për kryerjen e operacioneve të fikjes së zjarrit nga rrugët ajrore.

Operatorët ekonomik *A.ö* dhe *A.A.ö*, u përgjigjën se nuk disponojnë mjetet e nevojshme për fikjen e zjarrit.

Operatorët ekonomik *Sh.A.ö*, në komunikim telefonik me nr. E tel +355684030143, të publikuar në faqen zyrtare të shoqërisë, si dhe me e-mailin e datës 04.08.2021 ora 10.17, ka pohuar se nuk disponon helikopter të pajisur me mjetet e nevojshme për operacionet e fikjes së zjarrit nga ajri.

Operatorët ekonomik *V.H.ö* njoftuan disponimin e kapaciteteve të mjaftueshme për ndërhyrjen nga ajri në operacionet e shuarjes së zjarreve dhe është i gatshëm të ndërhyj menjëherë.

Me shkresën nr. 1704/4 prot., datë 03.08.2021, K.N. informon me anë të memos, Drejtorin e Përgjithshëm të Informacion mbi mbledhjen e grupit të punës ku ndër të tjera në këtë memo citohet të Përsa më sipër ju bëjmë me dije se operatori ekonomik ÷V.H.ö, plotëson kushte për të qenë fitues. Bashkëlidhur do të gjeni projekt marrëveshjen me operatorin ÷V.H.ö.

Si dhe materialet shoqëruese, lutemi miratimin tuaj, miratim i cili është kryer me firmosjen e memos nga Drejtori i Përgjithshëm.

Me shkresën nr. 1704/3 datë 03.08.2021, Drejtori i Përgjithshëm i drejtohet Operatorit ekonomik ÷V.H.ö të ofertës për ofertë me objekt të fluturimit për shuarjen e zjarreve nëpërmjet ajrit me helikopter, në zonat e prekura të Gadishullit të Karaburunit, Bashkia Vlorë, me fond limit 39,825,000 lekë pa TVSH dhe me TVSH 47,790,000 lekë, afati 10 ditë, shërbimi i kërkuar duhet të realizohet me mjete ajrore të përshtatshme për fikjen e zjarrit nga ajri, helikopter të përshtatshëm për shuarjen e zjarreve dhe kapaciteti mbajtës i tyre të jetë jo më i vogël se 1000 litra ujë.

-Shoqëria ka detyrimin që të njoftoj Albkontrollin për fluturime të kryera në përputhje me parashikimet e kodit ajror dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. ***Ofertuesi duhet të paraqes ekstraktin e regjistrimit tregtar, kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit.***

Në ofertën ekonomike të jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjet ajror, nëse është rasti.

Nga AKMC nuk është kërkuar që Operatori ekonomik ÷V.H.ö shpk duhet të paraqes:

-Licencën e operimit të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, ku të jetë autorizuar për të kryer shërbime fluturimi në raste të emergjencave civile (fatkeqësi natyrore, fikje zjarresh, evakuime njerëzish dhe mallrash, punime ajrore të tjera të gjitha llojeve etj), specifikimet bashkëlidhur kësaj licence dhe certifikata e operatorit ajror, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10040, datë 22.12.2008, "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 12 pika 2, neni 13 pika 1, neni 16 pika 1, Udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve nr.17, datë 2.9.2010, të Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore, neni 3 pika 2 dhe neni 7, pika 1 dhe 2, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi grupin e punës për përzgjedhjen e operatorit dhe negocimin e kushteve të marrëveshjes për kryerjen e shërbimeve të Përsa shuarjen e zjarreve në Gadishullin e Karaburunit të përbërë nga K.N., A.Z., A.P., M.Sh. dhe Sh.Q..

Oferta e Operatorit ekonomik ÷V.H.ö protokolluar AKMC me nr. 1709/1 prot., datë 03.08.2021, është për 118 orë me vlerë 337,500 lekë/ora pa TVSH dhe 405,000 lekë/ora me TVSH, ***dhe nuk shoqërohet me asnjë dokument nga ato që është kërkuar, vetëm cilëson*** : Bashkëlidhur ekstraktin e regjistrimit tregtar, kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, ***që në fakt nuk ka paraqitur***:

-Licencën e operimit të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, specifikimet bashkëlidhur kësaj licence dhe certifikata e operatorit ajror, lejet e fluturimit për muajin gusht sipas datave lëshuar nga autoritetet përkatëse, tipin e helikopterit/ose avionit, numrin anësor, kapaciteti i licencuar i ngarkesës (masa maksimale e ngritjes në kg), numri i vendeve (kapaciteti i licencuar i vendeve) , Manifesti (depozita e ujit në litra), viti i prodhimit, në pronësi ose me qira (për përdorim personal për kënaqësi, biznes, tregtar, me qira etj. Sa helikopter vihen në dispozicion, si dhe të dhëna të tjera teknike të mjeteve ajrore).

Referuar ekstraktit historik Operatorit ekonomik ÷V.H.ö shpk, është themeluar në datë 20.04.2020, me vlerë në kapital 200,000 lekë.

Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., Operatorit ekonomik ÷V.H.ö është lidhur datë 03.08.2021 nga H.Ç në cilësinë e Drejtorit të

Përgjithshëm dhe Operatorit ekonomik ÷V.H.÷ nga administratori K.L., ndërsa kontrata me nr. 1789 prot., AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., Operatorit ekonomik ÷V.H.÷ është lidhur datë 16.08.2021, pas 13 ditëve, nga H.Ç në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Operatorit ekonomik ÷V.H.÷ nga administratori K.L..

Zbatimi i marrëveshjes dhe kontratës

Me urdhrin Drejtorit të Përgjithshëm nr. 109, datë 03.08.2021, protokolluar me nr. 1710 prot., datë 03.08.2021, është ngritur grupi ÷Për monitorimin e kryerjes së shërbimeve për shuarjen e zjarreve në Gadishullin e Karaburunit dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes së lidhur për këtë qëllim me Shoqërinë ÷V.H.÷. Grupi përbëhet nga P.K.me detyrë përgjegjësi i sektorit të buxhetit kryetar, G. Sh. me detyrë specialist qendra operacionale, Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit te përgjigjes se emergjencave, K.L. me detyrë specialist qendra operacionale, Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit te përgjigjes së emergjencave, B.S. me detyrë specialiste në sektorin e paralajmërimeve dhe mbështetjes operacionale & humanitare, A.P. me detyrë specialiste në sektorin e paralajmërimeve dhe mbështetjes operacionale & humanitare, L.Q. me detyrë specialiste në sektorin e paralajmërimeve dhe mbështetjes operacionale & humanitare.

Në pikën **vi**, të këtij urdhri është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Kohë operacionale do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve të “V.H.” Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë”*.

Në pikën **i**, të këtij urdhri është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Kryerja e shërbimeve sipas nenit 1 të marrëveshjes së lidhur me shoqërinë , nuk duhet të zgjas me shumë se 10 ditë”*.

Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021 për vlerën 36,069,300 lekë nëpërmjet OTP Bankë , është likuiduar shoqëria ÷V.H.÷ me nipt M01624004A. Urdhër shpenzimi është firmosur nga urdhëruesi H.Ç., kontabilisti P.K. dhe nga dega e thesarit. Ky shpenzim ka të bëjë me shërbimin e fikjes së zjarreve. ***Kryerja e këtij shpenzim nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë. Konkretisht:***

Dokument vërtetues i urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021, është urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 15.09.2021 për likuidimin e shoqërisë ÷V.H.÷, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik ÷V.H.÷ datë 03.08.2021, kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik ÷V.H.÷ datë 16.08.2021, fatura elektronike nr. 4/2021, datë 17.08.2021 në të cilën përcaktohet 89.06 orë për vlerën 36,069,300 lekë.

Fatura nuk shoqërohet nga asnjë dokument tjetër për ***kohën operacionale të kryer në fakt referuar:***

Pikës 2.5 të aktmarrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Ministria e Mbrojtjes, AKMC kryen pagesën për shërbimet e realizuara nga Operatori Ekonomik ÷V.H.÷ dhe të monitoruara sipas pikës 2.4 të kësaj marrëveshje, pikë në të cilën është shprehur se ÷Ministria e Mbrojtjes, AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOE) monitoron shërbimet e kryera nga Operatori ekonomik ÷V.H.÷, ***duke komunikuar me shërbimet vendore të mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe Albkontroll shaö***, pikës 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku ***“kohë pune operacionale”***, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga Viva heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....”.

-Kontratës me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatori Ekonomik ÷V.H.÷ datë 16.08.2021, në nenin 1 ka të përcaktuar ÷Objekti i kontratësö. Pika 11.1 Objekti i kësaj kontrate është shlyerja e shërbimeve të kryera për shuarjen e zjarreve në zonat e prekura në

Gadishullin e Karaburunit, Bashkia Vlorë, Prefektura Vlorë, nga ana e shoqërisë òV.H.ò shpk, për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes, AKMCò.

Neni 2 òDetyrimet e palëveò, pika 2.1 është shprehur në mënyrë eksplicite òShërbimet e realizuara nga “V.H.ò shpk, dhe të monitoruara sipas pikës 2.4, të marrëveshjes së lidhur midis palëve Ministria e Mbrojtjes, AKMC” dhe “V.H.”shpk, protokolluar nga AKMC me nr. 1704/7 prot., datë 03.08.2021, kanë kohëzgjatjen 89.06 orëve operacionale.

Pika 2.2. Çmimi për orë operacionale është 337,500 lekë/ora, pa TVSH 20 % dhe 405,000 lekë me TVSH.

Pika 2.3 “Pagesa totale për shërbimet e kryera nga V.H.”e llogaritur sipas formulës “Orë operacionale = 89.06 x çmimi për orë operacionale me TVSH 405,000 lekë/ora, është e barabartë me 36,069,300 lekë.

Pika 2.4. Kjo shumë do të paguhet në monedhën lekë , në llogarinë bankare të shoqërisë “V.H.”, sipas përcaktimeve të faturës të lëshuar nga “V.H.”.

Regjistri i orëve të punës i realizuara nga òV.H.ò shpk për shuarjen e zjarreve në pyje, është firmosur nga B. C., A.P., K.L. dhe G. Sh. specialist qendra operacionale, Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të përgjigjes së emergjencave, i firmosur jo për çdo datë por në fund për të 89 orët nga data 03.08 deri më 13.08.2021.

Regjistri i orëve të punës është firmosur në mënyrë të njëanshme nga AKMC, nuk është firmosur nga “V.H.ò shpk, si dhe nuk shoqërohet me asnjë dokument tjetër i lëshuar nga shërbimet vendore të mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe Albkontroll shaò, detyrime të përcaktuar në pikat 2.4, 2.5 të marrëveshjes dhe neni 2 të kontratës të cituara si më sipër, për pasojë është dokument i pa besueshëm për tu marr në konsideratë për shërbimin e kryer.

Pra nuk ka një dokument (akt verifikim, akt konstatim, procesverbal etj, ku te jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, te urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren , Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOE) dhe Operatorit ekonomik “V.H.” etj)

Si konkluzion: Shpenzimi i kryer në vlerën 36,069,300 lekë, ***nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35. Nga të dhënat e Albkontrollit, provohet që vetëm helikopteri AS350 D-DAHIQ është futur në datë 03.08.2021 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk provohet që të jetë përdorur helikopteri D-HAIF siç paraqitet Regjistri i orëve operacionale, regjistër i cili nuk përcakton tipin e helikopterit dhe numrin e serisë por vetëm çertifikata e regjistrimit D-HAIQ, D-HAIF.***

Më datë 03.08.2021 ky regjistër pasqyron Berlin (Gjermani)-Shqipëri 11,53 orë operacionale 11.53 orë x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se òNjësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku “Kohë pune operacionale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga Viva heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....”.

Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria V.H.” shpk.

Referuar faktit që Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. Menaxhimi i emergjencave (zjarreve në fondin

pyjor/kullosor etj..) kërkon një organizim të mirë institucional në aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme.

AKMC, për kryerjen e këtij shpenzimi, duhet të kishte vlerësuar dhe zhvilluar procedurën e prokurimit (Marrëveshje kuadërë, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, (Për prokurimin publik) 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, (Për miratimin e rregullave të prokurimit publik), neni 60, 61 dhe 62, për të siguruar mirë përdorimin të fondeve publike dhe të ulte shpenzimet procedurale.

NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR SHKELJET PËR KËTË SHPENZIM PARAQITEN SI MË POSHTË:

-AKMC nuk ka kompetencë (tagër ligjor) për kryerjen e procedurës për këtë shpenzim, si dhe nuk është deleguar nga Ministri kryerja e kësaj procedure. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015, (Për prokurimin Publik në Ministrinë e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në forcat e armatosura), KREU III, pika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite "*Të gjitha autoritet Kontraktore, në Ministrinë e Mbrojtjes, strukturat e vartësisë dhe në forcat e armatosura do të prokurojnë vet mallra, punë dhe shërbime, vlera e të cilave, gjatë vitit buxhetor, do të jetë deri në 800,000 lekë pa TVSH. Prokurimi do të kryhet sipas procedurës së prokurimit "Prokurim me vlera të vogla", KREU IV, pik 11, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se (Marrëveshje) Kontrata lidhet nga autoriteti kontraktor, vetëm me urdhër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës së lidhur, çdo autoritet kontraktor është i detyruar të dërgoj në Drejtorinë e Ankandëve dhe Prokurimeve njoftimin e gjatë dhe të shkurtër të kontratës së lidhur në formë të shkruar dhe elektronike (CD), i cili do të hidhet në sistem nga Drejtoria e Ankandëve dhe Prokurimeve... (Marrëveshje).*

Veprim në kundërshtim të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, (Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë), të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, (Për prokurimin publik), dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, (Për miratimin e rregullave të prokurimit publik).

Veprim i cili ngarkon me Përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe nëpunësit autorizues dhe P.K.me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.

-Nuk është përcaktuar lloji i procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, (Për prokurimin publik), neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, (Për miratimin e rregullave të prokurimit publik), neni 46.

Veprim i cili ngarkon me Përgjegjësi H.Ç me detyrë drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe nëpunësit autorizues dhe P. K. me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.

-Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fond është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., date 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., date 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, (Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë), i ndryshuar neni 40, i cili përcakton se: *(Marrëveshje) "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëveçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në sistemin informatik financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë sistem angazhimin, brenda pesë ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrimit të prokurimit. (Marrëveshje) Neni 50 (Marrëveshje) Nënpunësit autorizues të njësitë të qeverisjes së përgjithshme mbajnë të dhëna për angazhimet financiare dhe nuk lejojnë ndërmarrjen e angazhimeve të reja, përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara (Marrëveshje).*

Veprim i cili ngarkon me Përgjegjësi H.Ç me detyrë drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe nëpunësit autorizues dhe P. K. me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Për këtë procedurë prokurimi nuk është marr autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1 *oFaza para angazhimit... Nëpunësi zbatues kryen kontrollin dokumentar të përputhshmërisë si dhe të fondeve në SIFQ dhe në përfundim të procesit konfirmon direkt në SIFQ ngurtësimin e fondeve për prokurimin në fjalë, ose paraqet opinionin negativ zyrtarisht pranë Nëpunësit Autorizues. Urdhër prokurimi autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit.*

Veprim i cili ngarkon me Përgjegjësi H.Ç me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe nëpunësit autorizues dhe P.K.me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.

-Të gjitha dokumentet zyrtare, të përmendura si më sipër janë më datën 03.08.2021, deri dhe nisja e mjeteve ajrore nga Berlino (Gjermani), që nuk ka asnjë mundësi fizike dhe profesionale për zbatimin e procedurave dhe dokumentacionin e përshkruar si më sipër. ***Referuar këtij fakti në opinionin e grupit të auditimit kemi të bëjmë me një formalitet shkresor dhe jo një procedurë reale.***

Veprim i cili ngarkon me Përgjegjësi H.Ç me detyrë drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe nëpunësit autorizues, P.K.me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe kryetarit të grupit të monitorimit të kontratës, R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente në cilësinë e drejtuesit të operacionit, K.N. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve.

- Për kryerjen e këtij shpenzimi, AKMC, duhet të kishte vlerësuar dhe zhvilluar procedurën e prokurimit *oMarrëveshje kuadërë, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, oPër prokurimin publiko 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, oPër miratimin e rregullave të prokurimit publiko, neni 60 ,61 dhe 62,, për të siguruar mirë përdorimin të fondeve publike.*

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi H.Ç me detyrë drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe nëpunësit autorizues, P.K.me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe kryetarit të grupit të monitorimit të kontratës, R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente në cilësinë e drejtuesit të operacionit, K.N. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve.

-Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të *oV.H.o* shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi P.K. me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe kryetarit të grupit të monitorimit të kontratës, R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente në cilësinë e drejtuesit të operacionit, K.N. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve.

-Mos paraqitja e dokumentacionit të kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse

është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik òV.H.ò, nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi grupin te punës për përzgjedhjen e operatorit dhe negocimin e kushteve të marrëveshjes i përbërë nga K.N., A.Z., A.P., M.Sh. dhe Sh.Q..

-Shpenzimi i kryer në vlerën 36,069,300 lekë, ***nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35. Nga të dhënat e Albkontrollit, provohet që vetëm një helikopter është futur në datë 03.08.2021 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk provohet të jenë përdor dy helikopter siç paraqitet Regjistri i orëve operationale, regjistër i cili nuk përcakton tipin e helikopterit dhe numrin e serisë por vetëm çertifikata e regjistrimit D-HAIQ, D-HAIL.***

Si pasojë e çështjeve të trajtuar si më sipër grupi i auditimit refuzon të jap opinion, për saktësinë dhe vërtetësinë e kryerjes së këtij shpenzimi.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi P.K.me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe kryetarit të grupit të monitorimit të kontratës, R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente në cilësinë e drejtuesit të operacionit.

-Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer ***drejtimi i planit operacional të zjarreve me “V.H.” nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe Përgjigjes së Emergjencave.***

Konkretisht në zbatim të planit operacional nga R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një Plan Veprimi për monitorimin për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar operatorit òV.H.ò shpk, nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatorit òV.H.ò, shpk si referencat ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi. ***Konkretisht nuk ka një dokument (aktverifikim, aktkonstatim, procesverbal etj, ku te jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, te urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren , Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOC) dhe Operatorit ekonomik “V.H.” etj)***

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi P.K. me detyrë përgjegjës i sektorit dhe buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe kryetarit të grupit të monitorimit të kontratës, R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente në cilësinë e drejtuesit të operacionit

-Operatori ekonomik òV.H.ò shpk, ka paraqitur certifikatën me Nr. HEL 001AL, me nr. 1470/3 prot., datë 08.10.2014, për regjistrimin e të Aerodromi/ Heliporti, lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për operatorin òA.&V.ò shpk, dhe jo për Operatori ekonomik òV.H.ò shpk. Dokumenti është i fotokopjuar dhe i pa noterizuar veprim në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr.6291, datë 17.8.2005, òPër evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noterialeò, i ndryshuar, pika 4.

Operatori òA.&V.ò shpk, referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar QKB, ka datë themelimi 29.04.2009 vetëm me një ortak i cili është njëkohësisht dhe administrator V.V., nuk ka lidhje me Operatorin ekonomik òV.H.òshpk e cila referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar QKB është krijuar më datë 20.04.2020 me ortak dhe administrator K.L.. Pra certifikata me Nr. HEL 001AL, me nr.

1470/3 prot., datë 08.10.2014, është dokument i pavlefshëm për tu marr në konsideratë për llogari të Operatori ekonomik ÷V.H.öshpk, ***pasi nuk është në pronësi të saj, si dhe nuk ka një marrëveshje me shoqërinë ÷A.&V.*** shpk për përdorimin e Aerodromi/ Heliporti në zbatim të Udhëzimit nr. 1362, datë 16.3.2016 ÷Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit, neni 2, pika 3. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi grupin te punës për përzgjedhjen e operatorit dhe negocimin e kushteve të marrëveshjes i përbërë nga K.N., A.Z., A.P., M.Sh. dhe Sh.Q..

-Operatori ekonomik ÷V.H.ö shpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik ÷V.H.ö , dhe Kompanisë A.I.G.C Gjermani, i cili është operatori i helikoptereve : Tipi Arbius As-350, modeli B2, Certifikata e regjistrimit D-HFCE, D-HAIQ, D-HAIO, D-HAIL.

Tipi Atyribus AS-355, modeli N, D-Haif, Tipi Robinson R-44, D-HIB, modeli Raven II.

Kompania Aeroheli international GmbH &Co KC, Gjermani, është zotëruesi i licencës së ***operimit për transportin ajror të pasagjereve të lëshuar*** me nr. D-365 EG, datë 22.10.2014, SDI AOC (Certifikata e operimit ajror) nr. 365EG, rev-20, datë 22.10.2014.

Në akt marrëveshje citohet: Fushë veprimi i marrëveshjes: A.I.G.CGjermani, do ti jap operatorit ekonomik ÷V.H.ö shpk, helikopterin me qira në kushtet dhe mënyrën e përcaktuar si më poshtë ... ***por nuk përcakton se cilin nga helikopterët e përcaktuar në marrëveshje*** (Arbius As-350, modeli B2, Certifikata e regjistrimit D-HFCE, D-HAIQ, D-HAIO, D-HAIL.

Tipi Atyribus AS-355, modeli N, D-Haif, Tipi Robinson R-44, D-HIB, modeli Raven II).

Pika 3. Helikopteri do të zhvendoset në bazën LABD të V.H. që ndodhet në Baldushk (Shqipëri), përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe.

Në pikën 4 ÷Kërkesatë të marrëveshjes është shprehur ÷i ..Përpara se të zhvendoset në bazën LABD në Baldushk, helikopteri do të pranohet/miratohet zyrtarisht nga operatori ekonomik ÷V.H.ö shpk, i cili do të nënshkruaj një procesverbal të posaçëm, nuk ka një dokument të tillë.

-*Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë.*

-*Konfirmimi që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit.*

Konfirmimi i operacioneve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit.

-*Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit)*

Licencën Operative , në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautik i vendit të regjistrimit

Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011 ÷Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010, "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2.

Për punë të ngjashme nga Operatorit ekonomik ÷V.H.ö shpk, është paraqitur kontrata e shërbimit datë 07.05.2021 ndërmjet shoqërisë ÷E.ö shpk me objekt ÷Shtrirja e përcjellësit të linjës elektrike 35 KV me helikopter për objektin ÷Rikonstruksion i linjës 35 KV, të segmentit Fier220-Patos-Ballsh, për 50 ore me çmim 2450 euro për një ore.

Kjo kontratë nuk është e shoqëruar me faturën përkatëse, si e tillë nuk mund të quhet punë e ngjashme, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me ndryshimet vijuese të tij, neni 41 pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite ÷*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Nga AKMC gjatë auditimit, është paraqitur dokumentacion i fotokopjuar dhe i noterizuar pas datës 03.08.2021 që është lidhur kontrata si më poshtë:

-Çertifikata e Operatorit Ajror kompanisë A.I.G.C Gjermani, lëshuar Zyra Federale e Aviacionit Civil, D38144, nr AOC D-365, date 22.10.2014.

Modeli i helikopterëve : As-350 B3, AS-355 N, D-Haif, R-44, R-44II dhe R66 D, llojet e operimit transport ajror komercial pasagjer dhe me ngarkesë.

Certifikata regjistrimi për helikopterin Tipi Atyribus AS-355, modeli N me nr. Serial 5514, lëshuar me 09.04.2014, lëshuar nga zyra federale e aviacionit civil, gjermani, përkthyer dhe noterizuar, pa vulë apostile, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, òPër verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda venditò, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë.

Certifikata vlefshmërisë ajrore për helikopterin Tipi Atyribus modeli N me nr. Serial 5514, lëshuar me 18.06.2013, përkthyer dhe noterizuar, pa vulë apostile dhe Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë ajrore me datë lëshimi 14.06.2019 deri më 1306.2020, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, òPër verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda venditò, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë. Certifikata e zhurmës nr. 23614 nga Zyra Federale ë Aviacionit Civil, Gjermani për helikopterin Tipi Atyribus AS-355, modeli N, me nr. Serial 5514 me regjistrim D-HAIF, e përkthyer e noterizuar, pa vulë apostile, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, òPër verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda venditò, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë.

Certifikata e sigurimit për përgjegjësinë ligjore (polica) nr 65958287512, datë 27.12.2020 për periudhën 01.01.2021-01.01.2022 për Tipi Atyribus AS-355, modeli N, me nr. Serial 5514, përkthyer dhe noterizuar, pa vulë apostile, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, òPër verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda venditò, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë.

Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë për helikopterin Tipi Arbius As-350, modeli B3, numër serial 8766, dhe jo për avionin e futur në territorin shqiptar, i cili është me numrin serial Airwolf 2, me datë lëshimi 19.03.2021-15.05.2021, i përkthyer dhe i noterizuar, pa vulë apostile të lëshuar nga zyra kompetente gjermane, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, òPër verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda venditò, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë.

Certifikata e sigurimit për përgjegjësinë ligjore (polica) nr 65958287660, datë 28.12.2020 për periudhën 01.01.2021-01.01.2022 për Tipi Airbus H125., me nr. Serial 8766, përkthyer dhe noterizuar, pa vulë apostile, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, òPër verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda venditò, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë.

| | |
|------------------------------|--|
| 1. Titulli i gjetjes: | Kryerje e procedure pa kompetencë (tagër ligjor) |
|------------------------------|--|

| | |
|------------------------|---|
| Situata: | AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në Gusht 2021, ka kryer procedurë prokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015, òPër prokurimin Publik në Ministrin e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në Forcat e Armatosuraò, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò. |
| Kriteri: | Udhëzimi i Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015, òPër prokurimin Publik në Ministrin e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në forcat e armatosuraò, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò. |
| Ndikimi/Efekti: | Keq përdorim i kompetencave. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E Lartë. |
| Rekomandimi: | Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen. |

| | |
|------------------------------|---|
| 2. Titulli i gjetjes: | Shpenzim pa procedurë të mirëfilltë prokurimi. |
| Situata: | AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 46. Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fondi është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., datë 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., datë 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50. Për këtë procedurë prokurimi nuk është marrë autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1 |
| Kriteri: | Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, neni 41 dhe me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 46, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50, Udhëzimi i MF nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1. |

| | |
|------------------------|--|
| Ndikimi/Efekti: | Risk që fondet publike të mos shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe efikase, me konkurrencë dhe transparencë. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E Lartë |
| Rekomandimi: | Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me procedurën për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve. |

| | |
|------------------------------|---|
| 3. Titulli i gjetjes: | Mos vlerësim dhe zhvillim të procedurës së prokurimit ÷Marrëveshje kuadërö, në ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në Gusht 2021. |
| Situata: | Referuar faktit që Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, duhet të kishte vlerësuar dhe zhvilluar procedurën e prokurimit ÷Marrëveshje kuadërö, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publikö 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, neni 60 ,61 dhe 62, për të siguruar mirë përdorimin të fondeve publike. |
| Kriteri: | Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publikö 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, neni 60 ,61 dhe 62. |
| Ndikimi/Efekti: | Risk në përdorimin pa efektivitet në përdorimin e fondeve publike. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E Lartë |
| Rekomandimi: | Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullësor etj..) duke marrë masa për një organizim më të mirë institucional në aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, në këtë kontekst vlerësimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit ÷Marrëveshje kuadërö. |

| | |
|------------------------------|---|
| 4. Titulli i gjetjes: | Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik ÷V.H.ö nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë. |
| Situata: | Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik ÷V.H.ö nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publikö nenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, neni 82. Konkretisht: -Operatori ekonomik ÷V.H.ö shpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik ÷V.H.ö shpk, dhe Kompanisë A.I.G.C Gjermani, dokument i |

| | |
|------------------------------|--|
| | <p>pavlefshëm për tu marr në konsideratë pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë. -Konfirmimin që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit. -Konfirmimi i operacioneve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit. -Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit) -Licencën Operative , në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautikë i vendit të regjistrimit <p>Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011, òPër disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010, "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2.</p> <p>-Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik òV.H.ò, nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.</p> <p>Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të òV.H.ò shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò nenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 82, Rregullorja e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011 òPër disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010, "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2. |
| Ndikimi/Efekti: | Vendosje e operatorëve ekonomik në kushte të pabarabarta. |
| Shkaku: | Keq interpretim i akteve ligjore dhe rregullatore të procedurave të prokurimit publik, si dhe të zbatimit të kontratave të shërbimeve. |
| Rëndësia: | E lartë |
| Rekomandimi: | Nga Institucioni t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale. |
| 5. Titulli i gjetjes: | Përfitim i padrejtë i shpenzimeve Berlin (Gjermani)-Shqipëri |
| Situata: | Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021, është likuiduar shoqëria òV.H.ò për vlerën 36,069,300 lekë, për 89.06 orë pune operationale të helikopterëve të kontraktuar. Regjistri i mbajtur për orët operationale të |

| | |
|------------------------|---|
| | <p>helikopterëve më datë 03.08.2021, pasqyron Berlin(Gjermani)-Shqipëri 11,53 orë operacionale x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Njësia mbi të cilën bëhet përlogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku ÷Kohë pune operacionale, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V. Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....ö.</p> <p>Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria V.H.ö shpk.</p> |
| Kriteri: | Marrëveshja me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik ÷V.H.ö datë 03.08.2021, kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik ÷V.H.ö datë 16.08.2021. |
| Ndikimi/Efekti: | Përfitim i padrejtë në vlerën 4,669,650 lekë nga shoqëria ÷V.H.ö shpk. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E lartë |
| Rekomandimi: | Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 4,669,650 lekë, nga shoqëria ÷V.H.ö shpk, për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt ÷Për shërbimet e kryera për shuarjen e zjarreve në zonat e prekura në Gadishullin e Karaburunit, Bashkia Vlorë, viti 2021, si përfitim i padrejtë i shpenzimeve Berlin(Gjermani)-Shqipëri, duke rënduar padrejtësisht koston e shërbimit në vlerën 4,669,650 lekë, vlerë e cila për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik. |

| | |
|------------------------------|---|
| 6. Titulli i gjetjes: | Nuk provohet nga ana dokumentare zbatimi i marrëveshjes dhe kontratës për likuidimin e vlerën 36,069,300 lekë për llogari të shoqërisë ÷V.H.ö shpk. |
| Situata: | <p>Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021 për vlerën 36,069,300 lekë nëpërmjet OTP Bankë, është likuiduar shoqëria ÷V.H.ö me nipt M01624004A. Kryerja e këtij shpenzim nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë. Konkretisht: Dokument vërtetues i urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021, është urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 15.09.2021 për likuidimin e shoqërisë ÷V.H.ö, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik ÷V.H.ö datë 03.08.2021 kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik ÷V.H.ö datë 16.08.2021, fatura elektronike nr. 4/2021, datë 17.08.2021 në të cilën përcaktohet 89.06 orë për vlerën 36,069,300 lekë. Fatura nuk shoqërohet nga asnjë dokument tjetër për kohën operacionale të kryer në fakt referuar:</p> <p>Pikës 2.5 të aktmarrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Ministria e Mbrojtjes, AKMC kryen pagesën për shërbimet e realizuara nga Operatori Ekonomik ÷V.H.ö dhe të monitoruara sipas pikës 2.4 të kësaj marrëveshje, pikë në të cilën është shprehur se</p> |

| | |
|------------------------------|--|
| | <p>Ministria e Mbrojtjes, AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOEC) monitoron shërbimet e kryera nga Operatori ekonomik ÷V.H.ö, duke komunikuar me shërbimet vendore të mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe Albkontroll shaö, pikës 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku ökohë pune operacionaleö, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V. heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....ö.</p> <p>Nga të dhënat e Albkontrollit, provohet që vetëm një helikopter është futur në datë 03.08.2021 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk provohet të jenë përdor dy helikopter siç paraqitet Regjistri i orëve operacionale, regjistër i cili nuk përcakton tipin e helikopterit dhe numrin e serisë por vetëm çertifikata e regjistrimit D-HAIQ, D-HAIL.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollinö, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligji nr. 25/2018, ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, ÷Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikö, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik ÷V.H.ö datë 03.08.2021 kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik ÷V.H.ö datë 16.08.2021. |
| Ndikimi/Efekti: | Risk i lart për keq administrim të fondeve publike. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E Lartë |
| Rekomandimi: | Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për llogari të shoqërisë ÷V.H.ö për shërbimin e fikjes së zjarreve nga ajri në Gusht 2021, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve. |
| 7. Titulli i gjetjes: | Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer drejtimi i planit operacional i zjarreve me ÷V.H.ö. |

| | |
|------------------------|--|
| Situata: | <p>Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer Drejtimi i planit operacional të zjarreve me òV.H.ò nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe Përgjigjes së Emergjencave.</p> <p>Konkretisht në zbatim të planit operacional nga R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një Plan Veprimi për monitorimin për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar operatori òV.H.ò shpk, nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatori òV.H.ò, shpk si referencat ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi. Konkretisht nuk ka një dokument (aktverifikim, aktkonstatim, procesverbal etj, ku te jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, te urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren , Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOE) dhe Operatorit ekonomik òV.H.ò etj)</p> <p>Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të òV.H.ò shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.</p> |
| Kriteri: | Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik òV.H.ò datë 03.08.2021 kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik òV.H.ò datë 16.08.2021. |
| Ndikimi/Efekti: | Keq menaxhimi i shërbimit e fikjes së zjarreve nga ajri në Gusht 2021, me shoqërinë òV.H.ò. |
| Shkaku: | Keq interpretim i dispozitave ligjore |
| Rëndësia: | E Lartë |
| Rekomandimi: | Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullor etj.) duke marrë masa për të hartuar Plan Veprime për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar operatorët ekonomik, duke saktësuar dokumentacionin që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar. |

2.8. Vlerësimi dhe argumentimi i dhënies së ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (tërmeti, zjarri, përmbytjet, rrëshqitje tokash ose dherash).

Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objekte sociale e publike (shkolla, spitale, qendra shëndetësore, kabina të tensionit të lartë, ujësjellës dhe kanalizimet e ujërave të zeza dhe impiantet e trajtimit për ujin e pijshëm apo të ndotur, hidrovore, argjinatura, rrugë etj.), kryhet nga grupet e vlerësimit, në përbërje të cilëve ka ekspertë të institucioneve që kanë në pronësi apo në administrim këto objekte. Për këtë qëllim hartohen planimetritë dhe preventivat përkatës, të cilat dërgohen në DPEC (AKMC sot), në Ministrinë e Brendshme (Ministrinë e Mbrojtjes sot). Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në kultura bujqësore, mjete mekanike, makineri dhe agregate bujqësore, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore (koncentrate, sanë, njomishte etj.) kryhet sipas çmimeve të tregut, të miratuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së

Konsumatorit, dërguar me shkresë zyrtare në Këshillin e Qarkut. Vlerësimi për orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në objektet e banimit bëhet mbi bazën e çmimeve aktuale mesatare, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dërguar me shkresë zyrtare Këshillit të Qarkut përkatës. Vlerësimi i dëmeve në makineri, mallra dhe pajisje, të dëmtuara në objektet e biznesit, kryhet në përputhje me dokumentacionin e depozituar pranë organeve tatimore e doganore dhe vlerësimi bëhet nga drejtoritë përkatëse rajonale të tatimeve.

-Lidhur me dokumentacionin ligjor për përfitimin e ndihmës financiare.

Sipas VKM nr. 329, datë 16.05.2012 për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore dhe financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave me nr. 263, datë 24.05.2013, për vënien në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, kapitullit III të udhëzimit, pikës 2, “*Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare*”, Institucionet Vendore me qëllim përfitimin e ndihmës financiare, duhet të dorëzojnë pranë AKMC-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

-Procesverbalin e konstatimit të gjendjes;

-Vendimin e Këshillit të Bashkisë/Komunës;

-Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit si dhe të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake;

-Certifikatën familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;

-Certifikatën e vdekjes së pjesëtarit të familjes, kur ka raste të tilla, shoqëruar me vërtetimin e komisionit mjeko-ligjor, sipas rastit;

-Akt-ekspertizën nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në rast eksplozivi;

-Studimin gjeologjik të hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licencuara, nëse është rrëshqitje toke;

-Konfirmimin e vendimit të njësisë së qeverisjes vendore për bazueshmërinë ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut;

-Shkresën nga njësitë e qeverisjes vendore dhe Këshilli i Qarkut, ku të shprehet masa e ndihmës së dhënë për familjen e dëmtuar, në rast se ka, ose pamundësia financiare për ta ndihmuar, për mungesë fondesh.

-Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave për përfitimin e ndihmës financiare, rezultoi si më poshtë:

-Lidhur me miratimin e vlerës 53.367 lekë për dhënien e ndihmës financiare z. Sh. Xh. për banesën e dëmtuar nga tërmeti.

-Tek kjo dosje, ndodhen:

**Certifikata familjare.*

**Kërkesa nga i dëmtuari me datë 06.01.2019.*

**Kërkesa drejtuar Bashkisë Himarë për ngritje komisioni për evidentimin e dëmeve me nr. 2, datë 06.01.2019.*

**Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Himarë me nr. 74 prot., datë 11.01.2019 për ngritjen e komisionit për konstatimin e dëmeve i përbërë nga G. B., F. S. dhe V. L.*

**Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Himarë me nr. 74/1 prot., datë 11.01.2019 për ngritjen e komisionit për vlerësimin e dëmeve i përbërë nga G. S., S. K. dhe E. M..*

**Procesverbali i mbajtur nga komisioni i konstatimit të dëmeve me datë 12.01.2019.*

**Preventivi i datës 20.01.2019 i nënshkruar nga G. S., S. K. dhe E. M..*

*Projekt Vendimi me nr. 12 prot., datë 15.02.2019 i firmosur nga Kryetari Bashkisë Himarë mbi njohjen institucionale të demit.

*Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 565/16 prot., datë 26.02.2019 për miratimin e kërkesës së Bashkisë Himarë për akordimin e ndihmës financiare.

*Përgjigje nga Këshilli Qarkut Vlorë me nr. 493/1 prot., datë 11.03.2019 drejtuar Bashkisë Himarë

ku cilësohet se KQV nuk ka mundësi financiare për të ndihmuar.

-Të njëjtat dokumente ndodhen edhe në praktikat e tjera për aplikantët I. R., Sh.

Q., etj.

-Konkretisht, nga auditimi i këtyre praktikave (në total 61 praktika) si rastet në vijim ku paraqiten disa prej tyre pasi të gjitha praktikat janë identike:

-Për dhënien e ndihmës financiare Z. D. A. në vlerën 38,877 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Për dhënien e ndihmës financiare Znj. K. H. në vlerën 38,877 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Për dhënien e ndihmës financiare Z. Sh. Xh. në vlerën 53,367 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Për dhënien e ndihmës financiare Z. Z. A. në vlerën 40,387 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Për dhënien e ndihmës financiare Z. A. L. në vlerën 48,537 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Për dhënien e ndihmës financiare Znj. P. D. në vlerën 48,537 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Për dhënien e ndihmës financiare Z. A. B. në vlerën 48,537 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Për dhënien e ndihmës financiare Z. A. S. në vlerën 41,292 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak;

-Etj;

-U konstatua se në asnjë prej këtyre praktikave nuk ka relacion drejtuar Titullarit të njësisë publike për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës ekonomike të përcaktuar konkretisht me shkrim dore me laps në fletët e preventivave të paraqitur. Përlllogaritja e vlerës së ndihmës ekonomike nga AKMC, nuk ka ndjekur një rrugë shkresore zyrtare por pas kalkulimeve dhe shënimeve dorazi me laps në fletët e preventivave të paraqitur, është proceduar me hartimin e relacionit për propozimin e akordimit të fondit financiar drejtuar Titullarit të AKMC, të konceptuar nga M. K. dhe B. G. dhe të miratuar nga R. H. aktualisht në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente por edhe i komanduar sipas shkresës me nr. 422 Prot., datë 19.02.2021, urdhër nr. 44, *“Për organizimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe Parandalimit dhe të Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe Sektorit të Inspektimit”*.

-Sa më sipër, mungon gjurma e auditimit tek të gjitha praktikat e mësipërme për akordimin e ndihmës financiare për të dëmtuarit nga tërmeti në fshatin Kuç të Himarës në muajin Janar 2019. Nuk evidentohet nëse kërkuesi e disponon pronën pra nuk ka në dosje një dokument hipotekor ku të vërtetohet posedimi i pronës nga kërkuesi. Nuk gjendet bashkangjitur preventivave asnjë skicë apo planimetri ose të paktën koordinata të pozicionit gjeografik të pronës për të bërë të mundur të paktën evidentimin e pronës dhe kryerjen e matjeve online nga www.google.com/maps. Nuk ka asnjë fotografi ose regjistrim të dëmeve të shkaktuara. Procesverbalet e mbajtura nga grupet e inspektimit të dëmeve në terren të autorizuar nga

Titullarët e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, nuk janë protokolluar pranë këtyre institucioneve.

-Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel Qendror dhe Vendor, miratuar me urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, përcakton qartë tek neni 15 i saj, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe të Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve.

-Si rezultat:

- Për mos lënien e gjurmës së auditimit për të gjitha praktikatat e audituara, duke mos miratuar sisteme informacioni dhe komunikimi për të dokumentuar veprimet dhe hapat e ndjekur për miratimin e vlerave të përcaktuara për ndihmë financiare të të dëmtuarve, mban përgjegjësi Titullari i Njësisë Publike pasi nuk ka vepruar konformë nenit 23, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe konkretisht sipas pikës 5 ku përcaktohet se:

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë:

5) Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

- Për mos respektimin e detyrave të ngarkuara sipas rregullores së brendshme të AKMC-ë lidhur me verifikimet e nevojshme që duheshin kryer për të gjitha praktikatat e audituara duke vepruar jo në përputhje me nenin 15 të rregullores së brendshme të institucionit të miratuar me vendimin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, mban përgjegjësi Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe Sektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve. Detyrat pasqyrohen në vijimësi:

Neni 15 I.

Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë ka për mision:

1. Marrjen e masave strukturore për parandalimin, gatishmërinë, përballimin, rehabilitimin e rimëkëmbjen e komunitetit/shoqërisë të prekur nga një fatkeqësi, monitorimin e realizimit të masave strukturore për shmangien apo zvogëlimin e ndikimit të rreziqeve, si dhe krijimin e bazës së të dhënave kombëtare të humbjeve nga fatkeqësitë, vlerësimin e tyre dhe kompensimin;
2. Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë ka këto funksione administrative:
 - a) Koordinon procesin e monitorimit të institucioneve vendore e qendrore, për realizimin e masave strukturore, në parandalimin apo zvogëlimin e ndikimit të risqeve nga fatkeqësitë;
 - b) Bashkërendon veprimtarinë me strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, qendrore dhe vendore, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për dëmet dhe humbjet e pësuar nga fatkeqësitë;
 - c) Koordinon procesin e monitorimit të institucioneve vendore dhe qendrore, për marrjen e masave rehabilitues e të rimëkëmbjes nga dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë;
 - ç) Krijon dhe mirë administron bazën e të dhënave kombëtare të humbjeve nga fatkeqësitë;
 - d) Koordinon dhe mbikëqyr përgatitjen e analizave dhe statistikave, lidhur me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë, kostot financiare për rehabilitimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, kapacitetet e përdorura në menaxhimin e fatkeqësisë apo emergjencës civile/humanitare, si dhe çështje të tjera të lidhura me mbrojtjen civile;
 - dh) Koordinon dhe mbikëqyr procesin e vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë, si

dhe kompensimin sipas fushës së përgjegjësisë;

e) Koordinon dhe merr pjesë në procesin e planifikimit të nevojave financiare për marrjen e masave parandaluese, mbrojtëse, të përgjigjes dhe rehabilitimit ndaj fatkeqësive, si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile.

3. Sektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve, ka këto funksione:

a) Monitoron institucionet vendore dhe qendrore, për realizimin e masave strukturore në parandalimin apo zvogëlimin e ndikimit të risqeve nga fatkeqësitë;

b) Mbledh dhe përpunon të dhëna nga strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, qendrore dhe vendore, për investimet infrastrukturore të planifikuara dhe të realizuara në parandalimin apo zvogëlimin e ndikimit të risqeve nga fatkeqësitë;

c) Përgjigjet për monitorimin e institucioneve vendore dhe qendrore, për marrjen e masave rehabilituese dhe të rimëkëmbjes nga dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë;

ç) Përgjigjet për vlerësimin e humbjeve nga fatkeqësitë dhe kompensimin e qytetarëve, sipas fushës së përgjegjësisë;

d) Përgjigjet për planifikimin e nevojave financiare për marrjen e masave parandaluese, rehabilituese dhe të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, sipas fushës së përgjegjësisë;

dh) Verifikon kërkesat e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në lidhje me nevojat e ndërhyrjes në masa infrastrukturore;

e) Kryen investime në masa mbrojtëse, parandaluese, të përgjigjes, rehabilituese dhe të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e ndryshme;

ë) Kontrollon ndërhyrjet në masa mbrojtëse dhe parandaluese, të përgjigjes, rehabilituese dhe të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e ndryshme të financuara nga AKMC-ja;

f) Harton udhëzime në zbatim të akteve ligjore.

| | |
|------------------------------|--|
| 1. Titulli i gjetjes: | Mos respektimi i detyrave funksionale nga stafi i AKMC-së sipas rregullores së brendshme të institucionit me pasojë mos lënien e gjurmës së auditimit. |
| Situata: | Nga auditimi i disa praktikave në administrim të AKMC-së sipas kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore dhe financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, u konstatua se në asnjë prej këtyre praktikave nuk ndodhet relacioni drejtuar Titullarit të njësisë publike për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës ekonomike. Përlllogaritja e vlerës së ndihmës ekonomike nga AKMC, nuk ka ndjekur një rrugë shkresore zyrtare por pas kalkulimeve dhe disa shënimeve, është proceduar me hartimin e relacionit për propozimin e akordimit të fondit financiar drejtuar Titullarit të AKMC-së. Nga auditimi i disa prej praktikave sipas akordimit e ndihmës financiare për të dëmtuarit nga tërmeti në fshatin Kuç të Himarës në muajin Janar 2019, rezultoi se mungonte gjurma e auditimit. Konkretisht, nuk evidentohet nëse kërkuesi e disponon pronën pra nuk ka në dosje një dokument hipotekor ku të vërtetohet posedimi i pronës nga kërkuesi. Nuk gjendet bashkangjitur preventivave asnjë skicë apo planimetri ose të paktën koordinata të pozicionit gjeografik të pronës për të bërë të mundur të paktën |

| | |
|------------------------|--|
| | evidentimin e pronës dhe kryerjen e matjeve online nga www.google.com/maps . Nuk ka asnjë fotografi ose regjistrim të dëmeve të shkaktuara. Procesverbalet e mbajtura nga grupet e inspektimit të dëmeve në terren të autorizuar nga Titullarët e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, nuk janë protokolluar pranë këtyre institucioneve. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel Qendror dhe Vendor, miratuar me Urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, përcakton qartë tek neni 15 i saj, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe të Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve. |
| Kriteri: | Neni 23, i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, pika 5. Neni 15 i Rregullores së Brendshme të Institucionit miratuar me Vendimin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve. |
| Ndikimi/efekti: | Mos lënia e gjurmës së auditimit, bëhet precedent në të ardhmen për parregullsi në keq menaxhimin e fondeve me pasoja negative për Institucionin. |
| Shkaku: | Mos zbatimi i detyrave sipas rregullores së brendshme të AKMC-së. |
| Rëndësia: | E Lartë. |
| Rekomandimi: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, të marrë masat që në të ardhmen të koordinohet procesi i monitorimit të institucioneve vendore dhe qendrore, për rehabilitimin dhe rimëkëmbjen e të dëmtuarve nga dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë duke dokumentuar të gjitha veprimet, proceset dhe transaksionet, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin e akordimit të shumave financiare rast pas rasti të të dëmtuarve, me qëllim krijimin dhe miradministrimin e një baze të dhënash kombëtare të dëmtimeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë. |

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Plani Kombëtar për Emergjencat Civile është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 385, date 03.12.2004.

Institucionet e ngarkuara me ligj për emergjencat civile për 17 vite, periudha viti 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, nuk kanë arritur të përditësojnë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2004 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot. Dokumenti Strategjik i Emergjencave Civile të Shqipërisë deri në miratimin e dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2004, i cili nuk pasqyron rrethana të reja në fushën menaxhimit të emergjencave, përfshirë edhe Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civileò, në rastet si më poshtë:

Kreu 1. (1.2) Baza ligjore.

Kreu 2. Organizimi i Sistemit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në Shqipëri.

Kreu 3.(3.3). Përgjegjësitë për bashkërendimin e emergjencave civile.

Kreu 4.(4.3) Masat e përgjithshme për Parandalimin dhe Lehtësimin.

Kreu 5.(4.3) Rolet dhe Përgjegjësitë.

Kreu 6 Përgjigja.

Shtojca B: Baza ligjore, funksionet dhe detyrat e institucioneve etj, të cilat nuk gjejnë mishërim te plani kombëtar i vitit 2004 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Gjetje nga auditimi: Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile. Në veçanti për sigurimin e pronës bujqësore, kullosore nga shoqëritë e sigurimit. Konkretisht janë në proces miratimi:

- Projekt-vendim për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile.

-Projekt-vendim për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112.

-Projekt-vendim për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive.

Nuk ka, dhe as në proces akt rregullator, për sigurimin nga zjarri në shoqëritë e sigurimit, për dëm shpërblimin në rast të rënies të zjarrit. Ashtu siç është vepruar me ndërtesat nga tërmeti etj.

-Bashkitë dhe Prefekturat përpos njësive të reaguesve të parë, nuk kanë në dispozicion edhe kompani të specializuara për mbrojtjen nga zjarri kontraktuara të cilat asistojnë në aspektin teknik sa herë që kërkohet nga Bashkitë dhe Prefekturat, edhe pse me Ligjin 45/2019, òPër Mbrojtjen Civile, neni 30, pikat e dhe j, neni 58, pika ç; neni 61, pika ë mundësohet angazhimi i subjekteve private (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Mungesa e këtij dokumenti ka bërë të pamundur parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Pas një viti e gjysmës, me urdhër të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021, është ngritur grupi ndërinstitutional dhe grupi teknik ndërinstitutional i punës për përgatitjen Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ky dokument është në proces, pra nuk ka përfunduar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 5-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4. Gjetje nga auditimi: Nuk ka funksionuar Komisioni Teknik Këshillimor i emëruar në zbatim të VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, òPër përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive. Nën drejtimin AKMC në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (në vijim KTK), i cili këshillon për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile. KTK-ja kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC dhe ka në përbërje përfaqësues të Ministrive, të strukturave në vartësi të tyre dhe të institucioneve. Nuk është mbledhur për periudhën janar-gushtë 2021. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, òPër përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj

fatkeqësive, pika 1,3,4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi:

Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për funksionimin e Komisionit Teknik Këshillimor, që në të ardhmen vendimmarrjet për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile të jenë sa më të dobishme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Niveli qendror dhe lokal nuk ka burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret.

-Nga 61 Bashki në shkallë Republike, janë marrë të dhëna në 55 prej tyre, në të cilat raportohen 152 zjarrfikëse. Nga këto 131 në gjendje pune, 8 me defekte të vogla, 3 me defekte të konsiderueshme, 10 jashtë përdorimit dhe 36 të pa targuara (pa dokumentacion). Shumë nga zjarrfikëset në dispozicion janë të vjetruara (disa që datojnë nga vitet gjashtëdhjetë), janë në gjendje të keqe dhe nuk janë të ndërveprueshme sepse janë dhuruar nga vende të ndryshme.

- Bashkive dhe njësite administrative u mungojnë pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisje të jashtme për shuarjen e zjarreve, si: Kostume anti zjarr, kundragaz, çizme kundra zjarrit, doreza kundra zjarrit etj. Nga bashkitë janë raportuar: Pompa shpine gjithsej 243, nga këto profesionale 221, të zakonshme 22, fikse me pluhur 568, me CO2 92, pompa thithëse 23 dhe pompa të ndryshme 55.

Numri i zjarrfikësve profesionist për vitin 2021 është 1295. Popullsia në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 2021 është 2,829,741 banor. Numri i banorëve/zjarrfikës për vitin 2021 është 2,185, duke kaluar 205 banor për zjarrfikës, në kundërshtim me Ligjin 152/2015 òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin neni 7, pika 5.

Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2015, òPër Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shërbimin e Shpëtimit, shumica e kompetencave të shuarjes së zjarrit u transferuan nga prefekturat tek bashkitë, duke lënë në nivel qendror vetëm legjislacionin, trajnimin dhe bashkëpunimin mes strukturave të shuarjes së zjarrit.

Po në zbatim të këtij ligji, Bashkitë janë të detyruara të investojnë në ngritjen e kapaciteteve vullnetare të shuarjes së zjarreve, përveç shërbimit profesional. Por kufizimet buxhetore pengojnë shumë bashki të zhvillojnë programe për shuarjen e zjarrit me vullnetarizëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pamjaftueshmëria e burimet njerëzore dhe teknike për menaxhimin efektiv dhe reagimin ndaj situatave emergjente(zjarret).

Brenda datës 31.05.2022

6. Gjetje nga auditimi: Nga AKMC, nuk ka janë përdorur Kapacitetet e Paralajmërimit të hershëm.

Deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, nuk është realizuar (është në proces) rehabilitimi i stacioneve hidrometeorologjike të cilat janë në pronësi të AKMC-së, që do të përdoren për detyra operacionale nga IGJEUM. Njëkohësisht numri i vrojtuesve dhe sinjalizuesve të kontraktura nga njësitë vendore është në nivel të kufizuar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, neni 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për rehabilitimi i stacioneve hidrometeorologjike, për të siguruar menaxhimin efektiv për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus zjarret.

Brenda datës 30.06.2022

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e mangët operationale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret), ka krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë. Konkretisht Ministria e Mbrojtjes nga 4 helikopter gjithsej që ka për emergjencat civile (zjarret), ka në gjendje operationale vetëm një helikopter të gatshëm, i cili është përdorur gjatë operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë gjatë vërës së këtij viti.

Në këtë kontekst, shpenzimi prej 36,069,300 lekë për blerjen e shërbimit me dy helikopter nga shoqëria ÷V.H.÷ nga AKMC, nuk do të ishte kryer në qoftë se Ministria e Mbrojtjes do të kishte përdorur kapacitetet e veta operationale, si dhe AKMC nuk do të ishte drejtuar Mekanizimit Evropian të Mbrojtjes Civile ERCC, për ndihmë ndërkombëtare, ndihmë e cila ka ardhur nga Shteti Hollandez me 3 mjete Helikopter dhe 76 veta personel, Republika Çeke me 2 mjete Helikopter me 7 veta personel. Gjithashtu USAID ka ofruar asistencë teknike mbi metodat e shuarjes së zjarreve në pyje me 4 veta personel, të cilët lehtësuan procesin e shuarjes së zjarreve në vatrat më kritike të vendit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8. Gjetje nga auditimi: Nuk është krijuar fondi i solidaritetit për mbrojtjen civile (zjarret), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, ÷Për mbrojtjen civilë, neni 66 ÷Fondi i solidaritetit, pikat 1,2,3 ku është shprehur respektivisht

÷Pika 1. AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond solidariteti, për mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Pika 2. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik.

Pika 3. Fondi i krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, mund të transferohet njësive të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre, sipas legjislacionit në fuqi ÷(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Nga AKMC-ja, të merren masa për të krijuar fondin e solidaritetit nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, për përballimin e situatave emergjente, si dhe të bëhen transparente të gjitha proceset e krijimit të këtij fondi.

Brenda datës 30.09.2022

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi nga AKMC, nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar Plan kontrolli nr. 1390/1 prot., datë 25.06.2021 ÷Për masat e marra nga Prefektura Fier dhe bashkitë e këtij Qarku, për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, me objekt: zbatimi masave të marra dhe planet e përgatitura për përballimin e situatave të zjarreve që mund të ndodhin gjatë sezonit të verës, ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për parandalimin e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga zjarret. Sipas këtij Programi është kërkuar që:

÷Në përfundim të planit të kontrollit të përgatitet informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara. Për masat të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, ekipi AKMC-së, të vërë detyra konkretë. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nuk është përgatitur informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për kryer inspektime në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civilë, neni 68 “Kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për ushtrim të plot të përgjegjësisë të Tij, funksionale ndaj strukturave qendrore dhe vendore për mos marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, ka kryer procedurë prokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015, òPër prokurimin Publik në Ministrinë e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në Forcat e Armatosura, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publik, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv të kushtohet vëmendje e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publik, neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 46.

Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fondi është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., datë 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., datë 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50.

Për këtë procedurë prokurimi nuk është marrë autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me procedurën për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Referuar faktit që Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300

lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, duhet të kishte vlerësuar dhe zhvilluar procedurën e prokurimit ÷Marrëveshje kuadërö, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publikö 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, neni 60 ,61 dhe 62, për të siguruar mirë përdorimin të fondeve publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullosor etj.) duke marrë masa për një organizim më të mirë institucional në aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, në këtë kontekst vlerësimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit ÷Marrëveshje kuadërö.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik ÷V.H.ö nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publikö nenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, neni 82. Konkretisht:

-Operatori ekonomik ÷V.H.ö shpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik ÷V.H.ö shpk, dhe Kompanisë A.I.G.C Gjermani, dokument i pavlefshëm për tu marr në konsideratë pasi:

-Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë.

-Konfirmimin që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit.

-Konfirmimi i operacioneve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit.

-Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit).

-Licencën Operative , në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautikë i vendit të regjistrimit.

Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011, ÷Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2.

-Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik ÷V.H.ö, nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të ÷V.H.ö shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Nga Institucioni t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 11.12.2020 për vlerën 120,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar shoqëria ÷D.A.ö Sh.a. Ky shpenzim ka të bëjë me shërbim makine (pjesë këmbimi dhe bateri). Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6023200, duke u konsideruar blerje me vlerë të vogël ÷Rast emergjentö, formulari nr.4.

Në fakt ky shpenzim nuk është rast emergjent, por një shërbim i rregullt, dhe duhet të ishte zbatuar procedurë prokurimi për përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

-Për këtë shpenzim nga shoqëria òD.A.ò sh.a është lëshuar fatura tatimore shitje 321561013, datë 03.12.2020, firmosur nga F.B., R.B. dhe F.K.. Në fakt duhej firmosur nga personat e ndodhur në udhëtim K.N. dhe J.H..

Urdhër shpenzimi, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi:

-Kontratën me karrotecin dhe sa është likuiduar për ta çuar makinën tek vendi i shërbimit, ose mjete që e ka tërhequr.

-Fletëdaljen e pjesëve të këmbimit (fakt që nuk ka fletëdalje, çka presupozon që pjesët duhet të jenë në magazinë).

-Situacionin e shërbimit të lëshuar nga operatori ekonomik shoqëria òD.A.ò Sh.a.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.2018, òMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, pika 18, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Departamenti i Administratës Publike në tre rast ka kryer emërimet në kundërshtim me kriteret e posaçme të pozicioneve të punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të depozituara në DAP *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të depozitoj në DAP, kriteret e posaçme të pozicioneve të punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të kërkoj që emërimet e nëpunësve civil të kryhen në zbatim të këtyre kriterëve, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, AKMC ushtron aktivitetin e saj me strukturë organizative të pa plotësuar. Konkretisht nga 106 pozicione të miratuara, në fakt janë punësuar 58 punonjës me një diferencë prej 48 punonjësish *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të kërkoj DAP nisjen e procesit të rekrutimit, pra shpalljen e vendeve vakante dhe administrimin e procedurave të seleksionimit për çdo kategori për të plotësuar strukturë organizative të AKMC.

Brenda datës 31.05.2022

18. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020, AKMC ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (tërmeti, zjarri, përmbytjet, rrëshqitje tokash ose dherash) në vlerën **129,500,000 lekë** në zbatim të Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, òPër mbrojtjen Civileò dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzoreò.

Kontabilizimi nuk është kryer në momentin e ndodhjes së tyre, pasi i gjithë dokumentacioni që vërteton kërkesat e bashkive *(për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmbytjet, rrëshqitje*

tokash ose dherash) për dhënien e fondeve emergjente, depozitohet dhe verifikohet nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, (*Spektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve*), për këtë arsye kontabilizimi është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, òPër Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshmeò, pika 3.1, òProcedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, nënpika pika 32, paragrafi 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, të depozitohet në kohë në Drejtorinë e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse i gjithë dokumentacioni që ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmytjet, dhe nga fatkeqësi të tjera, që detyrimet t' e evidentohen në pasqyrat financiare duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës s' tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i disa praktikave në administrim të AKMC-së òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore dhe financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzoreò, u konstatua se në asnjë prej këtyre praktikave nuk ndodhet relacioni drejtuar Titullarit të njësisë publike për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës ekonomike. Përlllogaritja e vlerës së ndihmës ekonomike nga AKMC, nuk ka ndjekur një rrugë shkresore zyrtare por pas kalkulimeve dhe disa shënimeve, është proceduar me hartimin e relacionit për propozimin e akordimit të fondit financiar drejtuar Titullarit të AKMC-së. Nga auditimi i disa prej praktikave òPër akordimin e ndihmës financiare për të dëmtuarit nga tërmeti në fshatin Kuç të Himarës në muajin Janar 2019, rezultoi se mungonte gjurma e auditimit. Konkretisht, nuk evidentohet nëse kërkuesi e disponon pronën pra nuk ka në dosje një dokument hipotekor ku të vërtetohet posedimi i pronës nga kërkuesi. Nuk gjendet bashkangjitur preventivave asnjë skicë apo planimetri ose të paktën koordinata të pozicionit gjeografik të pronës për të bërë të mundur të paktën evidentimin e pronës dhe kryerjen e matjeve online nga www.google.com/maps. Nuk ka asnjë fotografi ose regjistrim të dëmeve të shkaktuara. Procesverbalet e mbajtura nga grupet e inspektimit të dëmeve në terren të autorizuara nga Titullarët e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, nuk janë protokolluar pranë këtyre institucioneve. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel Qendror dhe Vendor, miratuar me Urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, përcakton qartë tek neni 15 i saj, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe të Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 72-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, të marrë masat që në të ardhmen të koordinohet procesi i monitorimit të institucioneve vendore dhe qendrore, për rehabilitimin dhe rimëkëmbjen e të dëmtuarve nga dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë duke dokumentuar të gjitha veprimet, proceset dhe transaksionet, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin e akordimit të shumave financiare rast pas rasti të të dëmtuarve, me qëllim krijimin dhe miradministrimin e një baze të dhënash kombëtare të dëmtimeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente nuk është përgatitur Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI)

(projektet, preventivat dhe dokumentacioni ligjor) për projektet prioritare të investimit për vitin 2021 dhe 2022).

Për projektin kryesor të investimit ÷Fatkeqësi natyrore të menaxhuara me vlerë 280,073 mijë lekë për vitin 2021.

Drejtoria e sipër cituar është dërguar 1 vit vonesë, konkretisht me shkresën nr. 1892/1, datë 30.08.2021 në Ministrinë e Mbrojtjes me subjekt ÷Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja duke e bërë praktikisht të pamundur realizimin e këtij investimi prioritar dhe mos përdorimin e fondit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandimi AKMC, Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente të marrë masat që në të ardhmen për projektet prioritare të investimeve, të përgatisë dhe dërgojë brenda afateve ligjore formularët e propozimeve të projekteve.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020 janë kryer 2 shtesa/pakësime në vlerën 35,000 mijë lekë, për vitin 2021 janë kryer 6 shtesa/pakësime në vlerën 300,250 mijë lekë, tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së AKMC tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi Nga ana e AKMC të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi:

Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021 për vlerën 36,069,300 lekë nëpërmjet OTP Bankë, është likuiduar shoqëria ÷V.H.ö me nipt M01624004A. Kryerja e këtij shpenzimi nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë. Konkretisht:

Dokument vërtetues i urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021, është urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 15.09.2021 për likuidimin e shoqërisë ÷V.H.ö, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik ÷V.H.ö datë 03.08.2021, kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik ÷V.H.ö datë 16.08.2021, fatura elektronike nr. 4/2021, datë 17.08.2021 në të cilën përcaktohet 89.06 orë për vlerën 36,069,300 lekë. Fatura nuk shoqërohet nga asnjë dokument tjetër për kohën operationale të kryer në fakt referuar:

Pikës 2.5 të aktmarrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Ministria e Mbrojtjes, AKMC kryen pagesën për shërbimet e realizuara nga Operatori Ekonomik ÷V.H.ö dhe të monitoruara sipas pikës 2.4 të kësaj marrëveshje, pikë në të cilën është shprehur se ÷Ministria e Mbrojtjes, AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operationale Civile (QKOE) monitoron shërbimet e kryera nga Operatori ekonomik ÷V.H.ö, duke komunikuar me shërbimet vendore të mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe Albkontroll shaö, pikës 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Njësia mbi të cilën bëhet

përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku òkohë pune operacionale, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga Viva heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....ò.

Nga të dhënat e Albkontrollit, provohet që vetëm një helikopter është futur në datë 03.08.2021 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk provohet të jenë përdor dy helikopter siç paraqitet Regjistri i orëve operacionale, regjistër i cili nuk përcakton tipin e helikopterit dhe numrin e serisë por vetëm çertifikata e regjistrimit D-HAIQ, D-HAIL.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligji nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik òV.H.ò datë 03.08.2021 kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik òV.H.ò datë 16.08.2021 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

22.1. Rekomandimi

Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për llogari të shoqërisë òV.H.ò për shërbimin e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer Drejtimi i planit operacional të zjarreve me òV.H.ò nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe Përgjigjes së Emergjencave.

Konkretisht në zbatim të planit operacional nga R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një Plan Veprimi për monitorimin për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar operatori òV.H.ò shpk, nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatori òV.H.ò, shpk si referencat ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi. Konkretisht nuk ka një dokument (aktverifikim, aktkonstatim, procesverbal etj, ku te jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, te urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren , Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOE) dhe Operatorit ekonomik òV.H.ò etj)

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të òV.H.ò shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

Veprim në kundërshtim me marrëveshjen ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik òV.H.ò datë 03.08.2021 kontratën me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik òV.H.ò datë 16.08.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi

Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullosor etj.) duke marrë masa për të hartuar Plan Veprime për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar operatorët ekonomik,

duke saktësuar dokumentacionin që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021, është likuiduar shoqëria ÷V.H.ö për vlerën 36,069,300 lekë, për 89.06 orë pune operacionale të helikopterëve të kontraktuar. Regjistri i mbajtur për orët operacionale të helikopterëve më datë 03.08.2021, pasqyron Berlin (Gjermani)-Shqipëri 11,53 orë operacionale x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku ÷Kohë pune operacionale, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V. Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....ö.

Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria V.H.ö shpk (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 4,669,650 lekë, nga shoqëria ÷V.H.ö shpk, për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt ÷Për shërbimet e kryera për shuarjen e zjarreve në zonat e prekura në Gadishullin e Karaburunit, Bashkia Vlorë, viti 2021, si përfitim i padrejtë i shpenzimeve Berlin(Gjermani)-Shqipëri, duke rënduar padrejtësisht koston e shërbimit në vlerën 4,669,650 lekë, vlerë e cila për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.08.2022

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave konstatohet se për katër punonjës ish-ushtarak, që kanë përfunduar studimet e universitare në Shkollën e Lartë të Bashkuar Tiranë sistemim tre vjeçar, nga AKMC janë klasifikuar në kategorinë e sistemit katër vjeçar (master shkencor). Duke u bazuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 2012, datë 11.12.2015, ÷Miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake në vite, tabela 1 dhe 2, këto diploma ekuivalentohen si Bachelor. Në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, këta punonjës duhen të trajtohen me vlerën 10,000 lekë në muaj dhe jo në vlerën 14,000 lekë në muaj që i ka trajtuar AKMC-ja. Kjo praktikë është korrigjuar nga muaji mars 2021 dhe në vazhdim, ku këta punonjës janë trajtuar me vlerën 10,000 lekë në muaj në përputhje me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes. Për muajt gusht 2020 - shkurt 2021 kjo diferencë është në vlerën 78,044 lekë e cila për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të analizohet vlera 78,044 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me mos përcaktimin e saktë të statusit të klasifikimit dhe ekuivalentimit të diplomave

universitare për punonjësit ish-ushtarak dhe ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.08.2022

D. MASA DISIPLINORE:

D.1. Mbështetur në nenin 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 òPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Ministrit të Mbrojtjes, Titullarit të AKMC, t'ò kërkojnë Komisionit Disiplinor, pranë AKMC dhënien e masave disiplinore si më poshtë vijon:

D.1.a. òLargim nga shërbimi civil”, sipas pikës “ç” e nenit 58,

1. R.H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, **për arsye se:**

-Për periudhën objekt auditimi nga AKMC, nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civilò, neni 67 “Inspektimiò, pikat 1 dhe 2.

Plan kontrolli nr. 1390/1 prot., datë 25.06.2021 i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm òPër masat e marra nga Prefektura Fier dhe bashkitë e këtij Qarku, për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarriò, me objekt: zbatimi masave të marra dhe planet e përgatitura për përballimin e situatave të zjarreve që mund të ndodhin gjatë sezonit të verës, ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për parandalimin e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga zjarretò.

Ky program në fund ka përcaktuar se òNë përfundim të planit të kontrollit të përgatitet informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara. Për masat të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëshme, ekipi AKMC-së, të vërë detyra konkrete. Në fakt nuk është përgatitur informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara

- Për periudhën objekt auditimi, në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kane shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civilò, neni 68 “Kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2

-Për vitin 2020, AKMC ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (*tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash*) në vlerën **129,500,000 lekë** në zbatim të Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, òPër mbrojtjen Civileò dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzoreò.

Kontabilizimi nuk është kryer në momentin e ndodhjes së saj, pasi i gjithë dokumentacioni që vërteton kërkesat e bashkive (*për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash*) për dhënien e fondeve emergjente, depozitohet dhe verifikohet nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, (*Spektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve*), për këtë arsye kontabilizimi është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, òPër Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave

financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme, pika 3.1, "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nën-pika pika 32, paragrafi 2

- Nga auditimi i disa praktikave në administrim të AKMC-së "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore dhe financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, u konstatua se në asnjë prej këtyre praktikave nuk ndodhet relacioni drejtuar Titullarit të njësisë publike për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës ekonomike. Përlllogaritja e vlerës së ndihmës ekonomike nga AKMC, nuk ka ndjekur një rrugë shkresore zyrtare por pas kalkulimeve dhe disa shënimeve, është proceduar me hartimin e relacionit për propozimin e akordimit të fondit financiar drejtuar Titullarit të AKMC-së. Nga auditimi i disa prej praktikave "Për akordimin e ndihmës financiare për të dëmtuarit nga tërmeti në fshatin Kuç të Himarës në muajin Janar 2019, rezultoi se mungonte gjurma e auditimit. Konkretisht, nuk evidentohet nëse kërkuesi e disponon pronën pra nuk ka në dosje një dokument hipotekor ku të vërtetohet posedimi i pronës nga kërkuesi. Nuk gjendet bashkangjitur preventivave asnjë skicë apo planimetri ose të paktën koordinata të pozicionit gjeografik të pronës për të bërë të mundur të paktën evidentimin e pronës dhe kryerjen e matjeve online. Nuk ka asnjë fotografi ose regjistrim të dëmeve të shkaktuara. Procesverbalet e mbajtura nga grupet e inspektimit të dëmeve në terren të autorizuara nga Titullarët e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, nuk janë protokolluar pranë këtyre institucioneve. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel Qendror dhe Vendor, miratuar me Urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, përcakton qartë tek neni 15 i saj, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe të Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve.

-Nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, nuk është përgatitur Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI) (projektet, preventivat dhe dokumentacioni ligjor) për projektet prioritare të investimit për vitin 2021 dhe 2022).

Për projektin kryesor të investimit "Fatkeqësi natyrore të menaxhuara" me vlerë 280,073 mijë lekë për vitin 2021, Drejtoria e sipër cituar është dërguar 1 vit vonesë, konkretisht me shkresën nr. 1892/1, datë 30.08.2021 në Ministrinë e Mbrojtjes me subjekt "Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja" duke e bërë praktikisht të pamundur realizimin e këtij investimi prioritar dhe mos përdorimin e fondit

-Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer drejtimi i planit operacional të zjarreve me "V.H.ö" nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe Përgjigjes së Emergjencave.

Konkretisht në zbatim të planit operacional nga R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një Plan Veprimi për monitorimin për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar operatorit "V.H.ö" shpk, nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatorit "V.H.ö", shpk si referencat ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi. Konkretisht nuk ka një dokument (aktverifikim, aktkonstatim, procesverbal etj, ku të jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, të urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në terren, Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOE) dhe Operatorit ekonomik "V.H.ö" etj)

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbal apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të "V.H.ö" shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

2. P. K., me detyrë përgjegjësi i sektorit të buxhetit **për arsye se:**

Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021, është likuiduar shoqëria òV.H.ò për vlerën 36,069,300 lekë, për 89.06 orë pune operationale të helikopterëve të kontraktuar. Regjistri i mbajtur për orët operationale të helikopterëve më datë 03.08.2021, pasqyron Berlin (Gjermani)-Shqipëri 11,53 orë operationale x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se òNjësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operationale ku òKohë pune operationaleò, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V. Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....ò.

Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria V.H.ò shpk

- AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, ka kryer procedurë prokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015 òPër prokurimin Publik në Ministrin e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në Forcat e Armatosuraò, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò.

-AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, òPër prokurimin publikò, neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 46.

-Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fondi është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., datë 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., datë 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50.

Për këtë procedurë prokurimi nuk është marrë autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1

- Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021 për vlerën 36,069,300 lekë nëpërmjet OTP Bankë, është likuiduar shoqëria òV.H.ò me nipt M01624004A. Kryerja e këtij shpenzim nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë. Konkretisht:

Dokument vërtetues i urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021, është urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 15.09.2021 për likuidimin e shoqërisë òV.H.ò, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik òV.H.ò datë 03.08.2021, kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik òV.H.ò datë 16.08.2021, fatura elektronike nr. 4/2021, datë 17.08.2021 në të cilën përcaktohet 89.06 orë për vlerën 36,069,300 lekë. Fatura nuk shoqërohet nga asnjë dokument tjetër për ***kohën operationale të kryer në fakt referuar:***

Pikës 2.5 të aktmarrëveshjes, në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se òMinistria e Mbrojtjes, AKMC kryen pagesën për shërbimet e realizuara nga Operatori Ekonomik òV.H.ò dhe të monitoruara sipas pikës 2.4 të kësaj marrëveshje, pikë në të cilën është shprehur se ò Ministria e Mbrojtjes, AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operationale Civile (QKOE) monitoron shërbimet e kryera nga Operatori ekonomik òV.H.ò, ***duke komunikuar me shërbimet vendore të***

mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe AlbControl shaö, pikës 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operationale ku “kohë pune operationale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga Viva heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....”.

-Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e Helikopterëve Heliport të ÷V.H.ö shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

3. K.N., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve, për arsye se:

Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik ÷V.H.ö nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publikë nenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, neni 82. Konkretisht:

-Operatori ekonomik ÷V.H.öshpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik ÷V.H.öshpk, dhe Kompanisë A.I.G.CGjermani, dokument i pavlefshëm për tu marr në konsideratë pasi:

-Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë.

-Konfirmimin që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit.

-Konfirmimi i operationeve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit.

-Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit).

-Licencën Operative, në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautikë i vendit të regjistrimit

Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011 ÷Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010 "mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2.

-Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik ÷V.H.ö, nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të ÷V.H.ö shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

D.1.b. “Vërejtje” e parashikuar nga neni 58, shkronja (a), për:

2. F.B., me detyrë specialiste, Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Buxhetit dhe Financës.

3. R.B., me detyrë specialist, Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Prokurimit dhe Marrëdhënieve Kontraktuale.

Për arsye se:

Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 11.12.2020 për vlerën 120,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar shoqëria ÷D.A.ö Sh.a. Ky shpenzim ka të bëjë me shërbim makine (pjesë këmbimi dhe bateri). Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6023200, duke u konsideruar blerje me vlerë të vogël ÷Rast emergjentë, formulari nr.4.

Në fakt ky shpenzim nuk është rast emergjent, por një shërbim i rregullt, dhe duhet të ishte zbatuar procedurë prokurimi për përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

-Për këtë shpenzim nga shoqëria òD.A.ò sh.a është lëshuar fatura tatimore shitje 321561013, datë 03.12.2020, firmosur nga F.B., R.B. dhe F.K.. Në fakt duhej firmosur nga personat e ndodhur në udhëtim K.N. dhe J.H..

Urdhër shpenzimi, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi:

-Kontratën me karrotecin dhe sa është likuiduar për ta çuar makinën tek vendi i shërbimit, ose mjeti që e ka tërhequr.

-Fletëdaljen e pjesëve të këmbimit (fakt që nuk ka fletëdalje, çka presupozon që pjesët duhet të jenë në magazinë).

-Situacionin e shërbimit të lëshuar nga operatori ekonomik shoqëria òD.A.òSh.a.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.20181 òMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, pika 18, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

D.2. Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 òPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AKMC, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit që nuk përfshirë në pikën **D.1**, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë.

D.3. Për punonjësit e identifikuar me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara, Titullari i AKMC, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT